

**IRIANA PAPAMIHALI**

Libër mësuësi  
për tekstin shkollor

**ART PAMOR**

**6**

Shtëpia botuese Albas



# PËRMBAJTJA

## **PLANI VJETOR I LËNDËS ART PAMOR 6 SIPAS TREMUJORËVE** 5

### **Tematika 1 - Gjuha dhe komunikimi artistik**

*Mjetet e pikturës dhe të skulpturës*

1.1. Vijat	17
1.2. Konturet	19
1.3. Format dypërmasore	22
1.4. (Analizë) Format dypërmasore te piktorët Kandinskij dhe Kle	24
1.5. Ngjyra	26
1.6. Sipërfaqja, tekstura	29
1.7. Drita dhe hija	30
1.9. Hapësira	34
1.10. Baraspesha	37

### **Tematika 2 - Teknika dhe procese**

2.1. Vizatimi me laps dhe karbon	41
2.2. Punojmë me laps	44
2.3. Punojmë me frotazh	46
2.4. Pikturojmë me bojëra uji	48
2.5. Stampojmë mbi letër	52
2.6. Stampa me relievi	55
2.7. Skulptura me reliev	58
2.8. Skulptura	60
2.9. Krijojmë një kolazh	64

2.10. Krijojmë një mozaik	67
2.11. Fotografia	70
2.12. Dizajni grafik	74
2.13. Projekt. Revista jonë (ora I)	77
2.14. Projekt. Revista jonë (ora II)	79
2.15. Projekt. Revista jonë (ora III)	80
2.16. Konstruksioni	81

### **Tematika 3 - Historia, arti dhe shoqëria**

3.1. Arti pasqyrë e shpirtit	85
3.2. Arti si pasqyrim i realitetit	89
3.3. Arti shqiptar në vite	91
3.4- 5. Në galerinë e artit	94
3.6. Arti popullor	95
3.7. Vizitë në studion e artistit	99
3.8. Artet figurative në jetën e përditshme	101

## PLANI VJETOR I LËNDËS ART PAMOR 6 SIPAS TREMUJORËVE

“Arti pamor” është një mënyrë për të krijuar dhe komunikuar nëpërmjet imazhit. Lënda e “Artit pamor” është një lëndë e veçantë dhe ka kërkesat e veta specifike të të mësuarit. Veprimtaritë e “Artit pamor” bëjnë të mundur që nxënësit të bëjnë lidhjen midis botës reale dhe imagjinare, të organizojnë dhe të shprehin vizualisht idetë, ndjenjat dhe përvojat nëpërmjet teknikave të larmishme artistike. Edukimi nëpërmjet “Artit pamor” siguron zhvillimin e krijimtarisë dhe përvojave personale nëpërmjet zbulimit, kërkimit, eksperimentimit, trillimit, vizatimit dhe përdorimit të një sërë mjeteve dhe teknikave. Kjo lëndë promovon vëzhgimin dhe ndihmon nxënësit të fitojnë ndjeshmëri për botën vizuale, hapësinore dhe të prekshme për përvojat estetike.

**Kompetencat kyçe të të nxënit në lëndën e artit pamor janë:**

### Ø Krijimi artistik

Nxënësi:

- përdor ide personale dhe stimuj për krijim;
- zbulon rrugë të ndryshme për të realizuar idetë artistike;
- përdor elementet e artit pamor dhe teknikat artistike;
- përzgjedh elementet e duhur për të realizuar idetë artistike;
- përmirëson punën duke u mbështetur në zgjidhje artistike;
- analizon qëllimin e tij/saj krijues;
- zbulon elemente të përvojës së tij/saj artistike, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur.

### Ø Realizimi i punimit

Nxënësi:

- përdor teknikat artistike, elementet e artit pamor në lidhje me mesazhin që do të përcjellë;
- krijon punë origjinale nëpërmjet vëzhgimit të drejtpërdrejtë nga natyra ose nëpërmjet kujtesës së tij mbi objektet, njerëzit etj., dhe nëpërmjet imagjinatës;
- ndan përvojën e tij krijuese dhe respekton mendimin e tjetrit;
- zgjedh ide dhe planifikon teknikat dhe mjetet për realizim;
- eksperimenton me mjete dhe teknika për të materializuar idetë e tij/saj;
- analizon qëllimin e tij/saj krijues;
- zbulon elemente të përvojës së tij/saj artistike, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur.

### Ø Vlerësimi i veprave të artit

Nxënësi:

- zbulon elementet e gjuhës vizuale, teknikën, gjininë në një vepër arti;
- zbulon veprat e artit në aspektin e tyre historik;
- zbulon aspektin shprehës dhe simbolik duke shprehur emocionet e tij/saj;
- shpjegon, argumenton dhe shpreh këndvështrimin e tij/saj për një vepër ose objekt artistik;

- përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar dhe komentuar veprat e artit dhe përvojën e tyre artistike;
- zbulon elemente të përvojës së tij/saj artistike, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur;
- kupton rëndësinë e rolit të artit pamor dhe artistit në shoqëri;
- zbulon një sërë profesionesh që lidhen me artin pamor.

### **1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit**

Nxënësi:

- Ø krijon personalitetin e vet dhe është aktiv në veprimtaritë artistike;
- Ø kupton drejt mesazhet, që u adresohet;
- Ø shprehet qartë me anë të simboleve, shenjave dhe gjuhës vizuale;
- Ø është komunikues efektiv;
- Ø udhëzohet që të shfrytëzojë në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur, kritike dhe krijuese, mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në art pamor.

### **2. Kompetenca e të menduarit**

Nxënësi:

- Ø merr dhe përpunon njohuritë vizuale në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;
- Ø zgjidh probleme të ndryshme artistike;
- Ø zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese;
- Ø ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari.

### **3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë**

Nxënësi:

- Ø përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim artistik;
- Ø përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim;
- Ø zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.

#### **Kompetenca e të mësuarit për të nxënë**

Nxënësi:

- Ø përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim artistik;
- Ø përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim;
- Ø zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.

#### **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**

Nxënësi:

- Ø ndërmerr nisma për të zhvilluar aktivitete në artin pamor brenda dhe jashtë klasës, duke ndihmuar në mënyrë krijuese;
- Ø kupton dhe gjen zgjidhje për problemet ekologjike, duke u ndërgjegjësuar për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

**Kompetenca personale**

Nxënësi:

- Ø zhvillon besimin te vetja gjatë veprimtarive artistike;
- Ø përfshihet në mënyrë aktive në jetën artistike shkollore dhe komunitet;
- Ø rrit ndërgjegjësimin për veten, në zhvillimin e vetëbesimit dhe krijimin e besimit te të tjerët.

**Kompetenca qytetare**

Nxënësi:

- Ø diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore;
- Ø respekton punën e vet dhe të të tjerëve;
- Ø bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.

**Kompetenca digjitale**

Nxënësi:

- Ø gjen, prodhon, krijon, prezanton dhe shkëmben informacion si dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet;
- Ø njeh dhe përdor mjetet audio, video, Cd, Dvd, aparat fotografik, digjital, kamera etj.

**Tematikat e lëndës:**

1. Tematika 1: Gjuha dhe komunikimi artistik
2. Tematika 2: Teknika dhe procese artistike
3. Tematika 3: Historia, arti dhe shoqëria

	<b>Gjuha dhe komunikimi artistik</b>	<b>Teknikat dhe proceset</b>	<b>Historia, arti dhe shoqëria</b>	<b>Gjithsej</b>
<b>Klasa e gjashtë</b>	<b>10</b>	<b>17</b>	<b>8</b>	<b>35 orë</b>

TREMUIJORI I						
Nr. orëve	Tematika	Temat mësimore	Situata e të nxënët	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
1		<b>1.1. Vijat</b>	Emërtimi i vijave të ndryshme. Eksperimentimi me lloje të ndryshme vijash nëpërmjet mjeteve të ndryshme. Dallimi i vlerave dhe vijave dhe kuptimi i tyre.	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.	Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësim, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.	Teksti Imazhe ku gjendet vija
2		<b>1.2. Konturet</b>	Përshkrimi i emocioneve rreth vijës. Zgjedhja sipas dëshirës të një konturi që të përmbushë preferencat e tij/saj. Dhënia e opinionit të tij/saj rreth vlerave të konturit.	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike analizë, vlerësim, interpretim.	Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësim, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.	Teksti Imazhe ku gjendet konturi në gjini të ndryshme.
3		<b>1.3. Format dypërmasore</b>	Gjejta e shembujve të formave gjeometrike. Krijimi me format gjeometrike dhe klasifikimi i llojeve të formave. Përfundime për disa forma të rregullta dhe të parregullta. Argumentimi pse disa janë natyrale dhe disa artificiale. Shpjegimi i rolit dhe rëndësisë së tyre në krijimtarinë artistike.	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.	Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësim, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.	Teksti Figura gjeometrike Modele me motive popullore
4		<b>1.4. Analizë. Format dypërmasore të piktorët Kandinskij dhe Kle</b>	Vëzhgimi i veprave përkatëse. Krahasimi i dy veprave për nga përmbajtja e tyre. Gjetja grafike e formave gjeometrike në këto vepra.	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim	Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësim, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe, për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.	Teksti Foto të dy veprave përkatëse

**Gjuha dhe komunikimi artistik**



5	<b>5.5 Ngjyra</b>	Njohja me spektrin e ngjyrave dhe klasifikimi i ngjyrave. Përdorimi i ngjyrave si mjet artistik si dhe interpretimi me mundësitë shprehëse. Vlerësimi i rëndësishëm të ngjyrës në artin pamor.	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.	Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe, për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.	Teksti Rrethi i ngjyrave Materiale ilustruese
6	<b>1.6. Sipërfaqja dhe tekstura</b>	Njohja me llojet e ndryshme të sipërfaqes. Krijim sipas dëshirës që të përmbushë preferencat e tij/saj. Gjurmimi ose hulumtimi i botës përreth dhe dhënia e opinionit rreth sipërfaqes dhe teksturës.	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.	Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe, për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.	Teksti Materiale ilustruese Objekte me sipërfaqe të ndryshme
7	<b>1.7. Drita dhe hija</b>	Zbulimi i dritë- hijes së objekteve. Vëzhgimi i burimit të dritës (Arrinhet në përfundimin se hija i jep vëllimin figurave).	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.	Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe, për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.	Teksti Materiale ilustruese Trupa gjeometrikë
8	<b>1.8. Punohet me dritëhijen</b>	Përcaktimi i burimit të dritës. Krijimi i vëllimit nëpërmjet vlerave të bardhë e zisë. Vlerësimi i krijimit të bërë.	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.	Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe, për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.	Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse

9	<p><b>1.9. Hapësira</b></p>	<p>Gjetja e llojeve të hapësirës. Klasifikimi i objekteve në hapësirë. Vlerësimi i rolit të perspektivës në paraqitjen e hapësirës në një krijim artistik.</p>	<p>Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.</p>	<p>Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe, për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.</p>	<p>Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse</p>
10	<p><b>1.10. Baraspesha</b></p>	<p>Njohja me llojet e baraspeshës në natyrë dhe në imazhe të ndryshme. Zbatimi në krijime artistike llojet e baraspeshës. Vlerësimi i rolit të simetrisë dhe asimetrisë në pikturë, skulpturë, arkitekturë.</p>	<p>Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.</p>	<p>Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe, për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.</p>	<p>Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse</p>

**TREMUJORI II**

11	<b>2.1. Vizatimi me laps dhe karbon</b>	Njohja me karakteristikat shprehëse të lapsit dhe karbonit. Aftësi në përdorimin e teknikës së lapsit dhe karbonit nëpërmjet mënyrave shprehëse të tyre. Eksperimentimi nëpërmjet ndërthurjes së teknikave të lapsit dhe karbonit.	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.	Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimi, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe, për analizën dhe e një krijimi ose të një vepre arti.	Teksti Karbon, laps Materiale ilustruese Modele përkatëse
12	<b>2.2. Punojmë me laps</b>	Aftësi nëpërmjet përdorimit të teknikës së lapsit Përdorimi gradacionit tonal të lapsit. Vlerësimi i mundësive shprehëse të lapsit.	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.	Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimi, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe, për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.	Tekst Laps Materiale ilustruese Modele përkatëse
13	<b>2.3. Punojmë me frotazh</b>	Prezantimi me teknikën e frotazhit. Aplikimi i fërkimit të trupave për krijimin artistik. Analizë dhe vlerësim i arritjeve të teknikës së frotazhit në punën e vet dhe të të tjerëve.	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.	Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimi, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe, për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.	Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse
14	<b>2.4. Pikturojmë me bojëra uji</b>	Prezantimi me bojërat e uji, akuarelet, temperat dhe akrilikët dhe cilësitë e tyre Krijim sipas preferencave duke ndjekur udhëzimet Vlerësim për punën në bashkëpunim dhe interpretimi sipas mënyrës së vet “Pranverën” e Botiçellit.	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.	Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimi, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe, për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.	Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse

**Teknika dhe procese**

15	<b>2.5. Stampojmë mbi letër</b>	<p>Prezantim me mjetet e realizimit të teknikës së stampimit dhe monotypit dhe veçoritë e tyre.</p> <p>Realizim stampimi dhe monotypi duke ndjekur hap pas hapi udhëzimet.</p> <p>Vlerësim për punën dhe përpjekjet e bëra për të arritur dy teknikat.</p>	<p>Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.</p>	<p>Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe, për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.</p>	<p>Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse</p>
16	<b>2.6. Stampa me relief</b>	<p>Diskutim për preferencat e veta për llojet e stampave.</p> <p>Paraqitja e formës tre dimensionale mbi sipërfaqen dy dimensionale.</p> <p>Qëndrim pozitiv ndaj krijimtarisë artistike dhe vlerësimi i punës së vlerëson punën e vet dhe të shokëve/shoqeve.</p>	<p>Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.</p>	<p>Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe, për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.</p>	<p>Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse</p>
17	<b>2.7. Skulptura me relief</b>	<p>Shkëmbehen për prejardhjen e skulpturës me relief.</p> <p>Aplikohet procesi i gdhendjes sipas etapave.</p> <p>Përdorimi i skulpturës me relief për qëllime të caktuara.</p>	<p>Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.</p>	<p>Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe, për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.</p>	<p>Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse</p>
18	<b>2.8. Skulptura</b>	<p>Përcaktimi i mjeteve të duhura për procesin e skulpturës që do aplikohet.</p> <p>Ndjekja hap pas hapi i modelimit, si proces i skulpturës.</p> <p>Vlerësimi i rolit të skulpturës në art e kulturë dhe në jetën e përditshme.</p>	<p>Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.</p>	<p>Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe, për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.</p>	<p>Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse</p>

19	<b>2.9. Krijojmë një kolazh</b>	Përzgjedhja e bazës materiale për krijimin e kolazhit. Krijimi i kolazhit duke iu referuar hapave sipas udhëzimeve. Zbulimi i karakteristikave të teknikës së kolazhit dhe vlerat e tij.	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.	Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësim, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe, për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.	Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse
20	<b>2.10. Krijojmë një mozaik</b>	Përcaktimi i materialeve dhe tema e mozaikut. Ndarja e detyrave në grup dhe marrja e përgjegjësisë për realizimin e mozaikut. Vlerësimi i mozaikut dhe vlerat e tij historike dhe kulturore në vendin tonë.	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.	Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësim, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe, për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.	Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse
21	<b>2.11. Fotografia</b>	Dallimi i llojeve të fotografisë dhe klasifikimi i tyre. Përdorimi i aparatit fotografik për të fiksuar imazhe të kompozua saktë, zbulon se imazhi fotografik ndryshon nga imazhi artistik i pikturës, vizatimit. Mbrojtja e ideve të veta në lidhje të pikturës ose të fotografisë nëpërmjet debatit konstruktiv dhe krahasimit.	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.	Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësim, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe, për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.	Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse
22	<b>2.12. Dizajni grafik</b>	Njohja me mundësitë shprehëse të dizajnit grafik si koncept i kohëve moderne. Zbulimi ose Gjurmimi i mundësive të reja shprehëse të dizajnit grafik nëpërmjet simboleve, mesazheve pamore etj. Vlerësimi i rolit dhe rëndësisë së dizajnit grafik në fushat e jetës.	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.	Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësim, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe, për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.	Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse

23	<b>2.13 Projekt. Revista jonë</b>	<p>Përshatja në grup dhe marrja përsipër e detyrave sipas tematikës.</p> <p>Hartimi i planit të punës sipas radhës së vendosur.</p> <p>Përcaktimi i llojit të informacionit dhe titullit për rubrikat që do përpunohen.</p>	<p>Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.</p>	<p>Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe, për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.</p>	<p>Teksti</p> <p>Materiale ilustruese</p> <p>Modele përkatëse</p>
24	<b>2.14 Projekt. Revista jonë</b>	<p>Përzgjedhja e fotove dhe materialeve ilustruese.</p> <p>Hartimi i tekstit sipas rregullave.</p> <p>Hartimi i ngjites së fotografive në përshatje me tekstin</p>	<p>Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.</p>	<p>Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe, për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.</p>	<p>Teksti</p> <p>Materiale ilustruese</p> <p>Modele përkatëse</p>
25	<b>2.15 Projekt. Revista jonë</b>	<p>Përzgjedhja e prezantuesit/ses për rubrikën:</p> <p>Interesimi dhe vëmendja për punimet e grupeve të tjera.</p> <p>Analizimi, vlerësimi i punës së vet dhe të grupeve të tjera.</p>	<p>Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.</p>	<p>Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe, për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.</p>	<p>Teksti</p> <p>Materiale ilustruese</p> <p>Modele përkatëse</p>
26	<b>2.16. Konstruksioni</b>	<p>Përzgjedhja e materialeve të duhura për ndërtimin e një strukture.</p> <p>Përdorimi i materialeve të riciklueshme për të bërë një konstruksion.</p> <p>Vlerësimi i rolit të riciklimit si një proces i rëndësishëm në art.</p>	<p>Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.</p>	<p>Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe, për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.</p>	<p>Teksti</p> <p>Materiale ilustruese</p> <p>Modele përkatëse</p>

27	<b>Historia, arti dhe shoqëria</b>				<b>3.1. Arti si pasqyrë e shpirtit</b>	<p>Perceptohet si ka evoluar arti figurativ ndër shekuj.</p> <p>Përdorimi i fjalorit të duhur artistik për të komunikuar, vlerësimin e tij/saj, kërkimi i informacionit të duhur.</p> <p>Analizimi dhe vlerësimi i artit si pasqyrë e shpirtit dhe krahasimi i periudhave të ndryshme artistike.</p>	<p>Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.</p>	<p>Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimi, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe, për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.</p>	<p>Teksti Materiale ilustruese  Modele përkatëse</p>
28	<b>3.2. Arti si pasqyrim i realitetit</b>	<p>Dallimi midis periudhave të ndryshme të artit dhe njohja e tipareve të secilës periudhë.</p> <p>Krijimi duke u frymëzuar nga një periudhë e caktuar.</p> <p>Analizimi dhe krahasimi i periudhave të ndryshme dhe vlerësimi i rolit të artit në histori dhe kulturë.</p>	<p>Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.</p>	<p>Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimi, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe, për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.</p>	<p>Teksti Materiale ilustruese  Modele përkatëse</p>				
29	<b>3.3. Arti shqiptar në vite</b>	<p>Marrja pjesë në diskutim.</p> <p>Përdorimi i teknikave të ndryshme në lidhje me temën.</p> <p>Analizimi i tipareve më të veçanta ose të qenësishme të artit shqiptar në vite.</p>	<p>Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.</p>	<p>Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimi, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe, për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.</p>	<p>Teksti Materiale ilustruese  Modele përkatëse</p>				
30	<b>3.4. Në Galerinë e Artit</b>	<p>Mbajtja e shënimeve paraprake.</p> <p>Marrja e informacionit nga librat e artit.</p> <p>Përzgjedhja e mjeteve të informacionit që do të përdoren.</p>	<p>Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.</p>	<p>Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimi, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe, për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.</p>	<p>Teksti Materiale ilustruese  Modele përkatëse</p>				

31	<p><b>3.5. Në Galerinë e Artit</b></p>	<p>Përmbledhja e shënimeve dhe informacionit. Përcaktimi i veprave që pëlqehen më shumë. Përzgjedhja e informacionit për të krijuar një album.</p>	<p>Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.</p>	<p>Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe, për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.</p>	<p>Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse</p>
32	<p><b>3.6. Arti popullor</b></p>	<p>Mbledhja e informacionit të duhur për artin popullor (veshjet dhe arkitekturën, objekte artizanati etj.). Bashkëpunim në grup. Prezantimi i informacionit të mbledhur duke zbuluar vlerat e trashëgimisë kulturore.</p>	<p>Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.</p>	<p>Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe, për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.</p>	<p>Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse</p>
33	<p><b>3.7. Vizitë në studion e artistit</b></p>	<p>Njohja nga afër me veprimtarinë artistike dhe vendin ku krijohet. Qartësohen idetë nëpërmjet bashkëbisedimit. Vlerësimi i veprës krijuese të artistit.</p>	<p>Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.</p>	<p>Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe, për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.</p>	<p>Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse</p>
34	<p><b>3.8. Artet figurative në jetën e përditshme</b></p>	<p>Ndërgjegjësimi për rolin e artit figurativ në jetën e përditshme lustrim Ilustrim, krijim, stilim sipas dëshirës aty ku e ndien veten më mire. Vlerësimi për ndihmën që jep artisti në spektrin e madh të artit figurative.</p>	<p>Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim.</p>	<p>Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre si dhe, për analizën dhe interpretimin e një krijimi ose të një vepre arti.</p>	<p>Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse</p>



## Tematika 1 – Gjuha dhe komunikimi artistik

Planifikimi i orës mësimore – 1			
<b>Tematika:</b> Gjuha dhe komunikimi artistik	<b>Lënda:</b> Art pamor	<b>Tema:</b> Vijat	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënit, sipas kompetencave kyçe:</b>		<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës, sipas temës mësimore:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit</b> – Nxënësi/ja shpreh emocionet e tij/saj.</li> <li>• <b>Kompetenca e të menduarit</b> – Nxënësi/ja kupton si ndryshojnë llojet e shenjave dhe vijave sipas mjeteve të ndryshme.</li> <li>• <b>Kompetenca personale</b> – Nxënësi/ja është i aftë të krijojë me mjetin shprehës dhe zgjedh teknikën që i pëlqen.</li> </ul>		<b>Nxënësi/ja:</b> ✓ eksperimenton lloje të ndryshme shenjash, duke kuptuar rëndësinë komunikuese të vijës; ✓ përdor mjete të ndryshme artistike, për të krijuar emocione të caktuara nëpërmjet vizatimeve me vijën ✓ tregon se cilat janë cilësitë e vijës dhe vlerat e saj.	
<b>Mjetet e punës:</b> fletore vizatimi, laps, stilolaps, karbon, rapidograf, gomë, figura ilustruese			
<b>Burimet:</b> Teksti <i>Art pamor 6</i>		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> <i>Matematika, Historia</i>	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b> Diskutim, marrëdhënia pyetje- përgjigje, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, krahasim, interpretim.			

### Përshkrimi i situatës

**Diskutim.** Nxënësit lexojnë për disa minuta në tekst **Mjetet e pikturës dhe të skulpturës** dhe diskutojnë së bashku për këto mjete e materiale të artistëve.

**Marrëdhënia pyetje–përgjigje.** Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalën “VIJAT” dhe përgjigjet e tyre i shkruan në tabelë në skemë (kllaster).



**Vëzhgim.** Kërkojini nxënësve të shohin përreth dhe të japin shembuj të vijave që shohin.


Nxënësit, sipas njohurive që kanë për vijat nga lënda e matematikës apo e arteve pamore të klasave të mëparshme, bëjnë komentet e tyre.

Mësuesi/ja vizaton lloje të ndryshme vijash dhe nxënësit i emërtojnë ato.

Vijë e drejtë




Vijë e pjerrët



Vijë vertikale



Vijë e thyer



Vijë e lakuar



Vijë e hollë



Vijë e trashë



Të ndarë në dy grupe ata dallojnë me ç'loj vijash janë bërë shkronjat, numrat apo notat muzikore.

### Realizimi i kuptimit

Mësuesi/ja shpjegon konceptet kyçe të mësimit: ç'janë vijat, rëndësinë që kanë vijat në artin figurativ, cilësitë e vijës dhe mundësitë shprehëse të saj.

**Çfarë është një vijë?** Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të komentojnë shprehjen "Vija është një pikë që shëtit.", duke i lënë ata të shprehen lirshëm, ashtu siç e mendojnë (pa i korrigjuar). Ata dalin në përfundimin se vija është një vazhdimësi pikash.

**Për çfarë shërbejnë vijat?** Mësuesi/ja u tregon atyre që vijat janë kudo, që te fletoret (me vija dhe kutia), te shkrimi, te simbolet, figurat, hartat, figurat gjeometrike, rrjetin koordinativ, skicat etj. Nxënësit dallojnë vija te posterat e afishuar te muret e klasës, te librat e fletoret e tyre dhe te gjithçka që i rrethon.

**Çfarë mund të bëjmë me vijat?** Nxënësit japin mendimin e tyre se për çfarë i përdorin ata vijat në secilën prej lëndëve, si për shembull, për skema dhe diagrame, për të shkruar (numra dhe shkronja), për të bashkuar pika, për të rrethuar një përgjigje, për të plotësuar harta, si dhe për të vizatuar.

**Çfarë shprehin vijat?** Mësuesja ndalet pikërisht te vija dhe rëndësia e saj në lëndën e Artit pamor, e cila, ndryshe nga përdorimet e tjera të vijës, përveçse paraqet diçka (një send real që mund të shihet a një mendim a ide që nuk mund të shihet), shpreh dhe përcjell ide dhe emocione.

**Diskutim.** Mësuesi/ja u paraqet nxënësve figurën e qenit dhe të saksofonistit dhe i fton ata në diskutim:


- *Të gjithë ne dimë të bëjmë vija. Edhe një fëmijë 2-3 vjeç, i cili sapo ka filluar të mbajë lapsin, arrin të bëjë shkarravinat e para. Por ç'ndryshim ka shkarravina e një fëmije nga vizatimi i qenit i bërë me "teknikën e shkarravitjes"?*

Nxënësit dalin në përfundimin se vija në artin pamor ka si qëllim të paraqesë objekte, mendime e ide, të shprehë emocione etj. Ata rikujtojnë nga lënda e Historisë vizatimet e para të njeriut në muret e shpellave, çfarë paraqisnin dhe çfarë shprehnin ato.

Më pas mësuesja u tregon atyre se përdorimi i llojeve të ndryshme të vijave jep efekte dhe ndjesi të ndryshme. Ata e dallojnë këtë te vizatimi i shisheve të punuara me lloje të ndryshme vijash, tregojnë për ndjesitë që u lë secili prej vizatimeve dhe se cilat pëlqejnë.

**Punë e pavarur.** Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të eksperimentojnë në fletoren e vizatimit, duke vizatuar lloje të ndryshme vijash dhe efektsh që mund të krijohen me to, duke krijuar një punim me mjetin që i pëlqen më shumë, si lapsi, rapidografi, stilolapsi, karboni etj.

Në këtë mënyrë nxënësit/et kuptojnë rolin e rëndësishëm të vijës në artin figurativ dhe mundësitë shprehëse të saj.




Nxënësit ushtrohen me laps, duke e mbajtur atë në pozicione të ndryshme dhe duke ushtruar forca të ndryshme, sipas ushtrimeve në tekst.

**Një ide!** Ata mund të zgjedhin të krijojnë në 1/4 e fletës A4 nga një patern me lloje të ndryshme vijash si këto që janë paraqitur dhe në fund t'i organizojnë të gjitha punimet në një poster të përbashkët.

### Përforcimi i njohurive

*Analizë, vlerësim, krahasim, interpretim.* Nxënësit dalin në përfundimin se vija është zanafilla e artit figurativ. Ata diskutojnë se me cilin mjet ata e bënë vizatimin më të mirë (dhe pse), çfarë lloje vijash përdorën dhe çfarë roli kishin ato në krijimin e tyre.



**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre.

**Detyra:** Nxënësit zgjedhin të punojnë ndonjë nga objektet e përmendura në ushtrimin 1 ose këtë punim të paraqitur këtu. Mësuesja i udhëzon mënyrën e punimit: në një fletë të bardhë vendoset pëllëmbën e hapur dhe i bihet rreth e qark me laps. Më pas bëhen vijëzimet si te modeli i dhënë.



## Planifikimi i orës mësimore – 2


<b>Tematika:</b> Gjuha dhe komunikimi artistik	<b>Lënda:</b> Art pamor	<b>Tema:</b> Konturet	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</b>		<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit</b> - Nxënësi/ja përshkruan emocionet e veta rreth vijës.</li> <li>• <b>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</b> - Nxënësi/ja/ja zgjedh sipas dëshirës të krijojë konturin që të përmbushë preferencat e tij/saj.</li> <li>• <b>Kompetenca për jetën</b> - Nxënësi/ja jep gjykimin e tij/saj rreth vlerave të konturit.</li> </ul>		<b>Nxënësi/ja:</b> ✓ identifikon llojet të ndryshme të kontureve; ✓ përdor cilësitë e ndryshme të vijës për qëllime të caktuara me teknikën e zgjedhur sipas dëshirës; ✓ përcakton rolin e kontureve në një krijim, funksionin e tyre në gjini të ndryshme të artit.	
<b>Mjetet e punës:</b> fletore vizatimi, laps HB, gomë, figura ilustruese			
<b>Burimet:</b> Teksti <i>Art pamor 6</i>		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuha, Gjeografia	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b> <i>Diskutim, marrëdhënia pyetje- përgjigje, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, krahasim, interpretim.</i>			

### Përshkrimi i situatës

*Marrëdhënia pyetje- përgjigje.* Mësuesi/ja ka përgatitur më parë disa modele ose imazhe, ku evidentohet konturi në vizatim, pikturë, skulpturë, si në kohët më të hershme, në periudha të ndryshme e deri në ditët tona. Nxënësit japin mendime rreth figurave. Në këto figura paraqitet konturi në:



Konturi në pikturë



Konturi në skulpturë



Konturi në relief

*Vëzhgim.* Mësuesi/ja fton nxënësit të flasin rreth figurave të mësipërme, duke pyetur nxënësit rreth ndryshimeve që ata shohin dhe për mjetet me të cilat janë realizuar këto punë.

Shpjegon se konturi nuk është i rëndësishëm vetëm në art, por edhe në fusha të tjera si në përpunimin e hartave, në paraqitjen e relievit etj. Nxënësit japin opinionet e tyre për çfarë shohin.

Biseda drejtohet drejt rolit që ka konturi në gjinitë

e artit që nga arti grek, bizantin, rrymat e artit modern etj. Mësuesi/ja fton nxënësit edhe të bëjnë dallimin midis periudhave. Saktëson konceptet që nxënësit të kuptojnë ndryshimin e konturit, p.sh., midis vizatimit dhe pikturës ose dhe mes skulpturës, si dhe mjetet që janë përdorur për realizimin e tyre.

Është e rëndësishme që mësuesi/ja të rikujtojë shpesh që konturet e objekteve nuk ekzistojnë në natyrë.



Konturi në hartë

### Realizimi i kuptimit

Mësuesi/ja shpjegon konceptet kyçe të mësimin rreth konturit. Mësuesi/ja mund të vizatojë një objekt dhe të nxisë nxënësit të flasin rreth tij për mënyrën si u vizatua.

### Ç'është konturi?

- *Pra, me kur me anë të një vije vizatojmë një objekt, ne krijojmë një kontur.*

Konturi është një vijë që tregon formën e jashtme të objektit, por jo vëllimin ose masën e tij.

### Si e krijojmë konturin?

Konturi krijohet duke ndjekur anët e dukshme të një figure. Konturi përshkruan pjesën e jashtme kufizuese të një forme.

### Cili është roli i konturit?

Me kontur krijojmë formën e objektit, duke e shkëputur atë nga sfondi.

*Ja një shembull që tregon se si krijohet forma e jashtme, në rastin tonë e dorës me laps.*

### Si krijohet konturi në gjinitë e tjera të artit?

Më parë mësuesi/ja pyet nxënësit se ç'mendim kanë ata konturin në gjinitë e tjera të artit.



Mësuesi/ja shpjegon se konturi në skulpturë dhe në arkitekturë është i rëndësishëm, për faktin se ka të bëjë shumë me paraqitjen e jashtme me pamjen e përgjithshme anësore që ato ofrojnë. Rëndësi ka edhe burimi i dritës. Mësuesi/ja pyet nxënësit se pse në këto gjini është më i vështirë krijimi i konturit. Në periudha të ndryshme kemi përdorimin e kontureve si qëllim në vetvete si në artin egjiptian, grek, bizantin. Me kalimin e kohës konturi u zëvendësua nga elemente të tjerë të artit. Përdorimin e konturit e shohim shumë të shprehur edhe në artin modern, ku përveç ngjyrave potente kemi edhe kontur të dukshëm dhe shumë shprehës.

*Punë e pavarur.* Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që, sipas preferencës, të bëjnë një krijim, ku të evidentohet konturi (shihni ushtrimet në libër). Nxënësi/ja zgjedh teknikën që i pëlqen, vizatimin, pikturën ose dhe modelimin me plastelinë. Në fillim nisët nga konturi dhe më pas mund të punohet me materiale të ndryshme, p.sh., me plastelinë për të krijuar relievin etj.

*Krijimtari artistike.* Gjithashtu, nxënësit mund të krijojnë duke u nisur nga kohët e hershme sipas artit egjiptian, grek, bizantin ose edhe nga arti modern, ku konturet në pikturë janë më të theksuara. Duke iu referuar ushtrimit “Loja me konturet”. Nxënësit mund të vizatojnë profilet e njëri- tjetrit duke vepruar kështu: në një fletë formati të vendosur mbi tavolinë nxënësi/ja fton shokun ose shoqen e bankës të vendosë profilin mbi të dhe tjetri me laps ndjek formën e profilit mbi letër. Në të njëjtën fletë në të kundërt vendoset përsëri koka profil e mbështetur mbi bankë dhe konturohet përsëri. Ngjyroset bardhë e zi si të shembulli në libër dhe nxënësit gjejnë “leximin e dyfishtë”, portretet dhe vazon.

*Interpretim:* Mësuesi u shpjegon nxënësve për “konturin e verbër”, që do të thotë të vizatosh konturin e një objekti duke parë vetëm objektin, pa e parë fare fletën. Figura 1 na jep një ide se si mund të bëhet “konturi i verbër”. Shikoni rezultatin te figura 2



Figura 1



Figura 2

### **Përforcimi njohurive**

*Analizë, krahasim.* Nxënësit pasi vëzhgojnë krijimet e njëri- tjetrit, japin vlerësimet e tyre për punën e bërë dhe nxjerrin në pah rolin e rëndësishëm të konturit dhe e krahasojnë atë në gjini të ndryshme. Sigurisht, mësuesi/ja drejton bisedën nëpërmjet pyetjeve të duhura.


**Detyra:** Nxënësi/ja zgjedh sipas dëshirës një nga detyrat e dhëna në rubrikën “Ushtroni”.

**Shënim.** Në orën e ardhshme nxënësit ndahen në grupe sipas detyrës që kanë zgjedhur të punojnë dhe krahasojnë e vlerësojnë punimet e njëri- tjetrit.

<b>Planifikimi i orës mësimore – 3</b>			
<b>Tematika:</b> Gjuha dhe komunikimi artistik	<b>Lënda:</b> Art pamor	<b>Tema:</b> Format dypërmasore	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</b>		<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>● <b>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:</b> – Nxënësi/ja kërkon në mjedisin përreth dhe gjen shembuj të formave gjeometrike.</li> <li>● <b>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</b> – Nxënësi/ja krijon me format gjeometrike dhe klasifikon llojet e formave.</li> <li>● <b>Kompetenca për jetën</b> – Nxënësi/ja nxjerr konkluzionin që disa forma janë të rregullta dhe disa të çrregullta, disa janë natyrale dhe disa artificiale dhe kupton rolin dhe rëndësinë e tyre në krijimtarinë artistike.</li> </ul>		<b>Nxënësi/ja:</b> ✓ zbulon që format bazë gjeometrike gjenden edhe në natyrë; ✓ zhvillon format gjeometrike në një dekorim; ✓ vlerëson përdorimin e formave gjeometrike dhe natyrale në jetën e përditshme.	
<b>Mjetet e punës:</b> fletore vizatimi, laps HB, gomë, vizore, ngjyra të ndryshme, figura ilustruese			
<b>Burimet:</b> Teksti <i>Art pamor 6</i>		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Matematika, Biologjia, Trashëgimia kulturore	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b> <i>Diskutim, marrëdhënia pyetje- përgjigje, vëzhgim punë e pavarur, krijimtari artistike</i> <i>Analizë, vlerësim, krahasim, interpretim</i>			

**Përshkrimi i situatës:**

*Marrëdhënia pyetje- përgjigje.* Mësuesi/ja udhëheq nxënësit drejt një bisede “stuhi mendimesh” për format gjeometrike dhe shënon përgjigjet në tabelë. Më pas vizatohen format gjeometrike dhe nxënësit i emërtojnë ato. Rikujtohet që format gjeometrike kanë dy përmasa, gjatësi dhe gjerësi.



Mësuesi/ja nxit nxënësit të kërkojnë forma gjeometrike në klasë. Pyet nxënësit:

- A përdoren format dypërmasore vetëm në matematikë?
- Çfarë përdoret për të vizatuar format gjeometrike? (Përdoren konturet e figurave, duke përdorur lloje të ndryshme vijash.)
- Ku mendoni se gjejnë zbatim përdorimi i formave gjeometrike? (Përdorimi i formave gjeometrik gjen zbatim në vizatim, pikturë, skulpturë etj.)

*Vëzhgim.* Mësuesi/ja kërkon shembuj nga nxënësit për format dypërmasore në natyrë. P.sh.: dielli, ylli i detit, luledelet etj. Është shumë e rëndësishme që mësuesi/ja të vërë theksin te përafrimi i formave dypërmasore gjeometrike me format natyrore. Kjo do të thotë që nxënësi/ja në çdo formë të gjejë dhe strukturën gjeometrike të saj, sepse kështu e ka më të lehtë të krijojë nga natyra.

### Realizimi i kuptimit

Mësuesi/ja shpjegon se format natyrale gjenden në natyrë, ndërsa format artificiale janë të krijuara nga njeriu. Mësuesi/ja pyet nxënësit se sa përmasa kanë format gjeometrike (dy përmasa, gjatësi dhe gjerësi) dhe a janë ato forma natyrale apo artificiale (artificiale).

Mësuesi/ja shpjegon se format dypërmasore në vizatime ose i pikturojmë në një sipërfaqe të sheshtë, siç është fleta ose tabela. Gjinitë e artit, që janë dypërmasore, janë: vizatimi, piktura, grafika, fotografia etj.

*Punë e pavarur.* Mësuesi/ja paraqet figura ku evidentohen motivet popullore të kostumet dhe qilimat tanë.



Veshje e Hasit me forma dypërmasore



Qilim me forma dypërmasore e krijuar me qëndisje i krijuar me endje në

Mësuesi/ja vizaton në tabelë një dekorim me motive popullore si shembull dhe nxënësit e zhvillojnë në një fletë me kuti. Nxënësit e përzgjedhin vetë formën dypërmasore gjeometrike që do të vizatojnë. Mësuesi/ja i udhëzon për fillim e punës me laps dhe motivin e zgjedhur duhet ta shpërndajnë simetrikisht në fletën me kuti, pra, duhet të jetë sipas një rregulle të caktuar dhe duhet që nxënësi të numërojë kutitë. Mund të jetë edhe një formë e vetme që sa vjen dhe zmadhohet ose edhe disa forma të vendosura njëra pas tjetrës, si te modeli i dhënë në tekst.

Gjithashtu, nxënësit udhëzohen edhe për ngjyrat që do të përdoren nga nxënësit që të jenë të kombinuara dhe të jenë të pëlqyeshme për syrin.

Mësuesi/ja përmend edhe veshjet popullore dhe qilimat që kanë shumë forma dypërmasore, pra, në përgjithësi, në artizanatin shqiptar kanë një përdorim të gjerë.

### Përforcimi i njohurive

Mësuesi/ja fton nxënësit të shohin krijimet e tyre dhe të nxjerrin në pah se cilat forma përdorën në krijimet e tyre dhe se në art një formë e thjeshtë kthehet në formë artistike.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre.

**Detyra:** Nxënësit të krijojnë strukturën gjeometrike të një forme natyrore dypërmasore, si lule, guaskë, gjethe, siç paraqitet në tekst.

<b>Planifikimi i orës mësimore - 4</b>			
<b>Tematika:</b> Gjuha dhe komunikimi artistik	<b>Lënda:</b> Art pamor	<b>Tema:</b> Analizë. Format dypërmasore te piktorët Kandinskij dhe Kle	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</b>		<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit</b> - Nxënësi kërkon në mjedisin përreth dhe gjen shembuj të formave gjeometrike.</li> <li>• <b>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</b> - Nxënësi krijon me format gjeometrike dhe klasifikon llojet e tyre.</li> <li>• <b>Kompetenca për jetën</b> - Nxënësi nxjerr konkluzionin që disa forma të rregullta dhe disa të çrregullta, disa janë natyrale dhe disa artificiale dhe kupton rolin dhe rëndësinë e tyre në krijimtarinë artistike.</li> </ul>		<b>Nxënësi:</b> ✓ kërkon format gjeometrike dhe natyrale në veprat përkatëse; ✓ krahason përdorimin e formave në të dy veprat përkatëse; ✓ analizon format natyrale në veprat artistike të Pol Klesë dhe Vasilij Kandinskijt.	
<b>Mjetet e punës:</b> fletore vizatimi, laps HB, gomë, vizore, ngjyra të ndryshme, figura ilustruese			
<b>Burimet:</b> teksti - Art pamor 6		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Matematika, Historia, TIK	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b> Diskutim, Marrëdhënia pyetje- përgjigje, Vëzhgim, kërkim, krahasim Analizë, vlerësim, interpretim			

<p><b>Përshkrimi i situatës:</b> Mësuesi/ja ka printuar më parë dy pikturat e piktorëve, Kandinskij dhe Kle, mundësisht në format A3. I vendos ato në tabelë ose orienton nxënësit te fotot e tekstit.</p> <p><b>Hapi i parë:</b> Mësuesi pyet nxënësit për pikturat dhe për autorët, nëse dikush prej tyre i njeh. Bën një historik të shkurtër të jetës dhe veprës së piktorëve:</p> <p><b>Vasilij Kandinskij</b> lindi në Rusi (1866 –1944) dhe ishte një piktor dhe teoricien arti me ndikim të madh. Ai jetoi edhe në Gjermani dhe në Francë, ku zhvilloi krijimtarinë e tij artistike. Krijimi i veprave abstrakte erdhi si rezultat i një periudhe të gjatë pune dhe bazuar në eksperiencën e tij artistike. Ai është një nga figurat më të rëndësishme në zhvillimin e artit modern. Ai shpesh i shihte punët e tij si pjesë muzikore.</p> <p><b>Pol Kle</b> lindi në Zvicër (1879 –1940). Stili i tij i veçantë u ndikua nga lëvizjet e ndryshme të artit. Ishte një artist që eksploronte thellë me teorinë e ngjyrave dhe, së bashku me Kandinskijn, ndoqën shkollën Bauhaus në Gjermani. Kleja ishte gjithashtu edhe muzikant dhe, përpara se të pikturonte, ai luante në violinë. Kleja admironte shumë artin e fëmijëve.</p> <p>Të dy janë piktorë modernë. Kandinskij ilustronte organizmat mikroskopikë, insektet etj. dhe, ashtu si edhe Kleja, u pasionua shumë nga skenat organike të embrionologjisë, zoologjisë dhe botanikës.</p>
---



Mësuesi/ja fton nxënësit të vëzhgojnë dy pikturat dhe të kërkojnë format gjeometrike dhe natyrale. Nxënësit japin mendimet e tyre duke u nisur edhe nga titujt e pikturave (cilat forma dominojnë më shumë ose që janë përdorur më shumë herë).

### Realizimi i kuptimit:

Mësuesi/ja shpjegon pikturën e Kandinskij dhe evidenton format më të përdorura.

- *Meqenëse piktura edhe titullin e ka “Harqe që mbizotërojnë”, në të ka shumë harqe dhe forma të tjera të llojeve dhe madhësive të ndryshme. Ka rrethorë, drejtkëndorë, trekëndorë dhe forma organike. Ka përdorur edhe vijat të ndryshme. Në këtë pikturë ka edhe forma mikroskopike të kafshëve të detit, si dhe forma të tjera mikroorganizmash, që herë duken si shenja e herë si simbole. Ngjyrat e pikturës paraqiten në nuancat pastel dhe kjo ndoshta ka të bëjë me faktin që piktori kishte një vizion optimist dhe paqësor për të ardhmen me shpresën e rilindjes dhe ripërtëritjes.*

Mësuesi/ja shpjegon pikturën e Pol Klesë.

- *Ky piktor ka përdorur gjithashtu format gjeometrike katrorin, trekëndorin dhe imazhi që na jep është më i kuptueshëm, në të dallohet mali, shtëpitë, oborri. Edhe pse elementet e kopshtit janë të dukshme qartë, është e qartë prirja e piktorit drejt abstraksionizmit. Kleja këtu, ndryshe nga Kandinskij, ka përdorur vetëm format gjeometrike.*

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të gjejnë format e përdorura nga piktorët., duke i rrethuar lehtë me laps në libër, duke bashkëpunuar me shokun ose shoqen e bankës. Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të krahasojnë veprat e dy piktorëve dhe të gjejnë se cili nga ata ka përdorur më shumë forma gjeometrike, dypërmasore, organike. Mësuesi/ja duhet të saktësojë që piktorët nga format gjeometrike krijojnë edhe forma të tjera (këto janë thënë te mësimi i mëparshëm).

### Përforcimi i njohurive:

Më pas mësuesi/ja e ndan klasën në grupe me nga katër vetë. Udhëzon nxënësit të analizojnë pikturat e Kandinskijit dhe Klesë, duke dalluar figurat dypërmasore. Në një fletë secili grup vizaton një grafik me ndarje aq sa forma dypërmasore ka në pikturë.

Fiton grupi që ka gjetur më shumë forma gjeometrike. Nxënësit nxjerrin në pah rëndësinë e veçantë të formave dypërmasore gjeometrike në art.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre.

**Detyra:** Nxënësi zgjedh një nga detyrat e rubrikës “Ushtrohuni”. Për nxënësit e pasionuar, mësuesi/ja jep modele pikturash (afër moshës së nxënësit), ku ata të ushtrohen me stilin e pikturës së këtyre dy piktorëve të mëdhenj.

Të krijosh sipas  
Kandinskijit



Të krijosh sipas  
Pol Klesë



<b>Planifikimi i orës mësimore – 5</b>			
<b>Tematika:</b> Gjuha dhe komunikimi artistik	<b>Lënda:</b> Art pamor	<b>Tema:</b> Ngjyra	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</b>		<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit</b> – Nxënësi/ja percepton ngjyrat si mjet artistik.</li> <li>• <b>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</b> – Nxënësi/ja përdor ngjyrat si mjet artistik, si dhe kupton mundësitë shprehëse.</li> <li>• <b>Kompetenca e të menduarit</b> – Nxënësi/ja vlerëson rëndësinë e ngjyrës në artin pamor.</li> </ul>		<b>Nxënësi/ja:</b> ✓ njihet me karakteristikat shprehëse të ngjyrave dhe klasifikimin e tyre; ✓ eksperimenton, fiton aftësi në përdorimin e teknikës së akuaelit nëpërmjet përzierjes së ngjyrave parësore, të ngrohta e të ftohta etj.; ✓ përcakton nëpërmjet krijimit të tij/saj rolin e spektrit të ngjyrave.	
<b>Mjetet e punës:</b> fletore vizatimi, laps HB, gomë, akuarele, penela, gota plastike, ujë, figura ilustruese etj.			
<b>Burimet:</b> Teksti <i>Art pamor 6</i>		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuha, fizika, historia	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b> <i>Diskutim, Marrëdhënia pyetje- përgjigje, Vëzhgim</i> <i>Punë e pavarur, Krijimtari artistike</i> <i>Analizë, Vlerësim, krahasim, interpretim</i>			

### Përshkrimi i situatës

*Diskutim.* Mësuesi/ja ka përgatitur më parë rrethin e ngjyrave në një karton (një rreth me gjashtë ndarje të barabarta, ku secila ndarje i përket ngjyrave të spektrit, tre parësore dhe tre dytësore).

*Marrëdhënia pyetje- përgjigje.* Mësuesi/ja pyet nxënësit për rrethin e ngjyrave pasi e njohin më parë dhe rikujton cilat janë ngjyrat parësore. Organizon një bisedë në formën e metodës *stuhi mendimesh* rreth ngjyrave parësore që të shoqërohen me objektet me të njëjtën ngjyrë dhe shkruan mendimet e nxënësve në tabelë. P.sh.:

- **e verdha** – dielli, limoni, lule et
- **bluja** – deti, uji, xhinsit;
- **e kuqja** – molla, zjarri, trëndafilat, zemrat.


Gjithashtu, ata tregojnë për ndjesinë që i jep secilit një ngjyrë e caktuar, si gëzim, trishtim, zemërim, nxehtësi etj. Mësuesi/ja merr një bluzë të kuqe dhe fton nxënësit të shohin se çfarë ndodh me të nëse e vendosim në dollap dhe më pas e vendosim afër dritares.

– *A duket e kuqja njësoj në secilin vend? (Jo.)*

Mësuesi/ja ndihmon nxënësit të dalin në përfundimin se *ngjyra ndryshon nga sasia e dritës që e bie mbi objektin*. Kjo ndodh edhe në natyrë. Kemi disa lloje të gjelbrash ose të verdhash etj. Mësuesi/ja me rrethin e përgatitur u kërkon nxënësve të emërtojnë ngjyrat në parësore dhe dytësore, të ngrohta e të ftohta, gjithmonë duke drejtuar bisedën nëpërmjet pyetjeve, që nxënësit t'i dallojnë ato konkretisht.

Pyet nxënësit për pikturën e Kandinskijt:

– *Çfarë ngjyrash ka përdorur piktori?*



### Realizimi i kuptimit

Vëzhgim. Mësuesi/ja shpjegon konceptet e rëndësishme të mësimit.

#### Ç’është ngjyra?

- Ngjyra është një ndjesi që prodhohet prej rrezeve të ndryshme të dritës me gjatësi vale të ndryshme.

Mësuesi/ja jep një shembull për këtë.

- Nëse në një liqen do të hedhim një gur, çfarë do të ndodhë? (Rreth e përçark gurit do të përhapen si valë rrathë uji nga më i vogli deri te më i madhi).

Mësuesi/ja pret përgjigjet e nxënësve pa i ndërprerë dhe më pas shpjegon.

- E njëjta dukuri ndodh me ngjyrat. Ato përhapen si valë me gjatësi të ndryshme. Drita e diellit është e bardhë, por, duke kaluar nëpërmjet prizmit ajo zërthehet në ngjyrat e ylberit. Këtë zbulim e bëri fizikanti Isak Njuton.

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- A duken gjithmonë njësoj ngjyrat e objekteve që kemi përreth dhe në natyrë?

- Nga se varet ngjyra e një objekti? (Nga burimi i dritës, nga këndvështrimi ynë, nga stinët, nga momenti).

- P.sh.: gjethet ndryshojnë ngjyrë sipas stinëve. Qielli nuk është njësoj në çdo stinë apo edhe në çdo orë të ditës. Ose edhe kur koha është me diell ose kur është e vranët, kur bie shi etj.

Pra, ngjyrat dalin si rezultat i dritës së diellit dhe prandaj varen nga shumë faktorë.

#### Cilat janë ngjyrat parësore dhe pse quhen të tilla?


Mësuesi/ja pyet nxënësit dhe pret përgjigjet e tyre.

- Cilat janë ngjyrat parësore? (E kuqe, e verdhë, blu.)

- Pse quhen të tilla?

- Kur Njutoni zbuloi spektrin e ngjyrave, kuptoi se tri ishin ngjyrat kryesore dhe të gjitha të tjerat dilnin nga këto tri ngjyra. Pra, e kuqja, e verdha dhe bluja janë ngjyra parësore, sepse ato nuk mund të krijohen nga ngjyra të tjera, ndërsa nga bashkimi i tyre dalin dhe ngjyrat dytësore: portokalli, e gjelbër dhe lejla.

- Te rrethi i ngjyrave ngjyrat që janë në të kundërt të rrethit quhen ngjyra plotësuese.



Mësuesi/ja shpjegon se ngjyrat e spektrit janë 100% të pastra. Më pas fton nxënësit që të provojnë vetë të përziejnë ngjyrat parësore si modeli i dhënë dhe bën shpjegimet e rastit.

- Po të vihet re përzierja e ngjyrave parësore bëhet në sasi të barabartë nga të dyja ngjyrat.

- Nëse përziejmë një ngjyrë parësore dhe një dytësore, atëherë ngjyra që del quhet e ndërmjetme, sepse merr nga të dyja. P.sh.: E kuqe + portokalli = e kuqe në portokalli etj. Kjo është e qartë edhe te modeli i dhënë në tekst.

Ngjyrat kanë tri cilësi:

- **emërtimi i ngjyrave** (e kuqe, blu etj.) është një element i rrethit të ngjyrave;

- **vlera** – shkalla e bardhë e zisë së një ngjyre, ku e bardha është vlera më e zbehtë dhe e zeza është vlera më e errët;

- **intensiteti** - pastërtia e një ngjyre. Ngjyrat e spektrit



Shkalla tonale e ngjyrës blu një peizazh me shkallën tonale të ngjyrës blu.

kanë pastërtinë maksimale. Nëse një ngjyrë e përziejme me të bardhë ose më të zezë ne ndryshojmë nuancën e saj, pra, e bëjmë ose më të hapur ose më të errët. Kjo bën që ngjyra të humbasë intensitetin, pra pastërtinë.

### Cilat janë ngjyrat e ngrohta e të ftohta dhe pse klasifikohen si të tilla?

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Si mund t'i klasifikojmë ngjyrat? (Të ngrohta e të ftohta.) Pse quhen të tilla?

Nxënësit japin mendimet e tyre sipas njohurive që kanë nga klasat e mëparshme.

- Ngjyrat që anojnë nga e kuqja dhe e verdha quhen të ngrohta.

- Ngjyrat që anojnë nga bluja e gjelbra dhe violeti quhen të ftohta. Kjo varet edhe nga sasia e ngjyrës, sepse, nëse ka më shumë të verdhë se blu, atëherë e gjelbra anon nga e ngrohta.

*Punë e pavarur.* Nxënësit mund të eksperimentojnë vetë me ngjyrat, duke bërë përzierje të ndryshme. Me teknikën e akuarelit përzierja e ngjyrave arrihet mjaft mirë.

Mësuesi/ja fton nxënësit në pjesën e krijimtarisë dhe u jep atyre alternativat. Mund të krijojnë duke përdorur shkallën tonale të një ngjyre si te peizazhi më sipër.

Nxënësit mund të krijojnë me ngjyrat e ngrohta e të ftohta si te modeli i dhënë me gjethe, ose te modeli me pemë, ku nga njëra anë është vendosur pema mbi ngjyrat e ngrohta dhe te tjetra mbi ngjyrat e ftohta. Ata mund të krijojnë edhe një kolazh me ngjyrat e ngrohta e të ftohta me gazeta të vjetra dhe të grisin vetëm pjesët që përmbajnë këto ngjyra. Kjo do t'i ndihmojë nxënësit të dallojnë ndryshimin midis ngjyrave të ngrohta e të ftohta.



Te loja me ngjyrat veprohet në këtë mënyrë: në një fletë vizatimi nxënësit shkruajnë diagonal emrin e tyre. Kthehet fleta në të kundërt dhe e shkruajnë emrin përsëri diagonal, duke u mbivendosur. Më pas nxënësi/ja ngjyros sipas dëshirës, duke përdorur grupin e ngjyrave që dëshiron, parësoret, dytësoret. Nxënësit punojnë të pavarur.

### Përforcimi njohurive

Mësuesi/ja fton nxënësit të vëzhgojnë krijimet e bëra. Ata dalin në përfundimin se drita e diellit zërthehet nëpërmjet prizmit në ngjyrat e ylberit, parësoret, dytësoret, të ngrohta e të ftohta. Përcaktojnë edhe rolin e rëndësishëm të ngjyrave në krijimtarinë artistike.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre.

**Detyra:** Nxënësi zgjedh një nga detyrat e rubrikës "Ushtrohuni".

<b>Planifikimi i orës mësimore – 6</b>			
<b>Tematika:</b> Gjuha dhe komunikimi artistik	<b>Lënda:</b> Edukim figurativ	<b>Tema:</b> Sipërfaqja, tekstura	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:</b>		<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit</b> - Nxënësi përshkruan atë që shikon dhe prek, me termat se si e shikon dhe e ndjen sipërfaqen.</li> <li>• <b>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</b> - Nxënësi zgjedh sipas dëshirës një krijim që të përmbushë preferencat e tij/saj.</li> <li>• <b>Kompetenca për jetën</b> - Nxënësi hulumton botën përreth dhe jep gjykimin e tij/saj rreth sipërfaqes dhe teksturës.</li> </ul>		<b>Nxënësi:</b> ✓ identifikon shembuj të ndryshëm të sipërfaqeve në natyrë; ✓ eksploron llojet e sipërfaqeve në natyrë; ✓ interpreton teksturën në një krijim mbi sipërfaqe dy dhe tri-dimensionale.	
<b>Mjetet e punës:</b> fletore vizatimi, laps HB, gomë, pastele (bojëra dhjami), penela, karbon, gazeta, plastelinë, copa, ngjitës, figura ilustruese			
<b>Burimet:</b> Teksti – <i>Arti pamor 6</i>		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Biologjia, Gjuha	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b> <i>Diskutim, Marrëdhënia pyetje–përgjigje, vëzhgim punë e pavarur, krijimtari artistike</i> <i>Analizë, vlerësim, krahasim, interpretim</i>			

**Përshkrimi i situatës:**

*Marrëdhënia pyetje–përgjigje.* Mësuesi/ja fton dy nxënës pranë tabelës dhe njëri i lidh shokut ose shoqes sytë me një shall. Nxënësi që është pa shall e udhëheq shokun të prekë objekte të ndryshme në klasë. P.sh.: murin, derën, bankat etj. Ndërkohë nxitet nxënësi me sy të mbyllur të dallojë sipërfaqen (teksturën) e tyre. Nxënësi përshkruan atë që prek: *e lëmuar, e ashpër* etj.

*Vëzhgim.* Mësuesi/ja fton nxënësit në një bashkëbisedim për llojet e sipërfaqeve. Nxënësit flasin për përvojat e tyre. Mësuesi/ja shkruan një lloj sipërfaqeje dhe nxënësit thonë të kundërtën e saj, pra përdorin antonime. P.sh.;

- **e ashpër** – e lëmuar Krahas këtyre mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të japin shembuj
- **e butë** – e fortë objekteve për çdo sipërfaqe të përmendur.
- **e thatë** – e njomë etj.

Mësuesi/ja del në përfundimin se çdo trup ka një sipërfaqe të caktuar të ndryshme nga një trup tjetër. Krijimi i një sipërfaqe të caktuar në pikturë dhe skulpturë quhet **teksturë**.

**Realizimi i kuptimit:**

Mësuesi/ja shpjegon nëpërmjet shembujve konceptet kryesore të mëimit: ç’është sipërfaqja e tekstura, si dhe rëndësinë që kanë ato në vizatim, pikturë, skulpturë.

**Ç’është sipërfaqja?**

Mësuesi/ja pyet nxënësit për shprehjen: “Sipërfaqja është “lëkura” që mbulon trupat”.

Duke u nisur nga momentet e para ku nxënësit preknin objektet me sy të mbyllur, mësuesi/ja i lë të lirë nxënësit të japin mendimet e tyre dhe duhet dalë në përfundimin se sipërfaqet e kuptojmë kryesisht nëpërmjet shqisës së të parit dhe të prekurit. Prandaj ne dallojmë objektet nga njëri-tjetri (frutat, perimet, llojet e veshjeve, prej pambuku, linoje, akriliku, leshi etj.)

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të japin shembuj të llojeve të sipërfaqeve të objekteve, frutave, zogjve dhe kafshëve, të murit, të pllakave të dyshemesë, të dollapit etj:

Qelqi – i lëmuar, rëra – e kokrrizuar, veshjet – e lëmuar, e butë etj, lëvorja e pemës – e ashpër, portokalli – me pore, sfungjeri – i butë, zogu – me pupla, macja – me qime, muri – i fortë etj.

Mësuesi/ja shkruan në tabelë në dy kolona. Ne rreshtin e parë nuk shkruan gjë. Fillon dhe grupon në njërën anë sipërfaqet natyrore dhe në tjetrën artificialet.


Pyet nxënësit:

- Ku i gjejmë sipërfaqet në kolonën e parë?
- Ku i gjejmë sipërfaqet në kolonën e dytë?

Mësuesi/ja shkruan përgjigjet e nxënësve në tabelë.

- Pra, çdo trup ka sipërfaqen e tij të caktuar.

**Ç’është tekstura dhe si realizohet ajo në vizatim, pikturë, skulpturë?**



Sipërfaqet natyrore	Sipërfaqet artificiale
Rëra	Qelqi
Lëvorja e pemës	Muri
Portokalli	Pllakat
Macja	Dollapi
Zogu	Veshjet



Mësuesi/ja paraqet modelet dhe pyet nxënësit se çfarë paraqesin këto pamje, mjetet dhe teknikën që kanë përdorur artistët dhe i le të lirë të japin mendimet e tyre.

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Çfarë duan të na japin artistët nëpërmjet këtyre punëve? (Lloje të ndryshme sipërfaqesh.)
- Nëse duam të paraqesim sipërfaqen e një objekti me teknika dhe mjete të ndryshme artistike, atëherë ne kemi krijuar teksturën e tij.

Mësuesi/ja, pasi ka dëgjuar mendimet e nxënësve, saktëson si më poshtë:

- 1. Te pamja e parë kemi lloje të ndryshme teksturash të krijuara nëpërmjet kombinimit të vijave të lapsit.
- 2. Te pamja e dytë kemi një pikturë, ku paraqet puplën e palloit të realizuar me bojëra vaji, ku është ruajtur trashësia e bojës.




- 3. Te pamja e tretë kemi dy skulptura të realizuara me gdhendje.

Pra, në këto pamje kemi lloje të ndryshme sipërfaqesh: natyrale ose artificiale, në vizatim, pikturë dhe skulpturë, të realizuar me teknika dhe mënyra të ndryshme.

*Krijimtari artistike.* Mësuesi udhëzon nxënësit që të marrin me vete mjetet e artit dhe me rregull dalin në oborrin e shkollës. Secili e palos fletën në mënyrë të tillë që të ketë 8 ndarje të barabarta. Udhëzohen nxënësit që të eksplorojnë sipërfaqe të ndryshme rreth e rrotull duke e vendosur fletën mbi një sipërfaqe të caktuar dhe nxënësi me pastel ngjyros, duke e mbajtur pastelin rrafsh me fletën. Çdo ndarje të ketë një sipërfaqe të caktuar dhe një ngjyrë të caktuar, ose mund të bëhet edhe me karbon si modeli i dhënë më poshtë.

Këtë punë nxënësit mund ta bëjnë edhe me plastelinë duke e ngjeshur me dorë dhe duke e vendosur sipër sipërfaqeve të ndryshme në natyrë, ose edhe duke krijuar vetë objekte me tekstura të ndryshme sipas dëshirës. E rëndësishme është që nxënësit të interpretojnë me teknikën që parapëlqejnë dhe që ndjehen më mirë.



**Përforcimi njohurive:**

*Analizë, vlerësim, krahasim, interpretim.* Nxënësit, pasi hetuan sipërfaqet në natyrë dhe krijuan tekstura të ndryshme, nxjerrin përfundimet e veta sipas përvojave që patën gjatë orës së mësimit që sipërfaqja dhe tekstura janë shumë të rëndësishme për krijimtarinë artistike dhe e bëjnë më interesante një vepër arti.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre.

**Detyra:** Nxënësi zgjedh një nga detyrat e rubrikës “Ushtrohuni”.

Për nxënësit e pasionuar, mësuesja mund të paraqesë edhe lloje të ndryshme teksturash, që ata t’i realizojnë, nëse kanë dëshirë.



teksturë me vizatim




teksturë me copë dhe bojë




teksturë me rrjetë dhe bojë



teksturë me gazeta



teksturë në skulpturë

<b>Planifikimi i orës mësimore – 7</b>			
<b>Tematika:</b> Gjuha dhe komunikimi artistik	<b>Lënda:</b> Art pamor	<b>Tema:</b> Drita dhe hija	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</b>		<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit</b> - Nxënësi/ja eksploron dritëhijen e objekteve.</li> <li>• <b>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</b> - Nxënësi/ja shprehet nëpërmjet vëllimit me dritëhije.</li> <li>• <b>Kompetenca qytetare</b> - Nxënësi/ja gjen parapëlqimet e veta ndaj teknikave të ndryshme.</li> </ul>		<b>Nxënësi/ja:</b> ✓ përcakton nga vjen burimi i dritës dhe si krijohet hija e objektit; ✓ krijon vlerat e dritë hijes nëpërmjet vizatimit me laps; ✓ zbulon se hija i jep vëllimin figurave dhe mban qëndrim pozitiv ndaj krijimtarisë artistike.	
<b>Mjetet e punës:</b> fletore vizatimi, laps HB, gomë, figura ilustruese, elektrik dore, frutë, vezë			
<b>Burimet:</b> Teksti – <i>Art pamor 6</i>		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Histori, Fizikë	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b> <i>Diskutim, marrëdhënia pyetje- përgjigje, vëzhgim punë e pavarur, krijimtari artistike</i> <i>Analizë, vlerësim, krahasim, interpretim</i>			
<p><b>Përshkrimi i situatës:</b></p> <p>Mësuesi/ja ka siguruar më parë një elektrik dore dhe një sferë ose diçka të ngjashme me të, si një frutë etj. <i>Marrëdhënia pyetje- përgjigje.</i> Mësuesi/ja fton nxënësit në një bisedë rreth dritës dhe natës, si duken objektet. Dritën e dorës e vendos në pozicione të ndryshme mbi sferën dhe pyet çdo herë nxënësit se çfarë ndodh.</p> <p><i>Vëzhgim.</i> Nxënësit flasin për efektet e dritës mbi objekt dhe çfarë ndodh (objekti lëshon hije mbi tavolinë). Mësuesi/ja drejton bisedën në mënyrë që të dallohet koncepti i hijes së objektit dhe i hijes së hedhur. Mësuesi/ja vizaton në tabelë një shembull të sferës me diellin.</p> <div style="text-align: center;">  </div> <p>Shpjegon se nëse ndryshohet burimi i dritës ndryshon edhe hija e objektit. Kjo demonstron në klasë edhe me dritën e dorës mbi sferën (mund të jetë edhe një kokërr vezë) ose mbi objektin. Mund të jepen drejtime të ndryshme të dritës dhe nxënësi/ja të gjejë nga duhet të jetë hija e tyre.</p> <p><b>Realizimi i kuptimit</b>                      Mësuesi/ja nëpërmjet shembujve jep konceptet kryesore të orës së mësimit.                      - <b>Ç’është hija?</b>                      Pyet nxënësit:</p>			



- Me çfarë e matnin kohën shekuj më parë?

(Me orën diellore). Figura 1.

- Po ju, a keni bërë ndonjëherë orë në rërë?



Hijet në një ditë me diell



Mëngjes, drekë, pasdrekë

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Çfarë ndodh me hijen tonë në orë të ndryshme të ditës, në mëngjes, drekë, pasdrekë?

(hija në mëngjes kur dielli lind është e gjatë, në drekë kur dielli është pingul hija është më e shkurtër, dhe në perëndim është më e gjatë).

- Pse ndodh kjo? (Për arsye se dielli nuk qëndron në një pozicion ai lind dhe perëndon në drejtime të ndryshme)

- Çfarë ndodh nëse e ndryshojmë burimin e dritës?

(Kur ndryshon burimi i dritës, ndryshon edhe drejtimi i hijes.)

Ndërkohë, me elektrikun e dorës mësuesi/ja ndryshon drejtimin e dritës dhe ndihmon nxënësit të qartësojnë idenë se drita dhe hija i japin formë objektit.

- Sa lloj hijesh kemi?

Mësuesi/ja fton nxënësit të komentojnë vizatimin me vezë mbi dritë hijen e tyre dhe ndalet te llojet e hijeve:

1.hija e objektit është pjesa e pandricuar e tij;

2.hija e hedhur hija që hedh objekti mbi sipërfaqen ku është vendosur ose edhe mbi objektet e tjerë. Kemi edhe reflektimin e dritës në objekt nga bazamenti tek objekti. Kjo duket qartë edhe tek vezët në pjesët e poshtme.

Te objektet kemi dritën dhe hijen maksimale kjo duket edhe te vezët.

Mësuesi/ja tregon përsëri shembullin me sferën dhe diellin.



- Si paraqitet dritëhija në art?

Mësuesi/ja ndalet te rëndësia e dritës dhe e hijes në art.

Në vizatim dritëhija arrihet nëpërmjet toneve bardhezi, në pikturë arrihet nëpërmjet ngjyrave, ndërsa në skulpturë dhe arkitekturë ato ndryshojnë nga vendi, ora, këndi i vështrimit, stinët, burimit të dritës etj. Në skulpturë dritëhija është një element që përcakton qartë vëllimet dhe format dhe është shumë i rëndësishëm burimi i dritës sepse nëse vendoset në mënyrën e gabuar atëherë vepra humbet interesin.

*Punë e pavarur.* Mësuesi/ja fton nxënësit të vendosin dy objekte mbi tavolina dhe t'i vizatojnë ato me dritë hije. P.sh. mund të jenë mjete mësimore, si goma, mprehësja e lapsit, një laps, vezë etj. Mund ta provojnë nga dy pika të ndryshme shikimi për të dalluar ndryshimin e dritës.

**Krijimtari artistike.** Nxënësit në fillim vizatojnë lehtë me laps objektet e zgjedhura, duke parë mirë nga buron drita (drejtimin e saj) dhe hijen tek objektet që do të vizatojnë. Kalimi nga drita në hije duhet të jetë gradual dhe jo i menjëhershëm.

**Përforcimi njohurive**

*Analizë, vlerësim, krahasim, interpretim.* Nxënësit japin një përmbledhje të vlerave artistike të dritëhijes si në pikturë, skulpturë dhe arkitekturë, si dhe përvojat e veta personale. Nxënësi/ja zbulon se hija i jep vëllimin figurave dhe mban qëndrim pozitiv ndaj krijimtarisë artistike.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre.

**Detyra:** Nxënësi zgjedh një nga detyrat e rubrikës “Ushtroni”.

**Planifikimi i orës mësimore – 9**

<b>Tematika:</b> Gjuha dhe komunikimi artistik	<b>Lënda:</b> Art pamor	<b>Tema:</b> Hapësira	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
--	-------------------------	-----------------------	--------------------------------------

<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>
--	---

<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit</b> - Nxënësi/ja identifikon llojet e hapësirës.</li> <li>• <b>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</b> - Nxënësi/ja është i aftë të klasifikojë objektet në hapësirë.</li> <li>• <b>Kompetenca për mjedisin</b> - Nxënësi/ja krijon ide për vendosjen estetike të objekteve në hapësirë.</li> </ul>	<p><b>Nxënësi/ja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>√ zhvillon perceptimin vizual të distancave dhe thellësisë;</li> <li>√ zbulon dhe paraqet në krijim raportet hapësinore midis objekteve: para/mbrapa; sipër/poshtë;</li> <li>√ vlerëson rolin e perspektivës në paraqitjen e hapësirës në një krijim artistik.</li> </ul>
--	--


**Mjetet e punës:** fletore vizatimi, laps HB, gomë, ngjyra të ndryshme, figura ilustruese.

<b>Burimet:</b> Teksti – <i>Art pamor 6</i>	<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Matematikë, Histori
---	--



**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**  
*Marrëdhënia pyetje- përgjigje, diskutim, vëzhgim  
 punë e pavarur, krijimtari artistike  
 Analizë, vlerësim, interpretim*

**Përshkrimi i situatës:**

Mësuesi/ja paraprakisht vizaton në tabelë thjesht një model të një katrori dhe të një shkronje.



*Marrëdhënia pyetje- përgjigje.* Mësuesi/ja vizaton në tabelë me ndihmën e perspektivës me një pikë ikje të shkronjës dhe të kubit. Nxit nxënësit të krahasojnë këto vizatime dhe të gjejnë ndryshimet. Nxënësit japin mendimet e tyre, duke u nisur edhe nga njohuritë e marra më parë.



**Vëzhgim.** Është e rëndësishme që mësuesi/ja të bëjë këto vizatime në mënyrë që nxënësi/ja ta ketë sa më konkrete perspektivën.

### Realizimi i kuptimit


Mësuesi/ja shpjegon konceptet e kyce të mësimit nëpërmjet shembujve të ndryshëm.

#### - Ç'është hapësira në pikturë dhe në skulpturë?

Mësuesi/ja fton nxënësit në një udhëtim imagjinar sikur të ishim milingona dhe zogj, si do na dukej bota nga këndvështrimi i tyre. Mësuesi/ja dëgjon mendimet e nxënësve pa i ndërprerë.

Mësuesi/ja ngre ndonjë nxënës me dëshirë për të dy rastet dhe mund të vizatojnë në tabelë secili sipas këndvështrimit të vet si miligona ose si zogju. Më pas jepen këta shembuj për ta ilustruar më mirë këtë koncept. Pyet nxënësit çfarë mendimi kanë për vizatimet.

Mësuesi/ja shpjegon se e gjithë përvoja jonë jetësore ka lidhje me hapësirë. Vetë hapësira është




trepërmasore. Në pikturë, vizatim hapësira e bën një imazh të sheshtë të duket sikur ka formë, nuk është e vërtetë, pra artistët përpiqen të japin iluzionin e hapësirës. Ndërsa në skulpturë, arkitekturë ajo është reale pra trepërmasore. Hapësira në pikturë është pozitive dhe negative. Si tek modeli më poshtë. Hapësira pozitive është vetë objekti, ndërsa hapësira negative është hapësira rreth objektit.

1. Shikimi me sytë e zogut. 2. Shikimi me sytë e milingonës.

Ka shumë mënyra që një artist i jep hapësirën e duhur një vepre arti:

**1. Mbivendosja** – të vendosësh një objekt përpara një tjetri kjo bën që objekti përpara të duket më i madh se tjetri. Kjo tregohet ne figurën poshtë.



**2.Ndryshimi i përmasave** – një objekt që është më i vogël duket sikur është në distancë të largët ndërsa objekti që është më i madh të duket më afër.




**3.Përdorimi i perspektivës** - paraqitja në art e objekteve trepërmasore mbi një sipërfaqe të sheshtë në mënyrë që të jepet përshtypja e duhur për lartësinë, gjatësinë, gjerësinë dhe pozicionin e tyre në marrëdhënie me njëri-tjetrin me saktësi. Pra, ashtu siç i sheh syri ynë.

Meritat për zhvillimin e perspektivës me një pikë ikje, që përdoret edhe sot nga artistët i takojnë artistit të Rilindjes Filippo Brunelleschi- t. Qëllimi i artistëve është të krijojnë iluzionin e hapësirës mbi një sipërfaqe të sheshtë.

Në klasën e 6 mësohet perspektiva me një pikë ikje, por atë e gjejmë me dy dhe tre pika ikje.

Shikoni shembullin.



#### - Ç'është vija e horizontit?

Si fillim mësuesja pyet nxënësit:

- Çdo të thotë për ju "Vija e horizontit", psh kur jemi në det?



Mësuesi/ja dëgjon përgjigjet e nxënësve.

Për të ndërtuar perspektivën në një vizatim si fillim duhet të bëjmë vijën e horizontit shpesh përshkruhet si vija që ndan qiellin me tokën. Kjo vijë është imagjinare. Në art ajo është e rëndësishme për paraqitjen e perspektivës. Në këtë vijë ne vendosim edhe pikën e ikjes që është pika e shikimit të artistit nga e cila ai shikon objektin gjatë pikturimit. Ajo përcakton se ku është vija e horizontit.

Mësuesi/ja për të konkretizuar paraqitjen e hapësirës nëpërmjet perspektivës bën një skicë të thjeshtë të rrugës me pemë duke përcaktuar vijën e horizontit dhe pikën e ikjes. Pyet nxënësit për objektet që janë afër pikës së ikjes (janë më të vogla) në krahasim me ato që janë larg pikës së ikjes (janë më të mëdha), kështu përforcohet koncepti afër dhe larg. Kjo evidentohet edhe nëpërmjet ngjyrës që do të thotë se objektet që janë larg bëhen më të zbehta në ngjyrë dhe objektet që janë afër bëhen më të dukshme në ngjyrë. Kështu krijohet ndjenja e thellësisë.

*Punë e pavarur.* Nxënësit ngjyrosin dhomën e Van Gogut sipas dëshirës. Ndërkohë mësuesi/ja flet pak për jetën e piktorit.






### Përforcimi njohurive

*Analizë, vlerësim, krahasim, interpretim.* Mësuesi/ja fton nxënësit të vëzhgojnë krijimet e bëra dhe i nxit të dalin në përfundimin se perspektiva luan një rol të rëndësishëm në paraqitjen e hapësirës. Në pikturë, vizatim ajo është dypërmasore, si në rastin tonë që e vizatuar në tabelë ose në fletë, pra në plan të sheshtë, ndërsa në skulpturë, arkitekturë ajo është tripërmasore. Pra, hapësira në një vepër arti e bën një imazh të sheshtë, të duket sikur ka formë.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre.

**Detyra:** Nxënësit, duke u bazuar te dhoma e Van Gogut, do të vizatojnë dhomën e tyre.



Çdo nxënës mund të shkruajë emrin e tij/saj në modelin e paraqitur dhe poshtë në të kundërt mund të bëhet edhe mbiemri dhe të gjitha vijat të bashkohen në një pikë.

### Planifikimi i orës mësimore – 10

<b>Tematika:</b> Gjuha dhe komunikimi artistik	<b>Lënda:</b> Art pamor	<b>Tema:</b> Baraspesha	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</b>		<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>● <b>Kompetenca e të menduarit</b> - Nxënësi/ja thellohet të dallojë llojet e baraspeshës.</li> <li>● <b>Kompetenca për jetën</b> - Nxënësi/ja krijon në përputhje me kërkesat e kohës.</li> <li>● <b>Kompetenca personale</b> - Nxënësi/ja kupton se asimetria është e kundërta e simetrisë dhe ku gjejmë zbatim në jetën e përditshme.</li> </ul>		<p><b>Nxënësi/ja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>√ dallon dhe zbulon llojet e baraspeshës në natyrë dhe në imazhe të ndryshme;</li> <li>√ aplikon në krijimet e veta llojet e baraspeshës;</li> <li>√ vlerëson rolin e simetrisë dhe asimetrisë në pikturë, skulpturë, arkitekturë.</li> </ul>	
<b>Mjetet e punës:</b> fletore vizatimi, laps HB, gomë, ngjyra të ndryshme, figura ilustruese.			
<b>Burimet:</b> Teksti – <i>Art pamor 6</i>		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Matematikë, gjuhë, fizikë	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>  <i>Marrëdhënia pyetje–përgjigje, diskutim, vëzhgim  punë e pavarur, krijimtari artistike  Analizë, vlerësim, interpretim</i></p>			

### Përshkrimi i situatës

**Marrëdhënia pyetje-përgjigje.** Mësuesi/ja ka siguruar më përpara disa fruta si një mollë, portokall, dardhë. Gjithashtu vendos në tabelë disa imazhet e një ndërtësimetrike të dyanshme, një vepër arti që të jetë asimetrike, një flutur etj., si dhe imazhe nga mobilimi i banesave ku të jenë llojet e baraspeshës (nga ndonjë revistë).

**Vëzhgim.** Mësuesi/ja pret frutat përgjysmë ose dhe më katërsh. Mësuesi/ja drejton pyetjet dhe në formën e një stuhi mendimesh Mësuesi/ja dëgjon përgjigjet e nxënësve. Nxit nxënësit të flasnin rreth imazheve në tabelë. Duke u nisur nga lënda e matematikës nxënësit japin përkufizimet e simetrisë.

Në tabelë vizaton p.sh. dy pemë një simetrike dhe një asimetrike. Nuk shkruan asgjë poshtë.



### Realizimi i kuptimit

Mësuesi/ja shpjegon konceptet kyçe të baraspeshës duke e lidhur në fillim me lëndët e tjera dhe duke dhënë shembujt përkatës.

#### - Ç'është baraspesha?

**Vëzhgim.** Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Sa lloj peshorësh kemi? (Me gurë, mekanike, elektronike.)

- Kur shkojmë në market dhe blini p.sh një kg mollë, çfarë bën shitësi, si e gjen peshën e saktë?


Pra, shitësi vendos portokallet në peshore dhe bën peshën e saktë që i kemi kërkuar.

- Si janë të dyja anët e peshores? (Të baraspeshuara.)

Nxënësit japin eksperiencat e veta.

- Po nëse ju kërkoni një kg mollë dhe shitësi ka marrë më shumë mollë se guri i peshës, çfarë ndodh? (Atëherë peshorja anon andej nga ka më shumë peshë.)

- Ku e gjejmë tjetër simetrinë në jetën e përditshme? (Në natyrë, në botën bimore, shtazore, në ndërtime, veprat e njeriut, në pasqyrim, shihni shembujt më poshtë.)



### Shembulli bazë për të kuptuar simetrisë është hunda dhe sytë.


#### - Sa lloj baraspeshash kemi?

Mësuesi/ja shpjegon se në art flasim me terma më specifike, si p.sh., baraspesha.

Në krijimtarinë artistike baraspesha është shumë e rëndësishme, sepse i jep veprës ndjenjën e ekuilibrit. Mësuesi/ja shpjegon me shembuj (te frutat dhe te imazhet e vendosura në tabelë).

Baraspesha është simetrike dhe asimetrike.






Nxënësit kanë njohuri për simetrinë nga vitët e mëparshme. Mësuesi/ja kthehet tek vizatimi i pemëve dhe i pyet nxënësit:

- Çfarë mund të themi për pemën e parë? (Është simetrike.)
- Çfarë mund të themi për pemën e dytë? (Është asimetrike.)

Duke i referuar pikturës “darka e fundit” e L. Da Viniçit, mësuesi/ja shpjegon se ç’do të thotë baraspeshë simetrike, duke përmbledhur edhe mendimet e nxënësve mbi simetrinë.



Kemi baraspeshë simetrike kur dy pjesë të të njëjtit lloj janë saktësisht të barabarta kundrejt aksit ose boshti ose një pike qendrore. Barazpesha është:

- **e dyanshme**, kur elementet përsëriten ndaj një aksi ose boshti (si tek piktura e da Viniçit);
- **rrethore**, kur elementet përsëriten rreth një pike qendrore (si te modelet më poshtë).

Mësuesi/ja nxit nxënësit të japin shembuj të ndryshëm të baraspeshës simetrike rrethore.



Pamjet më sipër na japin shembuj të baraspeshës rrethore në arkitekturë, vizatim dhe mobilimin e shtëpisë. Barazpesha është një element shumë i rëndësishëm edhe në fushën e dizajnit.

**- Cili është ndryshimi midis simetrisë dhe asimetrisë?**

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Cila fjalë është e kundërta e simetrisë? (Asimetria.)
- Si e kuptoni ju fjalën asimetri? (Mësuesi/ja kujton shembullin me pemë)

Në art e kundërta e baraspeshës simetrike është barazpesha asimetrike që mund të jetë e dyanshme, kur dy pjesët e një sipërfaqen e kompozimit nuk janë të barabarta dhe rrethore kur elementet vendosen në mënyrë të çrregullt rreth një pike qendrore.

Mësuesi/ja fton nxënësit të japin ndryshimin midis simetrisë dhe asimetrisë.

**- Pse veprat asimetrike ngjallin ndjenjën e lëvizjes?**



- Çfarë vini re te vepra 1 e Hokusait ,piktor japonez, dhe tek vepra 2 e Van Gogut?

- Nëse vizatojmë aksin e simetrisë, si janë të dyja anët e veprave? (Janë josimetrike.)

Nxënësit japin mendimet e tyre. Në këto dy vepra piktoret kanë përdorur baraspeshën asimetrike, sepse objektet kryesore nuk janë në qendër dhe të ngjallin ndjenjën e lëvizjes sepse syri ynë zhvendoset nga njëra pjesë tek tjetra. Kur themi baraspeshën asimetrike nuk nënkuptojmë parregullsi, por në art ky term do të thotë që elementet e veprës punojnë së bashku për ta bërë veprën sa më të këndshme për syrin.

Ka një ndjenjë lëvizjeje në asimetri dhe kjo është arsyeja që duket më interesante në art dhe në arkitekturë.


Asimetria të ofron liri, ajo nuk është e saktë si simetria. Ndonjëherë simetria mund të jetë e lodhshme për syrin.

- Çfarë ndryshimi ka midis baraspeshës simetrike dhe asaj asimetrike?

- Çfarë ndryshimi ka midis pikturës klasike dhe moderne?

Në veprat klasike baraspesha simetrike është me e spikatur, ndërsa në veprat moderne është më e spikatur baraspesha asimetrike.

Llojet e baraspeshave simetrike dhe asimetrike gjejnë zbatim edhe në jetën e përditshme në dizajn, në mobilim, në arkitekturë, në veshjet moderne, në zbukurimin e pjatave, në prerjet e flokëve etj.



**Punë e pavarur.** Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të aplikojnë llojet e baraspeshës në krijimet e tyre. Në një fletë mund të ilustrojnë me shembuj të thjeshtë njohuritë që morën për llojet e baraspeshave. Mësuesi/ja jep disa alternativa ku nxënësi/ja të aplikojë atë që i pëlqen.

### Përforcimi njohurive

**Analizë, vlerësim, krahasim, interpretim.** Mësuesi/ja fton nxënësit të vëzhgojnë krijimet e bëra dhe i nxit të nxjerrin përfundimin mbi rëndësinë e baraspeshës dhe se ku gjen zbatim ajo në art dhe në jetën e përditshme. Nxënësit evidentojnë dhe krahasojnë punimet simetrike dhe asimetrike.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre.

**Detyra:** Nxënësi zgjedh një nga detyrat e rubrikës “Ushtroni”.



## Tematika 2 – Teknika dhe procese

Planifikimi i orës mësimore - 1			
<b>Tematika:</b> Teknika dhe procese	<b>Lënda:</b> Art pamor 6	<b>Tema:</b> Vizatimi me laps dhe karbon	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>		<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit</b> - Nxënësi/ja përshtatet më këto dy mjete artistike.</li> <li>• <b>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</b> - Nxënësi/ja zbaton teknikën e lapsit dhe karbonit në krijimin e tij dhe kërkon rrugë të reja ndërthurjeje të teknikave.</li> <li>• <b>Kompetenca qytetare</b> - Nxënësi/ja diskuton dhe mbron idetë e tij/saj në lidhje me temën e dhënë.</li> </ul>		<b>Nxënësi/ja:</b> √ njihet me karakteristikat shprehëse të lapsit dhe karbonit; √ fiton aftësi në përdorimin e teknikës së lapsit dhe karbonit nëpërmjet mënyrave shprehëse të tyre; √ eksperimenton nëpërmjet ndërthurjes së teknikave të lapsit dhe karbonit.	
<b>Mjetet e punës:</b> fletore vizatimi, laps HB, gomë, vizore, karbon.			
<b>Burimet:</b> Teksti – Art pamor 6		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> kimi, fizikë.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b> <i>Diskutim, marrëdhënia pyetje–përgjigje, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, krahasim, interpretim.</i>			

### Përshkrimi i situatës

Mësuesi/ja porositi nxënësit një orë më parë që të sjellin karbonin dhe lapsat HB me vete. Prezanton para nxënësve lapsat dhe karbonin si mjete artistike.

Lapsat



### Realizimi i kuptimit:

*Marrëdhënia pyetje- përgjigje.* Mësuesi/ja shpjegon konceptet bazë të mësimit nëpërmjet shembujve dhe teknikave të ndryshme të punimit me këto dy mjete.

#### - Cilat janë veçoritë e vizatimit me laps?

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Cilin mjet shkollor përdorni më shumë gjatë ditës?
- Sa nga ju kanë përdorur sot më shumë stilolapsin, gomën, lapsin?
- Për çfarë e përdorim një laps?

Nxënësit përgjigjen nisur nga përvojat që kanë: lapsi përdoret për të shkruar, skicuar, vizatuar etj. Lapsi është një mjet që përdoret për të shkruar ose vizatuar dhe përmban një shkop të hollë grafiti ose substanca të ngjashme e përmbledhur në një copë të hollë prej druri ose i fiksuar në një mbështjellje cilindrike.

- Si nisen skicat e para të një punë artistike në pikturë, skulpturë, arkitekturë fillimisht?


Mësuesi/ja e nxit bisedën deri aty ku del në pah roli i lapsit. Lapsi është pikënisje për shumë vepra artistike.

Mësuesi/ja fton nxënësit që në një fletë të bardhë të provojnë trashësinë e lapsit, thjesht të shkarravisin.

- Çfarë vutë re në përdorimin e lapsit nëse ushtrojmë forcë?

Nxënësit japin mendimet e tyre.

Mësuesi/ja shpjegon që lapsat kanë numra sipas vlerës tonale (shihni figurën). Sa më i madh numri aq më shumë "nxin" lapsi. Për të vizatuar përdorim teknika të ndryshme me vija, me pika, me hijezime, me kryqëzim të vijave, me shtresa sipër njëra- tjetrës etj. (Shihni shembullin poshtë.)



- Nëse ushtrojmë shumë ç'forcë ndodh me majën e lapsit? (Thyhet.)

- Proveni ta fshini me gomë, mundeni?

Nxënësit dalin në përfundimin se sa më shumë forcë të ushtrojmë me lapsin maja thyhet dhe nuk fshihet mirë me gomë, ngelet gjurma e majës.

Me laps mund të bëjmë kalime shumë delikate nga drita në hije të një objekti falë shkallës tonale të tij. Mund të krijojmë tekstura të ndryshme dhe kombinime vizash të shumëllojshme (shihni figurën). Shumë artistë të famshëm kanë bërë kryevepra nga vizatimet me laps.

#### - Cilat janë përparësitë e vizatimit me karbon?

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Ç'do të thotë për ju fjala qymyr?

- Si përftohet qymyri? Përse përdoret ai?

- Kur është përdorur për vizatim? (Nëpër shpella.)

Nxënësit japin komentet e tyre duke u nisur nga njohuritë që kanë edhe nga lëndët e tjera.

Mësuesi/ja u shpërndan disa karbone (nëse ka) dhe fton nxënësit të njihen me të, duke bërë shenja të ndryshme në fletën e bardhë.

- Çfarë vutë re në përdorimin e karbonit?

- Po nëse e fshini me gomë ose me gisht?

Mësuesi/ja përmbledh mendimet e nxënësve:

- Karboni është shumë i zi, thërrmohet, dhe nuk fshihet lehtë me gomë, por me një copë leckë dhe me gisht "shkrihet".

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Çfarë ndryshimi kanë këto dy foto nga njëra- tjetra?


Pret përgjigjet e nxënësve dhe shpjegon se karbonin e gjejmë në dy forma, natyral dhe artificial.

Në fig. 1 kemi karbonin në formën natyrale, pra, shkop i karbonizuar. Por, ndryshe nga lapsi, atë nuk mund ta mprehim.

Në fig. 2 kemi lapsa të trashë me pluhur karboni të presuar dhe artificialë të cilët, mund t'i mprehim.



Natyre e qetë me laps



Kafshë në pozicione të ndryshme



Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Si mendoni, me çfarë janë bërë këto vizatime? (Me karbon).

- Në këto vizatime me karbon kemi teknika të ndryshme të mbajtjes së karbonit, me majë, i shtrirë. Por, ne mund të përdorim edhe gishtat për të përhapur kalimin nga drita në hije dhe për të krijuar efekte, por pastrohet lehtë.

Mësuesi/ja jep disa alternativa për nxënësit që të krijojnë me teknikën e lapsit ose të karbonit.

Nxënësit punojnë të pavarur duke zbatuar në fletë mundësitë shprehëse të lapsit dhe karbonit. Mësuesi/ja u sugjeron nxënësive që të eksperimentojnë me teknikën e lapsit dhe karbonit, njëkohësisht edhe ndërthurjen e tyre. Në fillim nxënësit të bëjnë një vizatim të thjeshtë me laps dhe me karbon, të krijojnë efektet e dritë- hijes. Nxënësit duhet të zgjedhin vetë objektin e vizatimit sipas dëshirës.



#### **Përforcimi i njohurive:**

**Analizë, vlerësim.** Nxënësit dalin në përfundimin se cila teknikë ju pëlqen më shumë dhe pse. Gjithashtu, vlerësojnë mundësitë shprehëse të secilës teknikë.

**Krahasim.** Loja – Konkurs “Lapsi ose karbonit”.

Mësuesi/ja ndan klasën në dy grupe dhe shkruan në tabelë “Lapsi ose karbonit”, njëri grup do mbrojë teknikën e lapsit dhe tjetri të karbonit. Bën dy kolona në tabelë. Për pak minuta, nxënësit mbledhin cilësitë për secilën teknikë dhe mbrojnë argumentet e tyre.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre.

**Detyra:** Nxënësi/ja zgjedh sipas dëshirës një nga detyrat e dhëna në rubrikën “Ushtrohuni”.

<b>Planifikimi i orës mësimore - 2</b>			
<b>Tematika:</b> Teknika dhe procese	<b>Lënda:</b> Art pamor 6	<b>Tema:</b> Punojmë me laps	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>		<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kompetenca personale</b> - Nxënësi/ja zhvillon besimin te vetja nëpërmjet përdorimit të teknikës së lapsit.</li> <li>• <b>Kompetenca e të menduarit</b> Nxënësi/ja merr dhe përpunon me përgjegjësi njohuritë vizuale në mënyrë krijuese.</li> <li>• <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b> Nxënësi/ja shfrytëzon në mënyrë krijuese dhe vlerëson mundësitë shprehëse të lapsit.</li> </ul>		<b>Nxënësi/ja:</b> ✓ fiton aftësi nëpërmjet përdorimit të teknikës së lapsit; ✓ krijon dukë përdorur gradacionin tonal të lapsit; ✓ vlerëson mundësitë shprehëse të lapsit.	
<b>Mjetet e punës:</b> fletore vizatimi, laps HB, gomë.			
<b>Burimet:</b> Teksti – Art pamor 6		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b>	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b> <i>Diskutim, marrëdhënia pyetje–përgjigje, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, krahasim, interpretim.</i>			

**Përshkrimi i situatës:**

Mësuesi/ja ka përgatitur më parë dy kartonët në formën e shkronjës L. Ndërkohë, vendos në tabelë një natyrë të qetë dhe një pejsazh.

**Realizimi i kuptimit:**

Marrëdhënia pyetje- përgjigje. Mësuesi/ja pyet nxënësit:  
- Çfarë bëni ju kur doni të filloni një vizatim ose një pikturë?

Pret me durim përgjigjet e nxënësve.

**- Ç’është një natyrë e qetë?**

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Çfarë paraqesin këto dy krijime artistike/?




Fig.1 Natyrë e qetë me laps.



Fig.2 Natyrë e qetë me bojëra vaji.



Mësuesi/ja shpjegon se sot do të ndalemi te vizatimi me laps. Pyet nxënësit:

- Çfarë objkesh ka vizatuar artisti tek krijimi me laps dhe tek krijimi me bojra vaji?

Nxënësit emërtojnë objektet që shohin. Mësuesi/ja shpjegon që kur në një krijim artistik artistët paraqesin objekte të palëvizshme, atëherë, ky krijim quhet “natyrë e qetë”.

- Ç’është kompozimi?

- A ndryshojnë këto krijime artistike nga njëra- tjetra për nga përmbajtja dhe vendosja e objekteve? Nxënësit japin komentet e tyre për këtë pyetje.

Mësuesi/ja shpjegon se mënyra e vendosjes së objekteve quhet kompozim. Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Si mund të kompozojmë si duhet? Si mendoni?

Nxënësit shprehen lirshëm ashtu siç e mendojnë vetë. Mësuesi/ja tregon para klasës dy kartonët e përgatitur më parë dhe demonstroi se si përdoren (fig.1). Ndonjëherë, mund të përdoren edhe duart (fig.2), kur nuk kemi kartonët që ndryshe mund t’i quajmë “gjetësit e pamjes”. Më pas e hedh në letër atë që ke përcaktuar ose që të ka pëlqyer më shumë. Kjo është një mënyrë se si mund të gjesh kompozimin më të mirë, por ka edhe një mënyrë tjetër që quhet “rregulli i trashit” (fig. 3), një fletë transparente e ndarë me nga tri pjesë të barabarta në çdo tre rreshta. Më pas e vendos përpara vetes, aty ku të pëlqen pamja dhe vizaton me kujdes sipër saj. Ndërkohë edhe fletën e vizatimit e ke ndarë në nëntë pjesë si te modeli që ke përgatitur më parë. Në çdo ndarje që vizaton duhet të jetë, pothuajse, identike me atë te fleta e tejdrukshme. Kjo të ndihmon të mos gabosh gjatë kompozimit.



“Gjetësi i pamjes” në formën e shkronjës L



*Krijimtari artistike.* Mësuesi/ja udhëzon nxënësit se përpara se të fillojnë punën duhet të mendojnë për kompozimin e tij, në mënyrë që të ketë ajër në vendosjen e objekteve. Kjo do të thotë që objektet të mos bëhen as shumë të mëdha, por, as shumë të vogla. Më pas duhet të studiojnë modelin dhe të përcaktojnë llojin e vijave që do të përdorin. Duhet pasur kujdes edhe kur të fillojnë objekte me dritë hije që të vijë në mënyrë graduale dhe të sfumuar, për këtë përdoret goma, mollëzat e gishtave.

Nxënësit punojnë të pavarur.

“Rregulli i trashit” mbi fletën e tejdrukshme

**Përforcimi njohurive:**

*Analizë, vlerësim.* Nxënësit analizojnë krijimet e bëra dhe vlerësojnë mundësitë shprehëse të lapsit.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre.

**Detyra:** Nxënësit mund të kompozojnë 2- 3 objekte, si: vazo, enë, fruta, lule etj., duke i vendosur ato në mënyra të ndryshme. Më pas t’i skicojnë hollë me laps dhe t’i punojnë me dritëhijet.

<b>Planifikimi i orës mësimore - 3</b>			
<b>Tematika:</b> Teknika dhe procese	<b>Lënda:</b> Art pamor 6	<b>Tema:</b> Punojmë me frotazh.	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>		<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>● <b>Kompetenca personale</b> Nxënësi/ja përfshihet në mënyrë aktive në njohjen me teknikën e re të frotazhit.</li> <li>● <b>Kompetenca e të menduarit</b> Nxënësi/ja merr dhe përpunon me përgjegjësi njohuritë vizuale në mënyrë krijuese me teknikën e frotazhit.</li> <li>● <b>Kompetenca qytetare</b> Nxënësi/ja respekton punën e vet dhe të të tjerëve.</li> </ul>		<b>Nxënësi/ja:</b> ✓ prezantohet me teknikën e frotazhit; ✓ zbaton fërkimin e trupave për krijim artistik; ✓ analizon dhe vlerëson arritjet e teknikës së frotazhit në punën e vet dhe të të tjerëve.	
<b>Mjetet e punës:</b> fletore vizatimi, karbon, pastelev, laps HB.			
<b>Burimet:</b> Teksti –Art pamor 6		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> fizikë, histori.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b> <i>Diskutim, marrëdhënia pyetje–përgjigje, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, krahasim, interpretim.</i>			

**Përshkrimi i situatës:**

*Marrëdhënia pyetje–përgjigje* Mësuesi/ja vendos disa monedha hekuri me madhësi të ndryshme, një karbon dhe një fletë të bardhë mbi tavolinë. Ndërkohë, u kërkon nxënësve të vendosin mbi bankë edhe ata ndonjë monedhë nëse kanë dhe t'i prekin me dorë, t'i vëzhgojnë.

**Realizimi i kuptimit:**

*Marrëdhënia pyetje- përgjigje.* Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Çfarë mund të bëhet me këto objekte që janë mbi tavolinë?

Nxënësit japin komente e tyre, mësuesi/ja i dëgjon pa i ndërprerë. Fokusohet te komentet e nxënësve për lëvizjen e lapsit mbi letër për të nxjerrë gjurmën e monedhës poshtë letrës. Fton nxënësit që ta provojnë vetë këtë gjë. Nxënësit japin përvojat e veta.

- Ç'do të thotë fjala “frotazh”?

Mësuesi/ja shpjegon se kjo është një teknikë e vjetër që quhet frotazh dhe vjen nga frëngjishtja që do të thotë fërkim. Artisti modern, surrealist, *Maks Ernst* ishte i pari që e shpiku këtë teknikë. Frotazhi është një vepër arti që përmban format dhe teksturat të prodhuara nga fërkimi.

- Si realizohet frotazhi?

Rikujtohen llojet e sipërfaqeve dhe teksturave.

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Nëse do ta vendos fletën mbi bankë dhe ta fërkoj lapsin mbi të, çfarë duket? (Asgjë).



Mësuesja del në përfundimin se frotazhi realizohet nga fërkimi i lapsit, karbonit, pastelit mbi letrën e vendosur mbi një sipërfaqe me relief të ashpër, në mënyrë që të mbetet gjurma e relievit të objektit, tekstura e tij.

Për ta realizuar frotazhin me një dorë mbajmë fletën e punës dhe me tjetrën mbajmë pothuaj rrafsh me fletën mjetin artistik që do të përdorim. (Shihni modelet më poshtë).

Për të krijuar frotazhin ne mund ta vendosim të njëjtën fletë mbi disa lloj sipërfaqesh dhe mund të krijojmë një pejzash, një zog etj., si te modelet më poshtë.

Por, ka edhe një mënyrë tjetër që nga frotazhi që ke bërë të presësh p.sh., petale lulësh dhe t'i ngjisësh në një fletë tjetër. Shihni modelin.

*Krijimtari artistike.* Secili nxënës, një fletë të bardhë e vendos mbi një sipërfaqe të caktuar dhe e fërkon sipër letrën me karbon, me laps, ose me pastele. Mirë është që të mos përsëritet e njëjta formë shumë herë. Kur të përfundojnë të gjithë, atëherë, mësuesja i vendos së bashku në formën e një kolazh të madh. Shihni modelin e dhënë.

#### **Përforcimi i njohurive:**

*Analizë, vlerësim.* Nxënësit analizojnë dhe vlerësojnë si e kanë realizuar teknikën e frotazhit dhe si u plotësuan pritshmëritë që dëshironin.



**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre.

**Detyra:** Nxënësit mund të krijojnë një nga idetë e dhëna dhe herën tjetër të diskutojnë me shokët për mënyrën e realizimit.

Ja, një ide se si mund të krijosh një frotazh interesant duke vendosur fletën mbi sipërfaqe të ndryshme dhe të krijosh tekstura të ndryshme. Më parë, kompozoni dhe më pas vendosni fletën duke e fërkuar me karbon ose me mjet tjetër.



<b>Planifikimi i orës mësimore - 4</b>			
<b>Tematika:</b> Teknika dhe procese	<b>Lënda:</b> Art pamor 6	<b>Tema:</b> Pikturojmë me bojëra uji.	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</b>		<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kompetenca e të menduarit</b> Nxënësi/ja ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim me bojëra uji.</li> <li>• <b>Kompetenca e mësuarit për të nxënë</b> Nxënësi/ja përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim artistik.</li> <li>• <b>Kompetenca qytetare</b> Nxënësi/ja diskuton në bashkëpunim dhe mban qëndrim pozitiv ndaj krijimtarisë artistike.</li> </ul>		<b>Nxënësi/ja:</b> ✓ prezantohet me bojërat e ujit, akuarelet, temperat dhe akrilikët dhe cilësitë e tyre; ✓ zbulon efektet e teknikës së akuarelit, temperas, akrilikut dhe i përdor në krijim; ✓ vlerëson punën në bashkëpunim dhe interpreton sipas mënyrës së vet “Pranverën” e Boticelit.	
<b>Mjetet e punës:</b> fletore vizatimi, laps HB, akuarele, temperë, akrilikë, penela, gota, pjata plastike, ujë.			
<b>Burimet:</b> Teksti – Art pamor 6		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Histori, Kimi, Gjuhë.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b> <i>Diskutim, marrëdhënia pyetje–përgjigje, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, krahasim, interpretim.</i>			

**Përshkrimi i situatës:**

Mësuesi/ja vendos mbi tavolinë bojërat e ujit që përfshihen në mësimin e ditës dhe penelat përkatës, (nëse nuk mundet t’i sigurojë atëherë mund të përdorë edhe foto të tyre), si dhe një foto të pikturës së Boticelit, “Pranvera”.

**Realizimi i kuptimit:**

Mësuesi/ja shpjegon konceptet kyçe të mësimin nëpërmjet demonstrimeve, shembujve, bashkëbisedimit dhe krijimtarisë artistike.

*Marrëdhënia pyetje- përgjigje.* Mësuesi/ja tregon mjetet që ka mbi tavolinë ose fotot dhe pyet nxënësit:



Akuarele



Temperë



Akrilikët

- Si emërtohen këto? Nxënësit japin përgjigjet lirshëm. (Akuarela, tempera dhe akrilikë.)
- Me çfarë l përziejmë që të punohet? (Me ujë.)
- Me anën e kujt mjeti artistic? (Me penela.)
- Çfarë i bashkon këto bojëra? (bojëra uji.)

Pra, me një fjalë këto i quajmë bojëra uji, sepse përzihen dhe hollohen me ujë.



**- Çfarë janë akuarelat?**

Megjithëse, akuarelet njiheshin që në Egjiptin e lashtë, nuk patën popullaritet në Evropë deri në shek. XVII- XIX. Më shumë u përdor në Francë dhe Angli nga piktorët e peizazheve.

Akuarelet janë bojëra artistike, të bëra nga goma arabike (lidhës i tretshëm në ujë), që duke u holluar me ujë, japin një ngjyrë të tejdukshme.

Akuarelet gjenden të paketuara në disa forma, si: në kuti, me tubete në formë lapsash. Gjenden me gjashtë, dymbëdhjetë apo edhe me më shumë nuanca ngjyrash.

Mësuesi/ja pyet nxënësit?

- A keni punuar me akuarele dhe si ka qenë kjo përvojë për ju?

- Mendoni se duhet letër dhe penela të zakonshëm?

Nxënësit japin lirshëm komentet e tyre rreth pyetjeve.

- Çfarë ndjesie ju kanë dhënë akuarelat?

Mësuesi/ja përmbledh mendimet e tyre.

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Pse penelat kanë forma, madhësi dhe përdorime të ndryshme?

Nxënësit japin mendime sipas përvojave të veta. Mësuesi/ja rendit mendimet e nxënësve dhe shpjegon se për të arritur efektet dhe rezultatet e duhura specifike të teknikës së akuarelit, punohet mbi letra të trasha poroze dhe me penela të butë dhe me qime të gjata. (Shihni fig. 1).

Mësuesi/ja tregon shembuj të përdorimit të penelave. (Shihni fig. 2)

**- Cilat janë hapat për të bërë një krijim me akuarele?**

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Si veprohet përpara se të fillojmë punën me ngjyrat? Nxënësit japin mendimet e tyre dhe mësuesi/ja i përmbledh ato.

Në fillim vizatojmë me laps subjektin që duam, natyrë e qetë, peisazh, portret. Pastaj, fillojmë dhe hedhim tonet e çelëta me penel të madh. Kalimet nga njëri ton te tjetri bëhet në mënyrë graduale deri sa arrijmë te më të errëtat. Duhet kujdes kalojmë nga ngjyra te ngjyra, sepse peneli duhet shpëlahet. Ngjyrat mund të përzihen edhe mbi një pjatë plastike nëse nuk kemi tavalocën e duhur. Akuareli punohet me shtresa të holla (shihni fig. 3). Peneli duhet “ngopur” me ujë dhe nuk duhet të fërkohet shumë pas letrës. Pozicioni i dorës varet edhe nga peneli që do të përdorim (fig. 4), ndonjëherë, mbahet shtrirë dhe kur bëjmë detajet me penel të hollë e mbajmë edhe pingul.



Mësuesi/ja fton nxënësit të eksperimentojnë me teknikën e akuarelit. Pas disa çastesh pyet:

- Si e kuptoni ju fjalën se teknika e akuarelit është “tekanjoze”?

Pret përgjigjet e nxënësve dhe përmbledh mendimet e tyre.

Akuareli është një teknikë që kërkon shpejtësi dhe siguri që të arrish rezultate të kënaqshme dhe nuk ke kohë të mendohesh. Kjo teknikë thahet shpejt, është transparente dhe nuk të jep mundësi të korrigjosh gabimet. Prandaj, themi që teknika e akuaireli është "tekanjoze".

Një mënyrë e punimit të akuairelit është pasi të bëhet vizatimi, laget letra me ujë me ndihmën e një peneli të pastër dhe bëhet kalimi i menjëhershëm i ngjyrave sipas vizatimit në mënyrë që të mos thahet uji në letër. Efektet që do të arrihen janë shumë interesante (fig. 4)

### - Çfarë janë temperat?

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Ç'do të thotë për ju fjala tempera? Nxënësit japin komentet e tyre.
- Cilat nga këto bojëra janë tempera? (dhe drejtohet nga kutitë e bojërave, ose nga pamjet fig. 1, 2).



Mësuesi/ja bën një historik të shkurtër.

Teknika e temperave u përdor në Evropë për piktura që bëheshin, zakonisht, në panele druri, nga shek. XII ose në fillimet e shek. XIII- XV, kur ju hap rruga bojërave të vajit. Temperat ishin pigmente pluhuri dhe përziheshin me të verdhën e vezës. Sot, ato i gjejmë në paketime të ndryshme.

- Keni punuar ndonjëherë me tempera? Pse ndryshojnë nga akuairelet?

Mësuesi/ja i lë nxënësit të lirë. Përmbledh komentet e tyre.

Temperat janë një teknikë që ndryshe nga akuaireli mund të punohet më trashë dhe nuk është transparente. Shihni shembujt poshtë.

Mësuesi/ja fton nxënësit të eksperimentojnë me teknikën e temperave.



### - Çfarë janë akrilikët?

Mësuesi/ja pyet nxënësit :

- Keni dëgjuar për ngjyrat akrilike?
- Cili nga ju ka punuar me këto ngjyra?

Bën një historik të shkurtër.

Ngjyrat akrilike u zhvilluan vonë rreth vitit 1940 dhe kanë një histori më të shkurtër se ngjyrat e tjera që mësuam sot. Këto ngjyra u futën në treg si bojëra për shtëpinë, por përfitimet prej tyre tërhoqën vëmendjen e artistëve. Prej vitit 1945 artistët filluan të përdornin akrilikët që thahen shpejt dhe shmangën bojërat e vajit që donin një kohë të konsiderueshme për t'u tharë. Artistët zbuluan se këto





ngjyra sintetike ishin të manovrueshme dhe përmbanin shumë potencial. Këto ngjyra thahen shpejt dhe kanë qëndrueshmëri ndaj ujit. Për këtë arsye ato përdoren shumë në stampimin e veshjeve. Akrilikët janë ngjyra pa shkëlqim dhe kanë veti mbuluese. Kanë ngjashmëri me bojërat e vajit sepse mund të përdoren të holluar ose të plotë.

Me temperat dhe akrilikët mund të punohet në letër, në kompesatë, në telajo etj.


Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- A ndryshojnë penelat e akvarelit nga ato të akrilikut? Pse?

Penelat ndryshojnë ashtu siç ndryshojnë teknikat nga njëra- tjetra. Nxënësit eksperimentojnë me teknikën e akrilikut.

### Përforcimi i njohurive:

*Analizë, vlerësim, interpretim.* Mësuesi/ja fton nxënësit të përqendrohen te piktura “Pranvera” e Boticelit, meqenëse është një pikturë e realizuar me teknikën e temperave. “Pranvera” është piktura më e madhe mitologjike e Rilindjes së hershme dhe më e veçanta nga familja e madhe Medici. Kjo kryevepër u krijua rreth viteve 1477–1482 me teknikën e temperas. Ajo ka një natyrë njerëzore dhe besohet se ka reflektuar ndikimet kulturore të kohës. Piktura vetë nuk kishte titull dhe, për herë të parë u quajt “La primavera” (Pranvera), nga historiani i artit Giorgio Vasari.



### Kompozimi:


Piktura paraqet një grup figurash mitologjike në një kopsht, që nënkupton ardhjen e lulëzuar të pranverës. Në qendër të pikturës është Venusi, perëndesha romake, që mbizotëron vendin është paraqitur me veshje shumë elegante. Tri vajzat janë të pikturuara me shumë finesë dhe perlat në kokën e tyre simbolizojnë pastërtinë. Veshjet e tyre prej tyli, me shumë dritë dhe depërtuese, demonstrojnë virtuositetin e Boticelit në pikturimin e kësaj lloj pëlhure.

Pemët dhe frutat janë pjekur dhe vendi është rigjallëruar pas dimrit. Nuk shihet perspektiva me një pikë ikje. Karakteristikë e figurave të Boticelit është qafa e gjatë dhe e anuar pak dhe flokët e gjata e të kuqërreme. Flora (perëndesha e luleve) është pikturuar duke hedhur lulet që i mbledh nga fustani i saj. Ky është kuptimi i simbolizmit të kohës së pranverës dhe ripërtëritjes së jetës.

Pemët janë të mbushura me portokalla dhe livadhi me lule për të treguar jetën e re që po rilind pas dimrit të gjatë. Piktori këtë e ka shprehur nëpërmjet efekteve shumë delikate të dritëhijes e tonaliteve të ndritshme të ngjyrës.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre.

**Detyra:** Nxënësit punojnë sipas rubrikës “Ushtrohuni” dhe herën tjetër krahasojnë të tri teknikat që mësuan, duke dhënë komentet e tyre për teknikën që u pëlqeu më shumë dhe pse.

<b>Planifikimi i orës mësimore - 5</b>			
<b>Tematika:</b> Teknika dhe procese	<b>Lënda:</b> Art pamor 6	<b>Tema:</b> Stampojmë mbi letër.	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>		<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kompetenca e mësuarit për të nxënë</b> Nxënësi/ja përdor burime të ndryshme për të realizuar teknikat e stampimit dhe monotipit.</li> <li>• <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b> Nxënësi/ja shfrytëzon mjetet artistike dhe mundësitë e tyre komunikuese dhe shprehëse.</li> <li>• <b>Kompetenca për jetën dhe mjedisin</b> Nxënësi/ja ndërmer nisma në shërbim të komunitetit.</li> </ul>		<b>Nxënësi/ja:</b> √ prezantohet me mjetet e realizimit të teknikës së stampimit dhe monotipit dhe veçoritë e tyre; √ realizon stampimin dhe monotipin duke ndjekur hap pas hapi udhëzimet; √ vlerëson punën dhe përpjekjet e bëra për të arritur dy teknikat dhe i krahason.	
<b>Mjetet e punës:</b> karton, fletore vizatimi, laps HB, modeli I përgatitur me karton, sfungjer, rul, penela, gërshtë, temperë, akrilikë, penela, ngjites letër, xham ose pleksiglas.			
<b>Burimet:</b> Teksti – Art pamor 6		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Histori, Edukatë qytetare	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b> <i>Diskutim, marrëdhënia pyetje–përgjigje, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, krahasim, interpretim.</i>			
<p><b>Përshkrimi i situatës:</b>                      Vëzhgim. Mësuesi/ja ka përgatitur më parë një model për stampimin dhe monotipin qoftë edhe të fotokopjuar ose të printuar. Ka porositur nxënësit një orë më parë, që të sjellin me vete mjetet e nevojshme për realizimin e dy teknikave. Prerja e kartonit mund të bëhet më përpara në shtëpi me ndihmën e prindërve.</p> <p><b>Realizimi i kuptimit:</b>                      Mësuesi/ja shpjegon të ilustruar hap pas hapi konceptet kyçe të stampimit dhe monotipit.                      Marrëdhënia pyetje- përgjigje. Mësuesi/ja pyet nxënësit:                      - Kush e mban mend se si krijohet një stampë me patate ose sapun?                      Nxënësit japin përvojat e veta. Mësuesi/ja tregon bazën materiale që ka në dispozicion për stampimin, fig.1. Mësuesi/ja pyet nxënësit:                      - Si emërtohen këto mjete? Nxënësit japin përgjigjet lirshëm për ato mjete që njohin.                      - Si realizohet stampimi mbi karton? Pse përdoret karton i trashë?                      Mësuesi/ja njeh nxënësit me stampën me karton mbi letër. Për këtë duhet një karton i trashë që të mos depërtojë bojën nën anën tjetër. Stampimi mbi karton ka disa hapa dhe mund të bëhen shumë kopje nga i njëjti model.                      Mësuesi/ja pyet nxënësit:                      - Ku përdoret kjo teknikë?                      - Çfarë mund të zbukurojmë me stampat me karton?</p>			

Nxënësit japin komentet e tyre.  
Stampat me karton janë të thjeshta për t’u përdorur dhe me to mund të zbukurojmë kartolinat, çantat, veshjet, muret etj.



Pra, stampimi gjen përdorim të madh në jetën tonë të përditshme. Këtu janë udhëzimet hap pas hapi për krijimin e stampimit me karton mbi letër.

*Krijimtaria artistike.*

**1. Për të bërë një stampë me karton më parë duhet të mendohemi për modelin që do vizatojmë dhe ta hedhim idenë në karton.**



**2. Pritet pjesa e brendshme e vizatimit me një brisk me majë.**

**Kujdes prerjen duhet ta bëni me ndihmën e një të rrituri.**



**3. Kartoni i prerë vendoset mbi letrën që do të stampohet dhe ngjitet te cepat me shirit ngjitës, që të mos lëvizë.**

**4. Përhapet boja mbi një xham ose mbi një pjatë dhe ngjyhet ruli i stampimit, duke e kaluar mbi bojë.**



**5. Ruli kalohet ngadalë mbi sipërfaqen e kartonit dhe të letrës. Në rast se nuk mund të gjeni rul, përdorni penela të trashë apo copa sfungjeri.**

**6. Hiqet kartoni dhe shihet se mbi letër ka mbetur figura e vizatimit që është prerë.**

Mund të bëni disa prova me të njëjtin model, duke ndryshuar ngjyrat.



Ka edhe mënyra të tjera për krijimin e stampave të thjeshta, nëse nuk kemi mjetet e duhura atëherë mund të përdorim një hapësë vrimash (fig.1) me forma të ndryshme ose edhe gërshërën (fig. 2), në fillim paloset letra, vizatohet dhe pritët sipas vizatimit me laps. Procesi i stampim bëhet njësoj.



Një ide tjetër për të stampuar me karton mbi letër është edhe krijimi i stampave të shkronjave të një emri ose fjale të caktuar. Procesi i punës është i njëjtë me sa thamë më sipër, fig.3.

Mund të stampojnë edhe bluza për ditën e tokës ose për të drejtat e fëmijëve dhe t'ia dhurojnë moshatarëve që janë në nevojë.

**- Si realizohet monotipi? Në sa kopje mund të realizohet ai?**

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Si emërtohen këto mjete? Dini ndonjë teknikë tjetër stampimi?

Nxënësit flasin lirshëm.

- Një teknikë tjetër e stampimit është edhe monotipi. Kjo teknikë nga vetë fjala "mono" bëhet vetëm në një kopje. Monotipi realizohet nga vizatimi ose pikturimi mbi një sipërfaqe të lëmuar jo thithëse, si xham, plastike a metal. Monotipi si proces u shpik nga një piktor dhe gdhendës italian rreth shek. XVII.

Mësuesja tregon bazën materiale që do të përdoret për teknikën e monotipit fig.2. Mësuesi/ja pyet:


- Si mendoni a ka rregulla për realizimin e teknikës së monotipit?

Më poshtë janë udhëzimet hap pas hapi. Monotipi mund të realizohet me ngjyra dhe bardh e zi.

**Krijimtari artistike**

**1. Më parë duhet të përcaktojmë ngjyrat që do të përdorim për teknikën e monotipit.**

Me një furçë ose me një rul të posaçëm shtrohet një shtresë e hollë boje mbi sipërfaqen e xhamit. Zakonisht, përdoret bojë tipografike (shtypi), por mund të jetë edhe bojë vaji, tempera, guash etj.



**2. Mbi bojë vizatohet me një stekë ose me një mjet tjetër të hollë si bishti i penelit, duke "gërvishtur" sipërfaqen e ngjyrosur.**



**3. Në vazhdim, hiqet boja nga pjesët që duam të jenë të bardha. Për këtë mund të përdorim penela, pambuk, lecka etj.**

**4. Ende sa pa u tharë boja, vendosim një letër mbi sipërfaqen e ngjyrosur dhe ushtrojmë forcë mbi të me anë të një ruli ose tamponi.**

**5. Kemi përfutur, kështu, vizatimin tonë të përmbysur.**

Mësuesi/ja mund të shkruajë në tabelë disa tema për mbrojtjen e mjedisit dhe nxënësit vetë të zgjedhin njërin, si: p. sh., "Gjallesat e detit" dhe çdo nxënës të krijojë një gjallesë me teknikën e monotipit. Në fund mblidhen të gjitha punët bashkë si te shembulli i dhënë.

Ky është shembull i printimit me plastelinë. Pasi plastelina hapet si një petë me trashësi 5 mm, gdhendet një imazh dhe më pas pikturohet me ngjyrat e dëshiruara. Sipër saj vendosim një letër të cilën e shtrijmë sipër plastelinë me dore. Më pas e heqim me kujdes letrën dhe rezultati është mjaft interesant, por që mund të realizohet vetëm njëherë.



**Përforcimi njohurive:**

*Vlerësim, krahasim.*

Mësuesi/ja nxit nxënësit të vlerësojnë krijimet e bëra te vetat dhe të shokëve dhe të krahasojnë dy teknikat që aplikuan.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre. Gjithashtu japin argumentet e tyre për teknikën që u pëlqeu më shumë dhe pse.

**Detyra:** Nxënësit punojnë sipas rubrikës “Ushtruhuni”.



**Planifikimi i orës mësimore - 6**

<b>Tematika:</b> Teknika dhe procese	<b>Lënda:</b> Art pamor 6	<b>Tema:</b> Stampa me relief	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>		<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>● <b>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit</b> Nxënësi/ja shprehet qartë me anë të simboleve nëpërmjet stampës me relief;</li> <li>● <b>Kompetenca personale</b> Nxënësi/ja merr përsipër përgjegjësi për realizimin e stampës me relief;</li> <li>● <b>Kompetenca qytetare</b> Nxënësi/ja vlerëson stampimin si pjesë e artit dhe si gjen ai përdorim në jetën e përditshme;</li> </ul>		<p><b>Nxënësi/ja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>√ merr pjesë në diskutim dhe jep preferencat e veta për llojet e stampave;</li> <li>√ paraqet formën tre dimensionale mbi sipërfaqen dy dimensionale;</li> <li>√ mban qëndrim pozitiv ndaj krijimtarisë artistike dhe vlerëson punën e vet dhe të shokëve/shoqeve.</li> </ul>	
<b>Mjetet e punës:</b> fletore vizatimi, laps HB, modeli I përgatitur me karton, sfungjer, rul, penela, gërshërë, temperë, akrilikë, pjata plastike.			
<b>Burimet:</b> Teksti –Art pamor 6		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> histori,	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b> Diskutim, marrëdhënia pyetje- përgjigje, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, krahasim, interpretim.</p>			

**Përshkrimi i situatës:**

**Bisedë.** Mësuesi/ja ka përgatitur më parë stampa me relief me material të ndryshme si me spango, plastelinë, patate, mollë, me mjete rrethore etj. Nëse nuk mundet t'i bëjë dot atëherë shfrytëzon foto që ilustronjë secilën nga stampat. Fillon me pamjen e një vule. Pyet nxënësit:

- Çfarë është kjo? Ku e keni parë një të tillë? Për çfarë përdoret në jetën e përditshme? Nxënësit japin mendimet e tyre rreth vulave dhe përdorimin e tyre në jetën e përditshme. Vulat i gjejmë jo vetëm nëpër zyra dhe institucione të ndryshme, por edhe në jetën e përditshme.



Mësuesi/ja ka porositur nxënësit një orë më parë që të sjellin patate, gomë etj.

### Realizimi i kuptimit:

Mësuesi/ja shpjegon etapat e realizimit të stampës me relief dhe e ilustron me shembuj.

*Marrëdhënia pyetje- përgjigje.* Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Keni munduar ndonjëherë të krijoni vulën tuaj?

- Përse mund t'ju shërbente një vulë?

### - Përmes cilës teknikë realizohen stampat me relief?

Mësuesi/ja tregon stampat e ndryshme që ka mbi tavolinë, të bëra me patate.

- Shikoni këto objektsh çfarë janë dhe përse mund t'i përdorim?

Nxënësit japin komentet nisur ngapërvojat e veta. Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Si mund të krijohet një stampë e tillë?

Mësuesi/ja shpjegon se stampat që janë mbi tavolinë quhen stampa me relief dhe realizohen me teknikën e gërryerjes, pra, përmes e heqjes së materialit të panevojshëm (Fig.1).

### - Me ç'materiale realizohen ato? Me ç'mjete?

Stampat me relief ne mund t'i realizojme edhe me fruta të ndryshme, me gomë etj. Mirë është që nxënësit të mos përdorin thikë dhe një mënyrë e sigurt është që ata të kenë forma metalike ose plastike biskotash, në këtë mënyrë stampa realizohet edhe më e saktë. Fig. 2.



### Hapat për realizimin e stampës me relief

1. Mblidhen materialet me të cilat do të punohet, si: gomë, patate, sfungjer, thikë me majë, bojëra akrilike, penel, fletë etj. (Goma dhe patatja na shërbejnë për të realizuar stampën. Bojërat dhe penelat për ta lyer me ngjyrat që dëshirojmë stampën, fleta për të kryer stampimin.)

2. Zgjidhet figura që do të realizohet (shkronja, syze, spirancë, tullumbace, biçikletë, gjethe, lule, frutë, kërpudhë, kafshë etj.) Nëse zgjidhet një shkronjë, ajo duhet vizatuar së prapthi.

3. Vizatohet figura mbi gomë ose mbi patate. (Bëhet një vizatim i thjeshtë me një mjet me majë).

4. Gërryhet me kujdes ana e jashtme e figurës që nuk nevojitet.

5. Gërryhen konturet e brendshme të figurës.

6. Lyhet sipërfaqja e gdhendur e gomës me ngjyrë, me anë të një peneli.

7. Stampohet fillimisht në letër duarsh ose mbi letër tjetër, për të hequr bojën e tepërt.

8. Më pas stampohet mbi fletën ose objektin e zgjedhur për t'u zbukuruar.

### - Për çfarë mund të përdoren stampat me relief?


Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Çfarë do të kishit dëshirë të krijonit me këto stampa?

Nxënësit japin mendimet e tyre. Mund të zbukurohen letra paketimi, zarfat, albumet fotografike, ftesat, piktura si natyra të qeta me lule etj., madje mund edhe krijohet një vulë me emrin e secilit dhe të vulosen







librat personalë.

Nëse do bëhet vula me emrin tuaj atëherë emri duhet shkruar nga e djathta në të majtë së prapthi.


- Çfarë vetie kanë ngjyrat akrilik?

Nxënësit duhet të dalin te vetia e tyre rezistente ndaj ujit. Ky fakt bën të mundur që nxënësit të personalizojnë objektet e tyre të preferuara, si: bluzë, shall, filxhan, pjatë, çantë etj.

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Çfarë objktesh mund të përdorim tjetër për realizimin e stampës me relief?

Stampat me relief mund të krijohen edhe me fruta dhe perime ose me mjete rrethore që ne i kemi në përdorimin e përditshëm. Ja, disa ide se si mund të krijojmë stampa me relief me materiale të ndryshme. Shihni pamjet.



### Përforcimi i njohurive:

*Analizë, vlerësim.* Mësuesi/ja fton nxënësit të shohin stampimet e bëra dhe të japin mendimet se cila, prej tyre, është realizuar sipas hapave, cila u pëlqen dhe pse.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre.

**Detyra:** Nxënësit punojnë sipas rubrikës “Ushtroni” dhe zbatojnë njërin nga stampat e shembujve, me materiale të ndryshme.

<b>Planifikimi i orës mësimore - 7</b>			
<b>Tematika:</b> Teknika dhe procese	<b>Lënda:</b> Art pamor 6	<b>Tema:</b> Skulptura në reliev.	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>		<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>● <b>Kompetenca personale</b> Nxënësi/ja bashkëpunon me shokët dhe shoqet.</li> <li>● <b>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit</b> Nxënësi/ja shpreh emocionet e veta me anë të simboleve nëpërmjet skulpturës me reliev.</li> <li>● <b>Kompetenca qytetare</b> Nxënësi/ja vlerëson rolin e skulpturës në jetën e përditshme.</li> </ul>		<b>Nxënësi/ja:</b> ✓ shkëmben eksperiencat dhe njohuritë e veta për prejardhjen e skulpturës me reliev; ✓ aplikon procesin e gdhendjes sipas hapave; ✓ përdor skulpturën në reliev për qëllime të caktuara.	
<b>Mjetet e punës:</b> modeli i përgatitur me karton, sfungjer, rul, penela, gërshtë, temperë, akrilikë, pjata plastike.			
<b>Burimet:</b> Teksti – Art pamor 6		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Histori, Aftësim teknologjik	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b> <i>Diskutim, marrëdhënia pyetje–përgjigje, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, krahasim, interpretim.</i>			

**Përshkrimi i situatës:**

*Diskutim.* Mësuesi/ja pyet nxënësit?

- Çfarë stampimesh bëtë me materiale të ndryshme?

Nxënësit shkëmbejnë eksperiencat e tyre. Ndonjë edhe mund të paraqesë stampat e bëra ndryshe. Mësuesja pyet nxënësit:

- Si quhet procesi i realizimit të stampave? (Me gërvishtje ose me gdhendje, pra, me heqje të materialit.)

**Realizimi i kuptimit:**

*Marrëdhënia pyetje–përgjigje.* Mësuesi/ja shpjegon konceptet bazë të skulpturës me reliev dhe hapat për realizimin e saj duke e ilustruar me shembuj. Pyet nxënësit:

- Ku jetonin njerëzit më parë në kohët primitive? (Nëpër shpella.)

- Ku është përdorur më parë si proces gjendja? Në kohët e lashta kur njerëzit jetonin nëpër shpella dhe gërvishtnin gurin, drurin, metalin, mermerin. Këto janë shembuj të gërvishtjes në shpellë dhe në shkëmb. Kjo quhet skulptura në reliev dhe njeriu e ka realizuar që në kohët e lashta. Kjo lloj skulpture realizohet mbi një sipërfaqe të sheshtë dhe të fortë dhe relievi del mbi këtë sipërfaqe nëpërmjet gërvishtjes ose gdhendjes.



**- Ku keni parë tjetër skulptura me relief në jetën e përditshme?**

Pret që nxënësit të japin komentet e tyre në bashkëpunim me shokun ose shoqen e bankës.

Këta janë shembuj të skulpturës me relief në jetën e përditshme.



**- Cilat materiale përdoren për të realizuar skulpturën me relief?**

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Po ju, si mund të krijoni një skulpturë me relief duke u nisur nga shembujt që pamë?

Nxënësit japin idetë e tyre për skulpturën me relief. Për këtë mund të përdoret sapuni ose qiriri.

*Krijimtari artistike. Hapat për realizimin e skulpturës prej sapuni:*

1. Mblidhen mjetet që duhen: sapun (ose qiri), thikë plastike, kunjja dhëmbësh etj., si dhe një gazetë, për të mos ndotur mjedisin ku punohet. (Fig. tregojnë mjetet e nevojshme për gdhendjen.)



2. Zgjidhet një figurë, që të jetë e thjeshtë për t'u gdhendur (kafshëz, varkë, vegël muzikore, raketë tenisi, guaskë etj.).

3. Vizatohet figura në sapun (me majën e një kunjja dhëmbësh).

4. Hiqet pjesa e panevojshme me thikë, duke e gërvishur sapunin, derisa objekti të marrë formë.

5. Realizohen detajet e figurës, vijëzimet.


Këto gdhendje janë realizuar në sapun. Të tilla mund të bëhen edhe me qiri. Nëse tregohemi pak të vëmendshëm, atëherë mund të arrijmë rezultate shumë të kënaqshme.



Gdhendja e frutave dhe e perimeve (si e kungullit të Hallouinit, shalqirit, mollës etj.) është tashmë pjesë e zbukurimeve të shtrimit të tryezave për raste festash.

Këto gdhendje janë realizuar në qiri.

*Duhet patur kujdes vetëm nëse gdhendim shkronja, atëherë mbani mend gjithmonë që të bëhen së prapthi, si te modeli i dhënë.*



**- Çfarë materialesh të tjera mund të përdorim për skulpturën në reliev?**

Skulptura me reliev mund të krijohet edhe me plastelinë. Më parë bëhet vizatimi mbi një karton dhe pastaj vendoset plastelina shtresa- shtresa dhe hapet me ndihmën e gishtave. Mund edhe të hapet si një litar me trashësi të ndryshme. Ngjyrat përshtaten sipas temës që është vizatuar.



Relievi mund të bëhet edhe me guaska të ngjitura, edhe me letra si te modelet pranë.

**Përforcimi i njohurive:**

*Analizë, vlerësim.* Mësuesi/ja fton nxënësit të analizojnë krijimet e bëra dhe të vlerësojnë rolin e skulpturës me reliev në art dhe në jetën tonë të përditshme.



**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre.

**Detyra:** Nxënësit punojnë sipas rubrikës “Ushtroni” dhe përzgjedhin krijimet e bëra për të krijuar një ekspozitë në klasë.

**Planifikimi i orës mësimore - 8**

<b>Tematika:</b> Teknika dhe procese	<b>Lënda:</b> Art pamor 6	<b>Tema:</b> Skulptura.	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>		<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>● <b>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</b> Nxënësi/ja përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim artistik në skulpturë.</li> <li>● <b>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit</b> Nxënësi/ja shfrytëzon në mënyrë të pavarur krijuese, mjetet artistike dhe mundësitë e shprehëse të skulpturës.</li> <li>● <b>Kompetenca qytetare</b> Nxënësi/ja vlerëson ndryshimet në kohë dhe rolin e skulpturës në historinë e artit, kulturës dhe në kohët moderne.</li> </ul>		<p><b>Nxënësi/ja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>√ përcakton mjetet e duhura për procesin e skulpturës që do aplikojë;</li> <li>√ ndjek hap pas hapi modelimin, si proces të skulpturës;</li> <li>√ vlerëson rolin e skulpturës në art e kulturë dhe në jetën e përditshme.</li> </ul>	

<b>Mjetet e punës:</b> modele të gatshme, plastelinë, kunjja, thika plastike.	
<b>Burimet:</b> Teksti –Art pamor 6	<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> histori, fizikë, kimi.
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>  <i>Diskutim, marrëdhënia pyetje–përgjigje, vëzhgim,  punë e pavarur, krijimtari artistike,  analizë, vlerësim, krahasim, interpretim.</i></p>	

**Përshkrimi i situatës:**

*Diskutim.*

- Keni udhëtuar me prindërit ose në ekskursionë nëpër qytete të Shqipërisë?
- Çfarë ju ka rënë më shumë në sy në sheshet kryesore, p.sh., në Tiranë, Korçë, Lezhë, Krujë etj?

Nxënësit flasin lirshëm dhe mësuesja i nxit të dalin te monumentet Skënderbeut me kalë që ndodhen në disa qytete të Shqipërisë etj. Nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin dhe flasin për përvojat e veta.

Mësuesi/ja pyet nxënësit.

- A ju kanë dhuruar ndonjë pikturë, vazo qeramike ose qelqi, statuja të vogla druri ose mermeri ose në një dyqan me artistike?
- Mund të më thoni disa gjini të artit pamor?

Nxënësit japin komentet e tyre pasi kanë marrë njohuri në mësimet e mëparshme.

- Si realizohen vizatimi, piktura, skulptura?

Mësuesja përmbledh mendimet e tyre se vizatimi realizohet me laps, karbon, piktura me ngjyra të ndryshme dhe skulptura me mjete të ndryshme.

**Realizimi i kuptimit:**

Mësuesi/ja shpjegon konceptet bazë të mëimit dhe e lidh edhe me shembuj të ndryshëm.

**- Ç’është skulptura?**

*Marrëdhënia pyetje–përgjigje.* Mësuesi/ja pyet nxënësit dhe vendos pamjet që ilustrojnë fjalën skulpturë:

- Ç’do të thotë për ju fjala skulpturë?



“Luftëtari Kombëtar”



Skënderbeu, muzeu i Krujës



ABC- ja, Korçë

Mësuesi/ja shpjegon se skulptura është arti i krijimit të formave me tre përmasa. Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Përse përdoren skulpturat sot?

Nxënësit japin mendimet e tyre. Mësuesja shpjegon se skulptura i ka fillimet e saj që në parahistori dhe njeriu i përdorte për qëllime magjike ose fetare. Më vonë e deri më sot, skulpturat janë vepra të mirëfillta arti.



**- Si realizohen veprat në skulpturë?**

Mësuesi/ja tregon pamjen ku paraqitet një atelie skulpture, ku studentët realizojnë krijimet e tyre në disa lloj materialesh të ndryshme.

Mësuesi/ja paraqet disa pamje ku jepen materiale nga të cilat bëhet skulptura dhe nxit nxënësit të flasin rreth tyre.



*Derdhja e metaleve*



*Gdhendja*



*Petëzimi i metaleve pas formësimit*


- Atëherë, si mendoni cilat janë materialet kryesore që përdoren në skulpturë?

Nxënësit japin mendimet e tyre dhe mësuesi/ja i përmbledh. Këto materiale, janë: balta, argjila, allçia, guri, druri, metalet, si: bronzi, bakri, si dhe të tjera me përbërje plastike etj.

Formësimi bëhet me argjilë e më pas bëhet derdhja në materiale të forta në kallëpe të parapërgatitura për këtë qëllim (Fig.1), Gdhendja bëhet mbi material të forta, si: guri, druri (fig. 2), petëzimi bëhet me anë të rrahjes së metaleve.

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Cilat janë materialet që përdoren për realizimin e skulpturave?



Mësuesi/ja tregon pamjet në tabelë dhe fton nxënësit të gjejnë llojet e materialeve të përdorura.

- Edhe, në vendin tonë janë gjetur nga zbulimet arkeologjike si këta qypat që datojnë që nga periudha ilire dhe po ashtu gjenden statuja dhe objekte të ndryshme, si Dea e Butrinitit e gdhendur në mermer. Disa nga skulptorët e famshëm në botë, janë: Fidia, Praksiteli, Mironi, Mikelanxheloja, Rodeni etj.

- Në vendin tonë, ashtu si për pikturën edhe për skulpturën, kemi artistë të famshëm që kanë lënë pas vepra të mrekullueshme, si: Odhise Paskali, Janaq Paço etj.

- Tradita kulturore vazhdon edhe sot, ku artizanët shqiptarë e mbajnë gjallë këtë pasuri të vendit tonë. Këto janë disa nga punimet e bëra në dru . Më poshtë, kemi edhe qelqin e shkrirë që derdhet në vasketë për t'u realizuar krijimi te figura pranë.

- Një lloj tjetër skulpture që po zhvillohet, sot, është edhe ajo me dyllë e titulluar "Ajnshtajni", ku paraqiten njerëzit e famshëm të botës. Ndërsa, në figurën tjetër është armatura, një strukturë prej metali që do të mbajë skulpturën e një njeriu.

### - Çfarë ndryshimi thelbësor ka piktura me skulpturën?

Kujtohet ndryshimi midis figurave dhe trupave gjeometrikë. Piktura është dypërmasore dhe skulptura bën pjesë në grupin e arteve me tri përmasa si arkitektura dhe instalacioni.

Mësuesi/ja pyet nxënësit:



### - Ç’do të thotë fjala “modelim”?

Një proces tjetër i skulpturës është modelimi. Mësuesi/ja jep shembuj për disa qypa dhe pyet nxënësit:

- E dini si janë realizuar këta qypa? Çfarë materiali është përdorur?

Nxënësit japin komentet e tyre dhe mësuesi/ja i përmbledh duke shpjeguar se modelimi është një proces që realizohet me shtim të materialit. Mësuesi/ja pyet:

- Si është balta ose argjila? Si mund të punojmë me to?

- Meqenëse argjila është e butë ajo punohet me gishta ose me disa steka (lopatëza druri).



- Si formësohet argjila? Më parë formësohej me gishta dhe më pas nëpërmjet formësimit mbi një plan rrotullues ose me tornjo, ose me kallëpe. Këtu mund të kujtohet hapësira pozitive dhe negative që tregohet edhe në figurën e kallëpeve.

### - Si formohet qeramika?

Nëse argjilën e pjekim në temperaturën 5000-6000 gradë, atëherë do të përftojmë edhe qeramikën që ka një histori shumë të vjetër dhe popullore edhe në vendin tonë.

- Po nëse e pikturojmë një vazo prej qeramike çfarë gjinie do ishte pikturë apo skulpturë?

Mësuesi/ja i lë nxënësit të lirë të japin mendimet e tyre dhe i nxit nxënësit të dalin në përgjigjen e saktë që qeramika është degë e skulpturës, sepse është tredimensionale edhe pse e ngjyrosim.

*Krijimtari artistike.* Mësuesi/ja kërkon vëmendjen e nxënësve për të shpjeguar:

### **Hapat për të modeluar**

1. Fillimisht krijohet një top balte, që e punojmë me duar.

2. Më pas gërmohet në brendësi të topit, duke e hapur. Duke vazhduar gërmimin, ngjeshim materialin anash me kujdes te pjesët anësore të tasit, në mënyrë që të krijohet një trashësi uniforme.

3. Sipërfaqja e jashtme lëmohet me një sfungjer të butë e të lagur, që të arrijmë pamjen e dëshiruar.

Modelimi është një proces që ka hyrë edhe në industrinë moderne të makinave. Ky është një model i ri, përpara se të realizohet në fabrikë. Shihni figurën.

Kjo figurë tregon një artist që krijon personazhet e filmave vizatimorë nëpërmjet modelimit.



**Përforcimi i njohurive:**

*Analizë, vlerësim.* Mësuesi/ja fton nxënësit të shohin modelimet e bëra dhe të japin mendimet e tyre për rolin e skulpturës në art dhe në jetën e përditshme.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre.

**Detyra:** Nxënësit punojnë sipas rubrikës “Ushtroni”.

*Nxënësit mund të bëjnë në shtëpi brumë me miell, kripë dhe ujë. Kjo masë është shumë e mirë për t’u modeluar dhe jep rezultate të kënaqshme pasi thahet edhe mund të ngjyroset sipas dëshirës. Ja, një ide me kavanozat e qelqit të veshura me brumin e kripur dhe të modeluara sipas dëshirës.*



**Planifikimi i orës mësimore - 9**

<b>Tematika:</b> Teknika dhe procese	<b>Lënda:</b> Art pamor 6	<b>Tema:</b> Krijojmë një kolazh	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>		<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit</b> Nxënësi/ja përgatitet të bashkëpunojë në grup.</li> <li>• <b>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</b> Nxënësi/ja njih mundësitë shprehëse të kolazhit.</li> <li>• <b>Kompetenca për jetën dhe mjedisin</b> Nxënësi/ja i vlerëson riciklimin si element i rëndësishëm i kolazhit.</li> </ul>		<p><b>Nxënësi/ja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ përzgjedh bazën materiale për krijimin e kolazhit;</li> <li>✓ krijon kolazhin duke iu referuar hapave sipas udhëzimeve;</li> <li>✓ zbulon karakteristikat e teknikës së kolazhit dhe vlerat e tij.</li> </ul>	
<b>Mjetet e punës:</b> fletore vizatimi, laps HB, gomë, vinovil, gërshërë, materiale të ndryshme si revista, tapa shishesh, gazeta, kopsa, pupla, fije, pëlhura të ndryshme, guaska deti, lëvozhga vezësh etj.			
<b>Burimet:</b> Teksti –Art pamor 6		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Histori, Biologji, Aftësim teknologjik.	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>  <i>Diskutim, marrëdhënia pyetje–përgjigje, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, krahasim, interpretim.</i></p>			



### Përshkrimi i situatës

*Diskutim.* Mësuesi/ja që në fillim të vitit shkollor bën një planifikim të përafërt të temave mësimore dhe njofton nxënësit të kenë më vete mjetet për realizimin e tyre më përpara. Nxënësit rikujtohen një orë më parë për bazën materiale. Disa prej këtyre materialeve mësuesi/ja i vendos mbi tavolinë dhe pyet nxënësit:

- *Çfarë mund të bëhet me këto materiale që janë mbi tavolinë?*

Nxënësit sjellin ide dhe mendime nisur nga materialet e ndryshme se çfarë mund të krijojnë.

### Realizimi i kuptimit:

Mësuesi/ja shpjegon konceptet bazë të mësimin dhe e lidh edhe me shembuj të ndryshëm.

*Marrëdhënia pyetje–përgjigje.* Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- **Ç’kuptim ka për ju fjala “kolazh”?**

Fjala “kolazh” vjen nga frëngjishtja që do të thotë “ngjis”.

- *Pra, çfarë mund të krijojmë me materialet e mbledhura dhe me ngjitje?*

Nxënësit shprehen lirshëm duke dhënë idetë e tyre.

- **Si realizohet teknika e kolazhit?**

Mësuesi/ja shpjegon se **kolazhi** është një kompozim artistik i krijuar nga materiale të ndryshme të ngjitura mbi një sipërfaqe për të krijuar një të tërën. Origjina e kolazhit është përdorur para qindra vjetësh, por u rishfaq bujshëm në fillimet e shek. XX si një risi e re arti dhe u bë pjesë e artit modern nga Pikaso dhe Brak.

- **Cilat material përdoren për realizimin e kolazheve?**

Materialet me të cilat mund të bëhet një kolazh janë: revista, gazeta, tapa shishesh, kopsa, pupla, fije, pëlhura të ndryshme, guaska deti, lëvozhga vezësh, makarona, gjethe etj. Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- *Çfarë materialesh keni sjellë ju sot? Nxënësit listojnë materialet që kanë sjellë.*

- *Për çfarë qëllimi mund ta krijoni një kolazh?*


Mësuesi/ja shpjegon se kolazhi mund të komunikojë ide, mesazhe dhe ndjenja. Në kolazh, një portret mund të përfshijë fotografitë me gjërat e preferuara të tij, ngjyrat, hobin etj. Nëse do të krijoni një kolazh për një ngjarje të caktuar mund të përfshihen në të fotografi të vendeve, biletat e udhëtimeve, suvenire, gazeta etj. Pra, kolazhi mund të jetë një koleksion artikujsh që paraqesin një person, vend, objekt ose ngjarje.

Mësuesi/ja fton nxënësit që të përzgjedhin temën e kolazhit dhe bazën materiale. Nxënësit mund të punojnë në grup ose edhe në mënyrë individuale. Jepen shembuj.



Shembuj kolazhesh me gazeta, revista etj

1. Kolazh me ngjyra dhe me punim artistik.
2. Kolazh me fletët e një reviste të mbështjella mirë dhe më pas të rrotulluara dhe në fund të lyera me bojë sipas dëshirës.



Siç, shihet edhe nga pamjet ka shumë mënyra se si mund të krijohet një kolazh jo vetëm me një material, por edhe duke i ndërthurur ata.

*Krijimtari artistike.*

**Hapat e realizimit të kolazhit**

1. Zgjidhet bazamenti mbi të cilin do të krijohet kolazhi (copë kartoni ose kuti a objekt me tri përmasa që mund t'i "vishet" sipërfaqja).

2. Zgjidhet materiali që do të shërbejë si sfond bazë (faqe gazetash, revistash, librash, fletorësh muzike, letra dhuratash, copa rrobe etj.) dhe materialet e tjera që do të ngjiten mbi të (kopsa, fije, fjongo, mbetje lapsash, figura të prera, si: shkrime, letra dhuratash, amblazhesh, muri etj.).

3. Lyhet sipërfaqja e bazamentit me ngjites të lëngshëm (vinovil).

4. Ngjitet e shtrohet letra e sfondit.

5. Mbi të ngjiten figurat a sendet e tjera, duke eksperimentuar vendosjen e tyre në kombinime e mënyra të ndryshme.

Mësuesi pyet nxënësit:

- Me çfarë materialesh u krijua kolazhi me zogun?
- Çfarë mesazhi jepet nëpërmjet këtij kolazhi me zogun?
- Pse ka rëndësi përdorimi i materialeve të riprodhueshme në kolazh?

Përmes përdorimit të materialeve të riprodhueshme në kolazh, ne kujdesemi edhe për mjedisin, sepse ripërdorim sende që nuk na nevojiten dhe me to krijojmë sende të tjera.

Për krijimin e këtij kolazhi si bazament kemi një kanavacë duke u përdorur gazeta dhe revista



të vjetra. Për të krijuar teksturat e ndryshme janë përdorur stampa nga materiale të ndryshme që i kemi përmendur te mësimi i stampave me karton dhe me relief. Në këtë mënyrë në sfond janë krijuar tekstura interesante. Është ngjitur zogu mbi sfondin e përpunuar dhe në fund, për të dhënë idenë e kafazit, janë përdorur shkëlqyes të lëngshëm (xixa) dhe për t'i theksuar hekurat e kafazit është përdorur pak e zeza. Nxënësit japin idenë e tyre mbi mesazhin që jep ky kolazh, lirinë e shpendëve dhe ruajtjen e mjedisit. Kjo është vetëm një ide dhe nxënësit mund ta zgjedhin vetë temën e kolazhit.



**Përforcimi i njohurive:**

*Analizë, vlerësim.* Nxënësit japin një përmbledhje të vlerave artistike dhe historike, të kolazhit, mënyrat dhe mundësitë shprehëse të tij dhe çfarë idesh, mendimesh komunikuan nëpërmjet kolazhit.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre.

**Detyra:** Nxënësit punojnë sipas rubrikës “Ushtrohuni”.

**Planifikimi i orës mësimore - 10**

<b>Tematika:</b> Teknika dhe procese	<b>Lënda:</b> Art pamor 6	<b>Tema:</b> Krijojmë një mozaik	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>		<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kompetenca e të menduarit</b> Nxënësi/ja ndjek udhëzimet për të realizuar mozaikun.</li> <li>• <b>Kompetenca qytetare</b> Nxënësi/ja bashkëpunon me të tjerët për një qëllim të përbashkët.</li> <li>• <b>Kompetenca për jetën dhe mjedisin</b> Nxënësi/ja komunikon mesazhe nëpërmjet mozaikut dhe gjen zgjidhje për problemet ekologjike.</li> </ul>		<p><b>Nxënësi/ja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>√ përcakton materialet dhe temën e mozaikut;</li> <li>√ ndan detyrat në grup dhe merr përgjegjësi për realizimin e mozaikut;</li> <li>√ vlerëson mozaikun dhe vlerat e tij historike dhe kulturore në vendin tonë.</li> </ul>	
<b>Mjetet e punës:</b> fletore vizatimi, laps HB, drithëra, CD- i të vjetra, rruaza, guralecë, guacka, lëvozhga vezësh, fara të ndryshme bimësh si luledielli, kungulli etj.			
<b>Burimet:</b> Teksti –Art pamor 6		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> histori, fizikë.	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>  <i>Diskutim, marrëdhënia pyetje–përgjigje, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, krahasim, interpretim.</i></p>			

### Përshkrimi i situatës

*Diskutim.* Mësuesi/ja rikujton nxënësit një orë më parë për bazën materiale që duhet të kenë për krijimin e mozaikut. Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- *Cili prej jush gjen se çfarë i bashkon këta qytete: Durrësin, Shkodrën, Apoloninë, Butrintin?*

Nxënësit japin mendimet e tyre sipas përvojave që kanë. Mësuesi/ja i nxit me pyetje që të dalin tek e përbashkëta që kanë këta qytete të mozaiku.

### Realizimi i kuptimit

Mësuesi/ja shpjegon konceptet bazë të mësimit dhe e lidh edhe me shembuj të ndryshëm.

*Marrëdhënia pyetje-përgjigje.* Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- *Çfarë dini ju rreth mozaikëve? Cili është më i famshmi në vendin tonë? (Bukuroshja e Durrësit etj.)*

Mësuesi/ja i nxit të flasin rreth mozaikëve sipas mendimeve apo njohurive që kanë.

### - Çfarë është teknika e mozaikut?

Mësuesi/ja përmbledh përgjigjet e nxënësve dhe shpjegon se mozaiku është arti i krijimit të imazheve nëpërmjet copave të vogla prej xhami të ngjyrosura, gurëve ose prej materialeve të tjera. Është një teknikë shumë e vjetër dekoruese e artit dekorativ ose e dekorimit të brendshëm. Një traditë mbi 4000-vjeçare.

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- *Pse duhet t'i ruajmë mozaikët e vjetër?*

Nxënësit japin komentet e tyre. Mësuesja saktëson se mozaikët duhen ruajtur sepse kanë vlera historike dhe artistike.



- *Çfarë e bën të veçantë një mozaik sipas mendimit tuaj?*

Mësuesi/ja nxit përgjigjet e nxënësve që të dalin aty ku duhet se bukuria e mozaikut qëndron te ritmi që krijon vendosja e materialeve, ngjyrat harmonike dhe vendosja e materialit të përdorur për këtë qëllim.

Mësuesi/ja fton nxënësit të shohin pamjet dhe i pyet:

- *Çfarë temash janë trajtuar te këta mozaikë të lashtë dhe çfarë materiali është përdorur? (Temat janë nga natyra dhe janë përdorur gurë ose copëza materialesh të vogla.)*

### - Për çfarë përdoren mozaikët?

Temat janë me elemente nga natyra, si: shpendë, bimë, forma gjeometrike, kafshë etj. Këto mund të përdoren edhe në krijimet tuaja. Ndërsa, mozaikët me forma gjeometrike që përsëriten dhe krijojnë ritëm mund të përdoren për korniza. Mund të krijohen dhurata shumë të këndshme me teknikën e mozaikut, si: vazo e zbukuruar me disqe të prera ose korniza fotosh, një kuti ose shishe mund të zbukurohet me copëza të vogla etj.

### - Me ç'materiale realizohet një mozaik?

Mësuesi/jja vendos modelet e përgatitura më parë ose foto që paraqesin mozaikë me materiale të ndryshme. Nxënësit të flasin rreth materialeve të përdorura në to.



Nxënësit listojnë materialet që janë përdorur në këto mozaikë, si: CD-i të vjetra, lëvozhga vezësh, fasule, letra me ngjyrë, guralecë, xhama, rruaza etj.

Për të krijuar mozaikun nxënësit mund të punojnë në grup, sepse si teknikë kërkon kohë dhe bashkëpunimi ndihmon që detyra të përfundojë në kohën e duhur. Ndahet klasa në grupe dhe secili grup mund të ketë temën dhe materialet të ndryshe nga grupet e tjera, pra, të ketë shumëllojshmëri.

#### Krijimtari artistike. Hapat për krijimin e mozaikut

1. Zgjidhet tema, pra, figura që do të realizohet, si: shkronja, kafshë, lule, pejzash, kornizë e zbukuruar, vegël muzikore etj.

2. Zgjidhen materialet me të cilat mund të realizohet më mirë tema e zgjedhur. Përdoren ato që janë më të thjeshta për t'u gjetur.

3. Zgjidhet bazamenti, i cili duhet të jetë i fortë, si xham, kompensatë, karton, pllakë dyshemeje etj., që të mbajë materialet dhe ngjitesit. Mund të zgjidhet edhe një objekt me tre përmasa, që të vishet me mozaik sipërfaqja e tij.

4. Vizatohet figura, duke u kujdesur që vijëzimet të krijojnë zona që mbulohen nga një ngjyrë.

5. Lyhet bazamenti me ngjitës, i cili varet nga rëndesa e materialeve që përdoren. P.sh., nëse përdoren materiale të lehta, si: lëvozhga vezësh, letra apo lule të thara, duhet ngjitës i lëngshëm (vinovil), por nëse ngjiten gurë, copa xhami, pllakash a pjatash porcelani, atëherë përdoret kollë ose allçi. Duhet pasur parasysh edhe koha e tharjes së materialit ngjitës: nëse ai thahet shpejt, atëherë shtrimi bëhet pjesë- pjesë.

6. Shtrimi i copëzave bëhet duke ndjekur vijëzimin, duke shkuar nga vijat drejt qendrës së pjesës që duhet mbushur.

Një ide tjetër është si mund të krijohet një mozaik me tapa shishesh plastike. Por, puna për grumbullimin e tyre duhet të fillojë shumë kohë më parë në mënyrë që kur të jetë tema e mozaikut, nxënësit t'i kenë me vete tapat ose mund ta bëjnë edhe në shtëpi në kohën e lirë.



#### Përforcimi i njohurive:

*Analizë, vlerësim, krahasim.* Nxënësit japin një përmbledhje të vlerave artistike dhe historike të mozaikut si dhe emocionet dhe përvojat e veta personale lidhur me këtë teknikë kaq interesante – Mozaiku “Shumë pjesë bëjnë një të tërë”. Nxënësit krahasojnë teknikën e kolazhit dhe të mozaikut dhe japin preferencën e tyre.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre.

**Detyra:** Nxënësit punojnë sipas rubrikës “Ushtroni” dhe krijimet e bëra i mbledhin për ekspozitën e klasës.

<b>Planifikimi i orës mësimore - 11</b>			
<b>Tematika:</b> Teknika dhe procese	<b>Lënda:</b> Art pamor 6	<b>Tema:</b> Fotografia	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>		<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit</b> - Nxënësi/ja krahason dy gjini të artit nëpërmjet vlerave që reflektojnë këto gjini.</li> <li>• <b>Kompetenca qytetare</b> - Nxënësi/ja reflekton ndaj përparimit të aparateve fotografikë deri në ditët tona.</li> <li>• <b>Kompetenca digjitale</b> - Nxënësi/ja njih dhe përdor mjetet audio, video Cd-i, Dvd- i, aparat fotografik, kamera, përpunon imazhet.</li> </ul>		<b>Nxënësi:</b> ✓ dallon llojet e fotografisë dhe i klasifikon ato; ✓ përdor aparatin fotografik për të fiksuar imazhe të kompozura saktë, zbulon se imazhi fotografik ndryshon nga imazhi artistik i pikturës, vizatimit; ✓ mbron idetë e veta në favor të pikturës ose të fotografisë nëpërmjet debatit konstruktiv dhe krahasimit.	
<b>Mjetet e punës:</b> aparat fotografik, piktura, fotografi, kompjuter.			
<b>Burimet:</b> Teksti –Art pamor 6		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> histori, TIK, kimi, fizikë.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b> Diskutim, marrëdhënia pyetje–përgjigje, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, krahasim, interpretim.			

**Përshkrimi i situatës**

*Diskutim.* Mësuesi/ja ka siguruar më parë foto të një aparati fotografik, një celular, një video- kamera, një tablët etj., dhe drejton pyetjen:

- Për se përdoren këto aparatura?

Nxënësit emërtojnë aparatet dhe përse përdoren secila prej tyre.

- Çfarë të veçantash ka secila prej tyre? Cili ju pëlqen më shumë?

Nxënësit japin komente për secilën prej tyre.

- Po të përbashkëtash çfarë kanë? Mësuesi/ja nxit bisedën që nxënësit të dalin në përfundimin se përveç funksioneve që kryen secila prej tyre, kanë të përbashkët fotografinë dhe lidhjen me kompjuterin.



**Realizimi i kuptimit:**

Mësuesi/ja shpjegon konceptet kyçe të mësimit duke e ilustruar me foto dhe shembuj.

**- Ç’është fotografia?**

*Marrëdhënia pyetje–përgjigje.* Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Cilat janë momentet tuaja më të bukura?

Nxënësit japin mendimet se cilat janë momentet



e më të bukura për ta.

- A ju ka ndodhur ndonjëherë që t’ju ketë shpëtuar një moment që ju do të donit ta kishit gjithmonë me vete, p.sh., një perëndim dielli, një lule të veçantë, një person të dashur etj.?

- Çfarë shikoni ju kur doni të kujtoni një ngjarje të veçantë në familjen tuaj?

- Si mund t’i fiksojmë ne momentet magjike?

Mësuesi/ja i lë nxënësit të shprehën lirshëm.

- Krahasoni një album me foto të gjyshërve tuaj dhe një album me foto të familjes tuaj.

- Çfarë ndryshimesh kanë? Nxënësit japin komentet e tyre për fotot bardhezi dhe me ngjyra.

Mësuesi/ja shpjegon fotografinë është një element i rëndësishëm i jetës sonë dhe si ka ndryshuar ajo në periudha të ndryshme.


### - Ku mbështetet teknika e fotografisë?

Mësuesja shpjegon se fjala fotografi do të thotë të “vizatosh me dritë”. Disa substance janë mjaft të ndjeshme ndaj dritës, si: p.sh., lastrat, filmat, sot kemi sensorë magnetikë të aparateve digjitale. Bën një historik të shkurtër se si lindi për herë të parë fotografia. Imazhi i parë i suksesshëm i fotografisë u bë afërsisht në vitin 1816 nga francezi Niépce, i cili përdori një aparat të vogël të bërë vetë siç shihet edhe në figurë. Ndërsa, aparatin e parë fotografik e shpiku amerikani Alexander Wolcott, më 1840.

- Si ka ndryshuar aparati deri në ditët tona?

Mësuesja pret përgjigjet e nxënësve dhe e ilustron me foto, ku duke qartë evolucionin e aparatit fotografik deri në ditët tona. Dikur aparati fotografik ishte manual dhe duhej të ndërroje filmin me 24 apo 30 poza, sa herë që mbaronte.

- Po sot, me aparatet digjitale sa foto mund të bëhen?



Karta e memorjes të lejon të kesh një numër të madh fotosh dhe me kalimin që i bëhet në kompjuter aparati ka përsëri hapësira bosh.

### - Sa lloje fotografish njihni?

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Ku gjen përdorim fotografia në jetën tonë?

Mësuesi/ja drejton bisedën që të dalë në pah roli i fotografisë në çdo fushë të jetës. Në ndihmë të nxënësve vendos disa foto që nxënësit t’i emërtojnë dhe të japin mendimin e tyre.



- Si mund t’i quajmë këto foto? Mësuesi/ja fton nxënësit të japin komentet e tyre rreth llojeve të fotove. Fotografia që paraqet portrete personazhesh të njohura, kujtime familjare.




*Libër mësuesi për tekstin "Art pamor 6"*




Fotografia që paraqet *peizazhe*, duke na e bërë të afërt çdo cep të globit.  
Fotografia *dokumentare*, e cila fikson ngjarje e personazhe historike, situata e mjedise të së shkuarës.



Fotografia *shkencore*, e cila fikson imazhe që prej satelitëve e deri në mikrokozmos;




Fotografia *publicitare* dhe botës së modës.



Fotografia *artistike*, e cila e tregon realitetin sipas emocioneve, përvojës dhe këndvështrimit të artistit fotograf.







Fotografitë artistike mund të jenë shumë të bukura si me ngjyra ashtu edhe bardhezi.

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- A njihni ndonjë fotograf të shquar shqiptar?

**Kel Marubi** (1870- 1940) ishte një fotograf shqiptar. Kel Marubi u bë mjaft i njohur edhe jashtë vendit. Ai fotografoi krerët e politikës së asaj kohe, por edhe njëzërit e thjeshtë dhe pejsazhe. Në vitin 1970, e gjithë pasuria e tij prej 150.000 negativë iu kalua qeverisë shqiptare që të ruhen në arkivin kombëtar.

**Gjon Mili** (1904- 1984) ishte një fotograf shqiptaro-amerikan i mirënjohur për punët e tij të publikuara te “LIFE” ku fotografoi artistë të famshëm siç ishte edhe Pablo Pikaso. Gjon Mili ishte një ndër fotografët që i dha formë kërcimit dhe lëvizjes para aparatit fotografik, ashtu siç e njohim edhe sot.

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Ju ka ndodhur ndonjëherë që nuk keni mbetur të kënaqur nga fotografia që keni bërë ose që ju kanë bërë të tjerët? Pse? Mësuesi/ja pret që nxënësit të japin mendimet e tyre. Vazhdon me pyetjen:

- Çfarë ndikon që një fotografi të jetë e këndshme ose jo? Ka ndonjë rregull? Nxënësit japin komentet e tyre.

- Ç’do të thotë për ju fjala “kompozim”?

Nxënësit shprehen lirshëm për këtë term. Mësuesi/ja shpjegon se nëse duam të bëjmë një fotografi të mirë duhet të fokusohet mirë dhe të jetë e kompozuar bukur brenda kuadratis.

*Kompozimi* ka të bëjë me skenën, peizazhin apo personazhin që zgjedhim të fotografojmë.

- Ç’do të thotë për ju fjala “këndi i shikimit”?

Këndi i shikimit ka të bëjë me pozicionin që fotografohet, nga distance dhe këndet e ndryshme, lart, poshtë, afër, larg, anash etj.

### - Pse themi se drita është elementi më i rëndësishëm i fotografisë?

Drita është e ndryshme në mjediset e brendshme dhe të jashtme, ashtu si dita me shi dhe me diell. Efektet e ndryshme krijohen nga mënyra se si drita godet një objekt. (Kujtojmë mësimin e dritëhijes).

Njohja e këtyre elementeve ju ndihmon të realizoni fotografi të bukura.

Pyet nxënësit për mënyrën e realizimit të pikturës dhe fotografisë. Nxënësit bëjnë komentet e tyre.


Mësuesi/ja pyet nxënësit për pikturën se si realizohet ajo dhe a ka lidhje me elementet e fotografisë.

Udhëzon nxënësit të plotësojnë ushtrimin krahasues midis fotografisë dhe pikturës.

Në tabelë vizaton diagramin e Venit dhe nxënësit listojnë të veçantat dhe të përbashkëtat e pikturës dhe fotografisë.

**Fotografia**

**Piktura**



**Përforcimi i njohurive:**

Mësuesi/ja e ndan klasën në dy grupe kryesore dhe organizon konkursin me temë “Pro dhe kundër” për fotografinë dhe pikturën. Secili grup jep argumentet e veta dhe fiton ai grup që mbledh më shumë anëtarë nga grupi tjetër, pra ai grup që jep argumentet më bindës dhe bën për vete anëtarët e grupit tjetër.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre.

**Detyra:** Nxënësit punojnë sipas rubrikës ushtrohu. Me fotot e tyre (portret) mund të krijojnë një kënd për klasën, ku secili të ketë një CD-i (që nuk e përdorin më) dhe në mes të CD-së të ngjitet foto e secilit.

**Planifikimi i orës mësimore - 12**

<b>Tematika:</b> Teknika dhe procese	<b>Lënda:</b> Art pamor 6	<b>Tema:</b> Dizajni grafik	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</b>		<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit</b> Nxënësi/ja shprehet qartë me anë të simboleve, shenjave dhe gjuhës vizuale.</li> <li>• <b>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</b> Nxënësi/ja përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim.</li> <li>• <b>Kompetenca digjitale</b> Nxënësi/ja shkëmben informacion si dhe bashkëpunon në rrjetet e informuese në internet.</li> </ul>		<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>√ njeh mundësitë shprehëse të dizajnit grafik si koncept i kohëve moderne</li> <li>√ eksploron mundësitë e reja shprehëse të dizajnit grafik nëpërmjet simboleve, mesazheve pamore etj</li> <li>√ vlerëson rolin dhe rëndësinë e dizajnit grafik në fushat e jetës</li> </ul>	
<b>Mjetet e punës:</b> revista, gazeta, postera etj.			
<b>Burimet:</b> Teksti - Art pamor 6		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> histori, TIK, gjuhë.	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>  <i>Diskutim, marrëdhënia pyetje–përgjigje, vëzhgim punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, krahasim, interpretim.</i></p>			

**Përshkrimi i situatës:**

*Diskutim.* Pyet nxënësit:

- Keni lexuar ndonjë libër? Çfarë libri ka qenë artistik, shkencor?

Pret përgjigjet e nxënësve. Vazhdon me pyetjet:

- Po prindërit tuaj çfarë lexojnë më shumë? (Libra, gazeta, revista etj.)

- Çfarë ju bind të blini një libëra dhe enciklopedi të reja etj.?

Nxënësit japin mendime nisur nga përvojat e veta. Mësuesja i nxit që të dalin te kopertina, ilustrimet te faqet e brendshme, pra të japin sa më shumë argumente në lidhje me anën grafike.

**Realizimi i kuptimit:**

Mësuesi/ja shpjegon konceptet kyçe të mësimit duke e ilustruar me foto dhe shembuj.

*Marrëdhënia pyetje–përgjigje.* Mësuesi/ja drejton bisedën duke pyetur nxënësit.

- Për se shërben kompjuteri sot? Nxënësit japin komentet e tyre.

Mësuesi/ja ka siguruar më parë revista, gazeta, libra, postera dhe i prezanton para klasës.

- Si mendoni çfarë i bashkon dhe si realizohen këto? Nxënësit japin komentet e tyre.
- Nëse del në treg një produkt i ri nga e dimë ne kush na informon? Reklamata, posterat etj.
- Si mendoni a kanë lidhje me artin librat, posterat, gazetata, reklamata etj.



### - Çfarë është dizajni grafik?

Mësuesi/ja përmbledh mendimet e nxënësve se dizajni grafik është pjesë e artit dhe një profesion shumë i rëndësishëm i kohëve moderne, që kombinon tekstin, figurën dhe idenë në fushën e reklamave, shtypit ose faqeve të inetrnetit.

Përmbledh mendimet duke shpjeguar se të gjitha mediat e shkruara dhe ato që ne shohim në internet, janë produkt i dizajnit grafik.

Më pas paraqet disa shenja, simbole dhe logo grafike. Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Kur udhëtoni, për diku, për herë të parë si orientoheni në atë vend, p.sh., hyrjet, dajlet, dyqanet, shërbimet e ndryshme etj.?
- Po kur blejmë veshje ose një produkt ushqimor ose pije freskuese, si i dallojmë për t'i zgjedhur? Nga etiketa, logo.
- Me kë ka lidhje bota e dizajnit grafik? Me botën e komunikimit dhe të teknologjisë, dizajni grafik është zhvilluar shumë.
- Si mendoni ky profesion çfarë synon, anën e jashtme apo të brendshme?
- Pra, ky profesion ka lidhje me realizimin e pamjes së jashtëme të një objekti, sipërmarrjeje ose shërbimi.
- Dizajni grafik ka të bëjë me imazhin e reklamave (posterat, fletëpalosjet, stampat, me mediet e ndryshme (gazetat, revistat etj.).



- Me kë ka lidhje bota e dizajnit grafik? (Me botën e komunikimit dhe të teknologjisë, dizajni grafik është zhvilluar shumë.)

- Si mendoni ky profesion çfarë synon, anën e jashtme apo të brendshme?

- Pra, ky profesion ka lidhje me realizimin e pamjes së jashtëme të një objekti, sipërmarrjeje ose shërbimi.

- Dizajni grafik ka të bëjë me imazhin e reklamave, (posterat, fletëpalosjet, stampat, me mediet e ndryshme (gazetat, revistat etj.)

### - Me ç'mjete i realizon dizajneri grafik punimet e tij?

Mësuesi/ja paraqet këto foto ku jepet dizajneri grafik gjatë punës së tij/saj.

- Cili është mjete kryesor në krijimin e dizajnit grafik? Nxënësit përgjigjen pasi shohin pamjet në tabelë.

- Kushdo që njih kompjuterin mund të bëhet dizajner grafik?

Mësuesi/ja pret përgjigjet e nxënësve dhe shpjegon se ky është një profesion që duhet të jesh person i specializuar. Me një fjalë dizajni grafik ka lidhje me



komunikimin joverbal, pra ne kuptojmë mesazhet jo me fjalë por duke parë imazhet pamore që na rrethojnë, manifestet publicitare, markat, logot e ndërmarrjeve, revistat dhe gazetatat, faqet e internetit, filmat me kartonë etj. të gjitha këto i projekton dhe i realizon dizajneri grafik.

- Nëse je me pushime dhe nuk mund të blesh dot në revistë, libër ose gazetë çfarë bën?

Ka mënyra të tjera të leximit të medias së shkruar edhe nëse nuk mund t'i blejmë dot në mund t'i lexojmë nga mjetet e teknologjisë së komunikimit si kompjuteri dhe celulari, mjafton të kesh internet.

- Si mendoni çfarë roli ka hartuesi grafik në produktet e shtypit? Nxënësit japin përgjigje si e mendojnë ata. Ka disa hapa për realizimin e një produkti shtypi, si: përpunimi i tekstit, rregullimi i fotove vendin dhe madhësinë e duhur, ra me një fjalë bashkëvendosja e tekstit dhe imazheve përbën atë që quhet faqosje.

- Mund të bëhet faqosja në çdo program kompjuterik? Dizajneri përdor programe veçanta kompjuterike.

- Nga ndryshon një gazetë e përditshme nga një revistë mode, mobilimi etj. Faqosja ndryshon në varësi të përmbajtjes dhe llojit të revistës apo gazetës.

- Çfarë ka më shumë në një revistë se një gazetë? Në një revistë mode ose mobilimi i kushtohet më shumë rëndësi imazheve, ndërsa në një gazetë të përditshme ka më shumë tekst të shkruar sesa imazhe.

- Ç'kuptoni ju me fjalën artist? Cilat janë mjetet e artistit? Nxënësit japin mendimet e tyre, mësuesi/ja saktëson se fjala artist nuk do të thotë një person që punon me letër, laps, penela, ngjyra. Sot, artist quhet kushdo që krijon dhe realizon punë artistike dhe përpunon imazhet pamore ashtu siç bën dhe grafik dizajneri.

**Punë e pavarur.** Mësuesi/ja ndan nxënësit në grupe dhe i udhëzon se si të krijojnë një poster me kolazh duke ngjitur pjesë të sendeve të përdorimit të përditshëm, nga revistat, gazetatat. Duhet patur kujdes se posteri ka një titull, jep një mesazh dhe fotot janë në shërbim të këtij mesazhi

### **Përforcimi i njohurive:**

Mësuesi/ja pyet nxënësit se cili është filmi vizatimor dhe kinematografik i preferuar për ta. Nxënësit japin komentet e tyre dhe mësuesi/ja i fton nxënësit që me diagramën e Venit të krahasojnë filmat vizatimorë dhe kinematografikë. Më pas diskutojnë dhe japin krahasimet e tyre.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre.

**Detyra:** Nxënësit punojnë sipas rubrikës “Ushtrohuni”.

<b>Planifikimi i orës mësimore - 13</b>			
<b>Tematika:</b> Teknika dhe procese	<b>Lënda:</b> Art pamor 6	<b>Tema:</b> Projekt. Revista jonë (ora I)	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>		<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</b> Nxënësi/ja përzgjedh mjetet për të realizuar revistën dhe ndan detyrat.</li> <li>• <b>Kompetenca përjetën, sipërmarrjen dhe mjedisin</b> Nxënësi/ja ndërmer nisma për të realizuar revistën dhe kontribuon në mënyrë krijuese.</li> <li>• <b>Kompetenca digjitale</b> Nxënësi/ja gjen, prodhon, krijon, prezanton dhe shkëmben informacion në rrjetet informuese në internet si dhe bashkëpunon në grup për krijimin e revistës.</li> </ul>		<b>Nxënësi/ja:</b> ✓ përshtatet në grup dhe merr përsipër detyrat sipas tematikës; ✓ harton planin e punës sipas radhës së vendosur; ✓ përcakton llojin e informacionit dhe titullin për rubrikat që do përpunojë.	
<b>Mjetet e punës:</b> fletore vizatimi, laps HB, ngjitës, gërshërë, revista, gazeta, ngjyra, stampa, kompjuter, dosje.			
<b>Burimet:</b> Teksti - Art pamor 6		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> histori, TIK, gjuhë.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b> Diskutim, marrëdhënia pyetje–përgjigje, vëzhgim punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, krahasim, interpretim.			
<b>Përshkrimi i situatës:</b> Diskutim. Rikujtohet nga ora e mëparshme dizajni grafik dhe fushat me të cilat merret. Mësuesi/ja pyet nxënësit: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Cili është ai proces që bën dizajneri për të krijuar gazetën ose revistën? Ndalesa bëhet te shtypi, pra te faqosja.</li> <li>- Cila revistë ju pëlqen më shumë? Pse?</li> <li>- Po ju a do të dëshironit të kishit revistën tuaj të klasës? Nxënësit japin komentet e tyre.</li> <li>- Çfarë gjërash ju pëlqen të lexoni më shumë ose të informoheni shpesh?</li> <li>- Çfarë mund të ofronit ndryshe në një revistë? Nxënësit japin komentet e tyre.</li> </ul> Mësuesi/ja pasi dëgjon mendimet e nxënësve sqaron se detyra në vazhdim është revista e klasës.			
<b>Realizimi i kuptimit:</b> Mësuesi/ja shpjegon se orët në vazhdim janë projekt me titull “Revista jonë”. Pyet nxënësit: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Cili është hapi i parë për krijimin e një reviste? (Titulli.)</li> <li>- Çfarë duhet të ketë një revistë që të jetë e pëlqyeshme dhe me interes? Duhet të ketë rubrika interesante të vlefshme dhe shumë foto.</li> </ul> Mësuesi/ja shpjegon se ky projekt ndahet në tri faza. Ky projekt do të zhvillohet në grup dhe pjesëmarrja e secilit anëtar është shumë e rëndësishme për mbarëvajtjen e punës. Në fazën e parë mësuesi/ja ndan klasën në grupe prej 4 vetë. Çdo grup do të ketë një drejtues grupi. Ky drejtues ndjek punën hapa pas hapi për mbarëvajtjen e revistës. Çdo grup përzgjedh një titull dhe e palos letrën. Mësuesi/ja i mbledh në një kuti i përzien dhe merr një nxënës nga klasa përzgjedh një nga letrat e palosura. Më pas çdo grup ndan detyrat mes anëtarëve dhe bën një plan pune ku shkruhet emri i nxënësve			

të grupit dhe detyra që do kryejë secili (cili do të merret me titullin, cili me ilustrimin pamor, cili me tekstin e shkruar dhe cili me faqosjen e të gjitha mjeteve e materialeve). Përcaktohet edhe një afat kohor.

Çdo grup do të ketë një rubrikë të caktuar për të realizuar, të tilla si: *faqja informuese* (veprimtaritë që ka zhvilluar klasa, si ekskursionet, shfaqje, ditëlindje, konkurse, olimpiada etj.), *faqja artistike* (pikturë, poezi, muzikë, lojëra gjuhësore etj.), *faqja sportive* (gara, futboll, basketboll etj.), *faqja shkencore* (eksperimente, kuriozitete, enigma), *faqja e të rejave të fundit*, *faqja e njerëzve të shquar*, *faqja e reklamave* etj.

Çdo rubrikë do të ketë një titull dhe nxënësit duhet të përgatiten edhe për ballinën e revistës. Mësuesi/ja paraqet disa modele revistash për fëmijë.

Nxënësit u referohen edhe librit për t'u orientuar më mirë.


Nxënësit përzgjedhin edhe bazën materiale që do të përdorin për realizimin e revistës.

Të gjithë pjesëtarët e grupit duhet të jenë pjesëmarrës dhe të japin idetë jo vetëm për punën e tyre, por edhe për punën në grup. Për shembull, të gjithë japin alternativat për titullin që do të zgjedhin dhe për mënyrën e realizimit (me stampim, me vizatim apo me ngjitje shkronjash të prera nga gazeta, libra a revista të vjetra).

Nxënësit vazhdojnë punën e pavarur në vëzhgimin e vazhdueshëm të mësuesit që jep edhe sugjerime nëse është e nevojshme për çdo grup.

#### **Përforsimi i njohurive:**

Mësuesi/ja fton nxënësit që të bëjnë një përmbledhje të punës së deritanishme të fazës së parë të projektit. Materialet futen në dosje që të vazhdojë puna orën tjetër.



**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre.

**Detyra:**

<b>Planifikimi i orës mësimore - 14</b>			
<b>Tematika:</b> Teknika dhe procese	<b>Lënda:</b> Art pamor 6	<b>Tema:</b> Projekt. Revista jonë (ora II)	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>		<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</b> Nxënësi/ja përzgjedh mjetet për të realizuar revistën dhe ndan detyrat.</li> <li>• <b>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin</b> Nxënësi/ja ndërmerr nisma për të realizuar revistën dhe kontribuon në mënyrë krijuese.</li> <li>• <b>Kompetenca digjitale</b> Nxënësi/ja gjen, prodhon, krijon, prezanton dhe shkëmben informacion në rrjetet informuese në internet si dhe bashkëpunon në grup për krijimin e revistës.</li> </ul>		<b>Nxënësi/ja:</b> ✓ përzgjedh fotot dhe materialet ilustruese; ✓ harton tekstin sipas rregullave; ✓ ideon ngjitjen e fotografive në përshtatje me tekstin.	
<b>Mjetet e punës:</b> fletore vizatimi, laps HB, ngjitës, gërrshërë, revista, gazeta, ngjyra, stampa, kompjuter, dosje.			
<b>Burimet:</b> Teksti - Art pamor 6		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> histori, TIK, gjuhë.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b> <i>Diskutim, marrëdhënia pyetje–përgjigje, vëzhgim punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, krahasim, interpretim.</i>			

**Përshkrimi i situatës:**

*Diskutim.* Mësuesi/ja fton nxënësit të nxjerrin materialet nga dosjet dhe të rikujtohet plani I punës për çdo nxënë. Drejtuesit e grupeve sipas shënimeve të mbajtura udhëzojnë shokët e grupit të kryejnë punët e papërfunduara në orën e parë (nëse ka).

Mësuesi/ja i lë nxënësit të lirë për pak minuta të diskutojnë për vazhdimin e punës dhe të ndajnë idetë ose mendimet e reja që kanë. Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Si mendoni për fazën e parë të projektit i realizuat qëllimet që i kishit vënë vetes?

- Çfarë mund të përmirësoni në punën tuaj ose në marrëdhënie me shokët e grupit? A ishin të gjithë pjesëmarrës?

**Realizimi i kuptimit:**

Mësuesi/ja shpjegon se vazhdon projekti “Revista jonë”, faza II, jep dhe hapat e punës që duhet të ndjekin nxënësit.

Çdo grup duhet:

- a) të përzgjedhë fotografite, pikturat, skicat.
- b) të sipas tekstit duhet të organizohen nënçështjet



- c) të kombinojë tekstin me figurat dhe të provojë alternativa të ndryshme
- d) të vendosin në bashkëpunim se cila është më e përshtatshme
- e) të ngjisë fotografitë, pikturat, skicat, në letrën me formatin e përcaktuar për revistën.

Nxënësit punojnë në grup duke ndarë idetë dhe mendimet dhe duke respektuar njëri- tjetrin. Punojnë duke iu referuar modelit në libër për ballinën dhe faqet e brendshme. Mësuesi/ja jep shembuj nga revistat se si mund të organizohet një faqe e brendshme. Gjithmonë duhet pasur parasysh që çdo fotografi apo pamje duhet të ketë lidhje me tekstin.

**Përforcimi i njohurive:**

Mësuesi/ja fton nxënësit që të bëjnë një përmbledhje të punës së deritanishme të fazës së dytë të projektit. Rubrikat e përfunduara mblihen sipas faqeve dhe ngjiten me njëra- tjetrën. Futen në dosje që të jenë gati për prezantimin në orën tjetër.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre.

**Detyra:**

**Planifikimi i orës mësimore - 15**

<b>Tematika:</b> Teknika dhe procese	<b>Lënda:</b> Art pamor 6	<b>Tema:</b> Projekt. Revista jonë (ora III)	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>		<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</b> Nxënësi/ja përzgjedh mjetet për të realizuar revistën dhe ndan detyrat;\.</li> <li>• <b>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin</b> Nxënësi/ja ndërmerr nisma për të realizuar revistën dhe kontribuon në mënyrë krijuese.</li> <li>• <b>Kompetenca digjitale</b> Nxënësi/ja gjen, prodhon, krijon, prezanton dhe shkëmben informacion në rrjetet informuese në internet si dhe bashkëpunon në grup për krijimin e revistës.</li> </ul>		<p><b>Nxënësi/ja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>√ përzgjedh prezantuesin/en e rubrikës;</li> <li>√ tregon interes dhe vëmendje për punimet e grupeve të tjera;</li> <li>√ analizon, vlerëson punën e tij/saj dhe të grupeve të tjera.</li> </ul>	
<b>Mjetet e punës:</b> fletore vizatimi, laps HB, ngjitës, gërshërë, revista, gazeta, ngjyra, stampa, kompjuter, dosje.			
<b>Burimet:</b> Teksti - Art pamor 6		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Histori, TIK, Gjuhë.	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>  <i>Diskutim, marrëdhënia pyetje–përgjigje, vëzhgim punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, krahasim, interpretim.</i></p>			



**Përshkrimi i situatës:**

*Diskutim.* Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të përmbledhin materialet, i ndihmon grupet për të paraqitur sa më mirë punën e bërë duke bërë komentet e duhura.

Fton grupet të zgjedhin nga një përfaqësues/se që të prezantojë punën e bërë.

**Realizimi i kuptimit:**

Mësuesi/ja shpjegon se projekti “Revista jonë”, arriti në fazën III, përfundimtare dhe ku çdo grup do të prezantojë punën e bërë. Udhëzon nxënësit prezantues për pikat ku do të mbështeten në prezantimin e punës:

- a) Në përzgjedhjen e rubrikës dhe të titullit të saj;
- b) Në përzgjedhjen e tekstit sipas rubrikave;
- c) Në përshtatjen e fotografive me përmbajtjen;
- d) Në pjesëmarrjen e anëtarëve të grupit;
- e) në realizimin e komponentëve;

Mësuesi/ja fton nxënësit të jenë të vëmendshëm sepse në fund do të dali grupi që i ka realizuar më mirë rubrikat, sipas rregullave të përcaktuara.

Mësuesi/ja ndihmon nxënësit të bashkëngjisin rubrikat sipas radhës për të krijuar revistën e klasës.

**Përforcimi i njohurive:**

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Si ju duket revista?
- A mendoni se e keni arritur qëllimin?
- Mendoni se gjithçka vajti sipas parashikimeve tuaja?

Mësuesi/ja i lë nxënësit të lirë të diskutojnë.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre.

**Detyra:**

**Planifikimi i orës mësimore - 16**

<b>Tematika:</b> Teknika dhe procese	<b>Lënda:</b> Art pamor 6	<b>Tema:</b> Konstruksioni	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>		<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>● <b>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</b> Nxënësi/ja krijon ide të qarta për krijimtarinë e tij/saj, mbi procesin e riciklimit në lidhje me artin.</li> <li>● <b>Kompetenca personale</b> Nxënësi/ja zhvillon besimin te vetja gjatë veprimtarive artistike.</li> <li>● <b>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin</b> Nxënësi/ja kupton dhe gjen zgjidhje për problemet ekologjike, duke u ndërgjegjësuar për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit.</li> </ul>		<p><b>Nxënësi/ja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>√ përzgjedh materialet e duhura për ndërtimin e një strukture;</li> <li>√ përdor materiale të riprodhueshme për të bërë një konstruksion;</li> <li>√ vlerëson rolin e riciklimit si një proces të rëndësishëm në art.</li> </ul>	

**Mjetet e punës:** letra e kartonit, tela të përkulshëm, drunj me nyje, unaza perdes, material copash të qepura, tapa shishesh, shishe plastike, Cd- i të vjetra, lëvozhga vezësh, vinovil, gërshërë, enë plastike.

**Burimet:** Teksti - Art pamor 6

**Lidhja me fushat e tjera:** histori, aftësim.  
teknologjik

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**  
*Diskutim, marrëdhënia pyetje–përgjigje, vëzhgim,  
punë e pavarur, krijimtari artistike,  
analizë, vlerësim, krahasim, interpretim*

### **Përshkrimi i situatës:**

*Diskutim.* Mësuesi/ja nxit bisedën nëpërmjet pyetjeve:

- Në shtëpinë tuaj ka objekte të përdorura, lodra, kartona etj?
- Çfarë bëni me to?
- Kur mbaroni shkollën çfarë bëni me dollapin tuaj?
- Ç’do të thotë për ju fjala “riciklim”? Ripërdorimi i mjeteve dhe objekteve të përdorura për të krijuar një të ri.
- Emërtoni disa objekte që mund të riciklohen?
- Çfarë mund të krijojmë me sendet e ricikluara?

Mësuesja pret me durim përgjigjet e nxënësve dhe shkruan në tabelë mendimet më të spikatura rreth temës.

### **Realizimi i kuptimit:**

*Marrëdhënia pyetje–përgjigje.* Mësuesi/ja shpjegon konceptet kyçe të mësimit duke e ilustruar me foto e shembuj.

#### **- Konstruksioni është figurë dypërmasore apo trepërmasore?**

Pyet nxënësit:

- Çfarë ju vjen në mendje kur themi “art”?
- Ku e gjejmë artin zakonisht? Po jetën tonë, në mjediset ku ne jetojmë?

Nxënësit japin mendimet e tyre lirshëm.

Mësuesi/ja përmbledh mendimet e nxënësve për fjalën art që është e pranishme jo vetëm në galeritë e arteve dhe muze, por e në jetën e përditshme në shtëpi, rrugë, kudo.

Nxit nxënësit të flasnin rreth fotos me armë, në Muzeun Kombëtar (te libri).

- Çfarë paraqet kjo foto? Sa përmasore është?
- Me çfarë mjetesh është krijuar? (Me armë të vjetra.)
- Sipas mendimit tuaj si mund ta klasifikojmë këtë vepër arti?

Mësuesi/jap dëgjon komentet e tyre dhe saktëson se kjo vepër është trepërmasore.

- Çfarë ju sjell ndërmend fjala “konstruksion”? Ku përdoret më shumë? (Fjalën “konstruksion” e gjejmë më shumë të përdoret në ndërtim. Edhe vepra gjendet në Muzeun Kombëtar është konstruksion (instalacion).)

Mësuesi/ja shpjegon se *konstruksioni* është bashkimi (ngjitja) i disa pjesëve për të ndërtuar një objekt, por ndryshe nga kolazhi, ky është objekt trepërmasor dhe transmeton një mesazh.



- Si mendoni, a transmeton një mesazh konstruksioni në Muzeun Kombëtar? (Luftën e popullit tonë në rrugën e gjatë të historisë.)

Mësuesi/ja vendos në tabelë foto të konstruksioneve të ndryshme dhe fton nxënësit të gjejnë materialet përkatëse për secilën.

**- Si realizohet konstruksioni? Ç’materiale përdoren për të krijuar konstruksionet?**

Këto konstruksione janë bërë me material të ndryshme të riprodhueshme:

- Kafshët e fermës me tubat e letrës dhe punëdore;
- Palloi me enë plastike;
- Abazhuri me shishe plastike;
- Pema me shishe qelqi;
- Papagalli me tuba dhe letër krep;
- Kompozim me letra të ricikluara;
- Çanta me butonat e tastierës së kompjuterit;
- Karrige me kartonët e kutive;
- Peshku me kanaçe;
- Pema me qese plastike;
- Dhoma me lodra të prishura;
- Letra të prera me forma;
- Pula me lëvozhga vezësh të thyera;
- Peshku me shishe plastike në plazh;
- Macja me CD-i;
- Dallgët me materiale të ndryshme të riprodhueshme.



**- A është konstruksion një figurë e bërë me kube ndërtuese (lego)?**

Mësuesi/ja nxit nxënësit të japin përgjigjen e saktë.

- Po ju a keni dëshirë të bëni një konstruksion me materialet që keni sjellë?

Mësuesja shpjegon se si do të punohet hap pas hapi. Mund edhe t'i shkruajë shkurtimisht hapat në tabelë.



### Krijimtari artistike. Hapat e realizimit të konstruksionit

1. Retë. Priten retë nga një karton i bardhë. Lyhet sipërfaqja, ngjitet përsipër pambuk dhe lihen të thahen. Nga pas u ngjitet një tape shishesh vere ose një copëz bukëpeshku.

2. Dielli. Vizatohet dielli në një karton të verdhë dhe priten. Nga pas i ngjitet një tapë shishesh vere ose një copëz bukëpeshku.

3. Toka. Vizatohet dhe priten format e maleve. Në majë të malit ngjitet pak letër e bardhë (si borë). Për të krijuar idenë e relievit si bazament vendoset një kuti e vogël ose bukëpeshku, mbi të cilën ngjiten malet (shihni figurën). Një pjesë e bazamentit “vishet” me letra të gjelbra (si bar).

4. Uji. Qeset e kaltra të plastmasës bëhen tub dhe priten në rripa. Më pas rripat hapen sipas gjatësisë. Disa prej tyre ngjiten (si shi), te retë dhe te pjesa e mbetur të kartonit (si lumë), me kapëse letrash prej metali.

5. Avujt e ujit. Plastmasa me flluska pritet në rripa dhe ngjitet në pjesën “e lumit” me ngjitës të dyanshëm shirit. Skemës trepëmasore mund t’i shtohen edhe shigjeta ose etiketa, që shpjegojnë emërtimin e dukurive (kondensimi, avullimi etj.).

Punimi lihet të thahet për disa orë ose një natë. (Shikoni modelin në libër)

### Përforcimi i njohurive:

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Çfarë mund të themi për konstruksionet nisur nga ndjesitë tuaja sot?
- Për se shërbejnë konstruksionet me material të riprodhueshme?

Mësuesi/ja nxit nxënësit që të dalin në përfundimin, se: duke përdorur materialet e riciklueshme rritim imagjinatën krijuese dhe kontribuojmë edhe në pastrimin dhe ruajtjen e mjedisit ku jetojmë.

Një ide se si të ruajmë mjedisin rreth nesh është arti në komunitet me temën “Mesazh në shishe”, ku të gjithë pavarësisht moshës të krijojnë një konstruksion të madh, për mbrojtjen e mjedisit dhe në çdo shishe të vedoset një mesazh ndërgjegjësues.



**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre.

**Detyra:** Nxënësit punojnë sipas rubrikës ushtrohuni.

## Tematika 3 – Historia e artit dhe shoqëria

Planifikimi i orës mësimore – 1			
<b>Tematika:</b> Historia, arti dhe shoqëria	<b>Lënda:</b> Art pamor 6	<b>Tema:</b> Arti si pasqyrim i shpirtit	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>		<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kompetenca e të komunikimit dhe e të shprehurit</b> Nxënësi/ja njeh ndryshimet e artit sipas periudhave të ndryshme.</li> <li>• <b>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</b> Nxënësi/ja përmirëson njohuritë nëpërmjet bashkëveprimit me nxënësit e tjerë.</li> <li>• <b>Kompetenca digjitale</b> Nxënësi/ja i përdor teknologjinë për të zgjeruar njohuritë e veta.</li> </ul>		<b>Nxënësi/ja:</b> ✓ percepton si ka evoluar arti figurativ ndër shekuj; ✓ përdor fjalorin e duhur për të komunikuar vlerësimin e tij/saj, kërkon informacionin e duhur; ✓ analizon dhe vlerëson artin si pasqyrë të shpirtit dhe krahason periudha të ndryshme artistike.	
<b>Mjetet e punës:</b> informacione shtesë të printuara			
<b>Burimet:</b> Teksti - Art pamor 6		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Histori, TIK.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b> <i>Diskutim, marrëdhënia pyetje- përgjigje, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim</i>			

<p><b>Përshkrimi i situatës:</b>  <i>Diskutim, vëzhgim.</i> Mësuesi/ja pyet nxënësit:                      - Pse ju pëlqen arti? Nxënësit japin komentet e tyre.                      - A ka pësuar ndryshime arti në kohë dhe në formë?                      Nxënësit japin përgjigje edhe duke u nisur nga njohuritë që kanë në lëndën e historisë.                      - Si mendoni kur kanë filluar njerëzit të bëjnë art?                      Mësuesi/ja dëgjon me durim mendimet e nxënësve dhe drejton bisedën.</p> <p><b>Realizimi i kuptimit:</b>                      Mësuesi/sja shpjegon konceptet kyçe të mësimit duke e ilustruar me pamje dhe shembuj.  <i>Marrëdhënia pyetje- përgjigje.</i> Mësuesi/ja pyet nxënësit:                      - Cilat janë krijimet që i përkasin artit?                      - Çfarë paraqesin njerëzit në veprat e tyre? Nga e marrin motivin, temën?                      - Ç’është arti në vetvete?                      Nxënësit përgjigjen. Mësuesi/ja saktëson konceptin e fjalës “art”. Artet janë një formë bazike e komunikimit njerëzor.                      - Art mund të quhen vetëm krijimet në pikturë, skulpturë, arkitekturë, apo edhe më gjerë?                      Nxënësit japin komentet e tyre. Mësuesi/ja saktëson se fjala <i>art</i> përfshin jo vetëm artet pamore, por edhe muzikën, letërsinë, poezinë dhe është konsideruar si qëllim nga njerëzit dje dhe sot, që nëpërmjet artit shprehin veten e tyre në pamje dhe tinguj unikë që kapin interesin, imagjinatën, dhe vlerësimin për të tjerët.                      Mësuesi/ja pyet dhe pret përgjigjet e nxënësve:                      - Pse e studiojmë artin?</p>
---

Mësuesi/ja përmbledh mendimet e nxënësve dhe shpjegon: Në bashkëpunim me kënaqësisë që na ofron arti një studim i artit do t’ju ndihmojë që të kuptoni veten dhe ata rreth jush. Ju mund të filloni të studioni veprat e krijuara nga artistët të cilët paraqesin kultura dhe periudha të ndryshme nga kjo e juaja. Duke studiuar shprehjen krijuese të artistëve nga të gjitha llojet, ju mund të bëheni me dije të besimeve, ideve dhe ndjenjave të njerëzve të origjinave, etnive zakoneve dhe kulturave të ndryshme.

- *A mendoni se arti ka kaluar në disa periudha të ndryshme?*

Pret përgjigjet e nxënësve. Mësuesi/ja i vendos të ç’rregullta pamjet nga arti i shpellave, arti egjiptian, bizantin, kinez dhe japonez, ekspresionizmi, artin abstrakt, romantizmi dhe futurizmi. Nëse nuk mund t’i gjejë të gjitha atëherë le të fotokopjojë fotot nga teksti. Fton nxënësit të gjejnë shtrirjen kohore të pamjeve që ka vendosur. Kërkon nga nxënësit që të bëhet një renditje sipas mendimit të tyre. Nxënësit renditin pamjet sipas idesë së tyre. Nxit nxënësit të flasin për ndryshimet që ka secila periudhë.

Mësuesi/ja rendit sipas radhës pamjet dhe ndërkohë, jep karakteristikat dalluese për secilën periudhë. Fton nxënësit të gjejnë tiparet e veçanta për periudha të ndryshme.

- *Çfarë vini re në veprat e periudhave që përmendëm? Me kë kanë lidhje? (Me me spiritualizmin, besimin, jetën e përditshme, imagjinatën, emocionet, frikën nga realiteti, ritmet e shpejta që ecën jeta etj).*

- **Cilat janë tiparet kryesore që bashkojnë këto periudha të ndryshme të historisë së artit?**

- *Ju përmendët tiparet dalluese të periudha të ndryshme të artit. Mendoni se kanë këto periudha një pikë të përbashkët?*

Mësuesi/ja i drejton që të dalin në përfundimin se arti është pasqyrim i shpirtit.

- **Pse themi se ato janë “pasqyrë e shpirtit”?**

Mësuesi/ja pret mendimet e nxënësve dhe saktëson se artistët në të gjitha kohërat i bashkon impulsi i brendshëm ose i jashtëm për të krijuar, pra nëpërmjet përdorimit të elementeve të artit çdo artist shpreh botën e brendshme shpirtërore, prandaj krijimet janë shumë të veçanta.

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që në një fletë të shkruajnë tiparet kryesore dalluese dhe të përbashkëta të periudhave të ndryshme të artit duke u nisur nga pamjet e renditura në tabelë ose nga pamjet në tekst. Mësuesi i nxit që nxënësit të përdorin fjalorin e duhur artistik dhe të bashkëveprojnë me njëri- tjetrin duke drejtuar pyetje dhe përgjigje.

Mësuesi/ja ka bërë më parë fotokopje të disa veprave që ilustrojnë mësimin e ditës dhe ua jep nxënësve të ndarë në grupe në formën e formueseve (pazëll). Nxënësit e formojnë pamjet dhe duhet të gjejnë edhe periudhën që i përket dhe ndonjë tipar dallues që mban mend.

Fiton grupi që e bën shpejt formuesen dhe jep përgjigjen e duhur.

**Përforcimi njohurive:**

*Krahasim.* Mësuesi u drejton pyetje:

- *Çfarë kanë të veçantë dhe të përbashkëta këto periudha?*

Nxënësit nxjerrin përfundimet e tyre dhe mësuesi përzgjedh ato më të saktat:

Nga periudha në periudhë vihet re ndryshimi i paraqitjes së imazheve pamore, vihet re aftësia artistike e krijuesve dhe ajo që i bashkon, është se artin e paraqesin si pasqyrim të shpirtit, pra krijojnë artin e emocioneve të brendshme, brenda ose jashtë realitetit.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre.

**Detyra:** Nxënësit mbledhin informacion për periudhën që i pëlqeu më shumë dhe e ilustrojnë me jetën e ndonjë piktori që i tërheq.

<b>Planifikimi i orës mësimore – 2</b>			
<b>Tematika:</b> Historia, arti dhe shoqëria	<b>Lënda:</b> Art pamor 6	<b>Tema:</b> Arti si pasqyrim i realitetit	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>		<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>● <b>Kompetenca e të menduarit</b> Nxënësi/ja merr dhe përpunon njohuritë vizuale në mënyrë të pavarur dhe krijuese.</li> <li>● <b>Kompetenca personale</b> Nxënësi/ja përfshihet në mënyrë aktive në orën e mësimit.</li> <li>● <b>Kompetenca qytetare</b> Nxënësi/ja diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</li> </ul>		<b>Nxënësi/ja:</b> ✓ bën dallimin midis periudhave të ndryshme të artit dhe njeh tiparet e secilës periudhë; ✓ krijon duke u frymëzuar nga një periudhë e caktuar; ✓ analizon dhe krahason periudhat e ndryshme dhe vlerëson rolin e artit në histori dhe kulturë.	
<b>Mjetet e punës:</b> <i>informacione shtesë, foto, libër arti.</i>			
<b>Burimet:</b> Teksti - Art pamor 6		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Histori, TIK.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b> <i>Diskutim, marrëdhënia pyetje- përgjigje, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike analizë, vlerësim, interpretim</i>			

**Përshkrimi i situatës:**

Vëzhgim. Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Nëse dy artistë pikurojnë të njëjtën pejsazh mendoni se ka ndryshime? Pse?

Çdo artist krijon një version të pamjes që reflekton idetë dhe ndjenjat e tij personale.

- Cila karakteristikë bashkonte periudhat e ndryshme?

Arti si pasqyrim i shpirtit. Të gjitha periudhat kishin në themel botën e brandshme shpirtërore të artistëve.

- Mendoni se ky është qëllimi i vetëm i artit pasqyrimi i shpirtit?

Nxënësit japin komentet e tyre.

**Realizimi i kuptimit:**

Mësuesi/ja shpjegon konceptet kyçe të mësimit duke e ilustruar me pamje dhe shembuj.

Mësuesi/ja shkuan në tabelë:

Arti grek, arti romak, rilindja, impresionizëm, surrelizëm, pop-art.

*Marrëdhënia pyetje- përgjigje.* Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Çfarë ju vjen në mend kur lexoni këto emërtime?
- A mund të përshkruani fotot në libër?

Mësuesi/ja fton nxënësit të komentojnë fotot sipas radhës duke përshkruar atë që shohin. Mësuesi/ja ndalet te secila periudhë dhe jep karakteristikat dalluese të tyre. Nxënësit përshkruajnë një foto, mësuesi/ja plotëson informacionin dhe u shkruan në tabelën përbri periudhave nga një karakteristikë kryesore.

**- Cilat janë tiparet kryesore që bashkojnë këto periudha të ndryshme të historisë së artit?**

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Çfarë paraqesin artistët e periudhave të ndryshme në krijimet e tyre? Tema janë nga jeta e përditshme. Në këto periudha artistët kërkojnë rrugë të reja, studiojnë anatominë e njeriut, paraqesin

jetën e përditshme dhe realitetin, pikturonin direkt nga natyra, kemi artin e masave etj.

- Arti nga periudha në periudhë ka pësuar ndryshime progresive apo ka lëvruar të njëjta teknika dhe tema?



- Në periudhat e ndryshme artistike arti ka pësuar ndryshime progresive, artistët eksplorojnë botën dhe natyrën dhe eksperimentojnë me teknika të reja dhe një këndvështrim të ri për botën që na rrethon.

#### - Pse themi se arti është pasqyrim i realitetit?

Mësuesja nxit nxënësit nëpërmjet pyetjeve që të dalin në përfundimin se në të gjitha periudhat që pamë më lart, në letërsi dhe arte, mbizotëroi vëmendja e artistëve ndaj realitetit dhe ndaj shoqërisë.

*Krijimtari artistike.* Mësuesi/ja fton nxënësit që duke u frymëzuar nga periudha që u pëlqen më shumë të krijojnë në mënyrë inovative një krijim sipas dëshirës. Mësuesi/ja jep shembuj për ta ilustruar.

- vazo dhe motive, arti grek
- kolazh me foto, ose mozaik, arti romak
- maket i një makine fluturuese, arti i rilindjes
- krijim me pika, impresionizmi
- kolazh, surrealizmi
- ngjyra të ndryshme i njëjti model, pop art
- krijim me lapsa me ngjyra, hiperrealizmi, ose mund të punosh me ngjyra sipër një fotoje nga fleta e një kalendari etj.



#### Përforcimi i njohurive:

*Vlerësim.* Mësuesi u drejton pyetje:

#### - Cila ka qenë dëshira më e hershme e artistëve?

Pasqyrimi i realitetit në art, ashtu si “e sheh” syri, ka qenë një dëshirë e hershme e njeriut. Në periudha të ndryshme dhe në popuj e kultura të ndryshme kjo përpjekje ka zënë vendin kryesor në punën e artistëve. Nxënësit japin komentet e tyre dhe diskutojnë në bashkëpunim me shokët dhe shoqet e klasës.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre.

**Detyra:** Nxënësit mbledhin informacion për artistin Leonardo da Vinci. I cili nuk ishte vetëm artist, por edhe një vëzhgues i madh, shpikës i armëve, mekanik, piktor, skulptor, arkitekt, ideoi makina fluturuese, njohës shumë i mirë i trupit të njeriut, pra ishte një gjeni. Nxënësit mund të ndahen edhe me grupe dhe çdo grup trajton një cilësi të artistit.



<b>Planifikimi i orës mësimore – 3</b>			
<b>Tematika:</b> Historia, arti dhe shoqëria	<b>Lënda:</b> Art pamor 6	<b>Tema:</b> Arti shqiptar në vite	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>		<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>● <b>Kompetenca e të menduarit</b></li> <li>- Nxënësi/ja zhvillon të menduarit kritik.</li> <li><b>Kompetenca personale</b></li> <li>- Nxënësi/ja zhvillon besimin te vetja gjatë krijimtarisë artistike.</li> <li>● <b>Kompetenca qytetare</b></li> <li>- Nxënësi/ja respekton dhe vlerëson artin shqiptar.</li> </ul>		<b>Nxënësi/ja:</b> ✓ merr pjesë në diskutim; ✓ përdor teknika të ndryshme në favor të temës; ✓ analizon tiparet më të spikatura të artit shqiptar në vite.	
<b>Mjetet e punës:</b> informacione shitesë, hartë, foto, libër arti, revista dhe gazeta.			
<b>Burimet:</b> Teksti - Art pamor 6		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Histori, TIK, Gjeografi.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b> <i>Diskutim, marrëdhënia pyetje- përgjigje, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike analizë, vlerësim, interpretim</i>			

**Përshkrimi i situatës:**

Mësuesi/ja ka porositur një orë më parë nxënësit për bazën material për temën e sotme.

Vëzhgim. Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Çfarë keni mësuar në lëndën e historisë dhe gjeografisë për Shqipërinë? Cilat kanë qenë periudhat më të rëndësishme?
- Nga i dimë ne sot se çfarë ka ndodhur para mijëra vitesh? (Kërkimet arkeologjike.)
- A mund të përmendni disa vepra arkeologjike në gjini të ndryshme të artit shqiptar?

Nxënësit japin mendimet dhe komentet e tyre. Mësuesi/ja i dëgjon dhe shkruan në tabelë ato periudha që i interesojnë për temën e sotme.

**Realizimi i kuptimit:**

Mësuesi/ja shpjegon konceptet kyçe të mësimit duke e ilustruar me pamje dhe shembuj.

**- Në cilën periudhë historike i gjejmë gjurmët e para të artit shqiptar?**

*Marrëdhënia pyetje-përgjigje.* Mësuesi/sja vendos disa pamje në tabelë dhe fton nxënësit të gjejnë qytetet se ku ndodhen këto pamje.



Nxënësit japin përgjigjet e tyre duke emërtuar secilën nga pamjet.

Mësuesi/ja saktëson se fillimet e artit shqiptar fillojnë që nga neoliti. Këto pamje i përkasin periudhave shumë të hershme që dëshmojnë për jetën e pasur artistike në qytetet kryesore.

**- Cili është autori më i shquar i pikturës mesjetare shqiptare?**

Mësuesja vendos hartën e Perandorisë së Bizantit dhe pyet nxënësit:

- Cilën periudhë paraqet harta?

Pret përgjigjet e nxënësve. Gjatë mesjetës Shqipëria ishte nën sundimin e Perandorisë së Bizantit. Arti i kësaj periudhe përmban të gjitha tiparet karakteristike të artit bizantin.

- *Cili ikonograf shqiptar është më i famshëm në këtë periudhë dhe mjeshtër i cilës ngjyrë?*

Për këtë dëshmojnë veprat e artistit shqiptar Onufri (shek. XVI), që shquhet në përdorimin mjeshtëror të ngjyrës së kuqe. Mësuesi/ja fton nxënësit të shohin ilustrimin në libër.

- **Cilët janë artistët kryesorë të pikturës shqiptare në fillimet e shek. XX?**

Mësuesi/ja shkruan disa emra artistësh shqiptarë:

*Simon Rrota, Spiro Xega, Andrea Kushi dhe Zef Kolombi, Odhise Paskali.*

Mësuesi/ja vendos pamje të disa veprave të këtyre autorëve në tabelë.



Pyet nxënësit:

- *Çfarë ju thonë këto emra? Cilës periudhë i përkasin?*

Mësuesi/ja përmbledh mendimet e tyre dhe saktëson se këta janë artistë dhe i përkasin periudhës së Rilindjes dhe Pavarësisë. Përveç pikturës, u zhvillua edhe skulptura.

- *Si mendoni a ndryshon arti i Rilindjes dhe Pavarësisë nga arti mesjetar? Pse?*

- *Arti i kësaj periudhe u ngrit në një nivel më të lartë artistik.*

- **Pse themi se arti i realizmit socialist është një art ideologjik?**

Mësuesi/ja vendos pamje në tabelë që i përkasin realizmit socialist. (Sali Shijaku, Ismail Lulani, Shaban Hysa, Lumturi Dhrami, Vilson Halimi)

- *Si mendoni për këto vepra? A kanë ndryshim nga periudhat e mëparshme?*

Mësuesi/ja pret komentet e nxënësve dhe përmbledh mendimet e tyre. Jep informacion për:

Realizmi socialist është një nënrymë e stilit realist në art që kishte për qëllim të përhapte doktrinën komuniste, duke ndikuar në ndërgjegjen e qytetarëve dhe pikëpamjet e tyre mbi jetën.



Realizmi socialist ishte stili i miratuar i të gjithë shteteve socialiste, ku stilet moderne si kubizmi dhe impresionizmi ishin të ndaluar. Po ashtu, mendohej se këto forma arti nuk do të kuptoheshin nga populli ndaj nuk mund të përdoreshin. Realizmi socialist konsiderohej si një mënyre totalitare e shtetit për të kontrolluar artistët. Pra, artistët nuk mund të krijonin të lirë sipas ideve dhe ndjenjave të tyre.



Mësuesi/ja vendos pamje që ilustrojnë artin e pas viteve '90.

*Arti është i lirë të paraqesë çdo gjë si duhet.*

*- Piktoret, janë: Ali Oseku, Pashk Përvathi, Helidon Haliti, Gazmend Leka, Lumturi Blloshmi, Shpeng Bengu, Alush Shima etj.*

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

*- Çfarë vini re te piktura e pas viteve 90?*

Nxënësit japin mendimet e tyre duke iu referuar fotove. Mësuesja saktëson se me ndryshimin e sistemeve në Shqipëri edhe arti pësoi ndryshime rrënjësore dhe artistët nuk ishin më të detyruar të krijonin sipas një ideologjie siç bënin më parë. Artistët krijojnë të lirë dhe e perceptojnë artin secili sipas mënyrës së tij. Sot, ka edhe shumë galeri artesh ku artistët janë të lirë të paraqesin veprat e tyre.



*Krijimatri artistike.* Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që sipas modeleve të dhëna të krijojnë duke iu referuar një periudhe të artit. Këtu paraqiten veshje nga stilistë të ditëve tona të frymëzuara nga arti bizantin.

Nxënësit mund të krijojnë sipas mundësive një mozaik (ky këtu paraqet perëndeshën Teodora). Mund të krijojnë të frymëzuar nga dasma shkodrane një kolazh me foto nga revistat se si krijohen dasmat sot etj. Nxënësit krijojnë vetë sipas preferencave dhe mund të punojnë në grup.



**Përforcimi i njohurive:**

Vlerësim. Mësuesi u drejton pyetje:

- Çfarë mendoni për artin shqiptar ndër vite? Ka pësuar ndryshime në kohë dhe në stil?

Nxënësit vlerësojnë arritje të artit shqiptar ndër vite dhe karahsojnë periudhat me artin sot.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre.

**Detyra:** Nxënësit sjell informacione shtesë për artistët shqiptarë të ditëve tona.

<b>Planifikimi i orës mësimore – 4</b>			
<b>Tematika:</b> Historia, arti dhe shoqëria	<b>Lënda:</b> Art pamor 6	<b>Tema:</b> Në galerinë e artit.	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>		<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>● <b>Kompetenca qytetare</b> Nxënësi/ja diskuton dhe bashkëpunon për çështje të ndryshme kulturore.</li> <li>● <b>Kompetenca personale</b> Nxënësi/ja përcakton informacionin që do të mbledhë.</li> <li>● <b>Kompetenca digjitale</b> Nxënësi/ja mbledh informacion dhe bashkëpunon.</li> </ul>		<b>Nxënësi/ja:</b> ✓ mban shënime paraprake; ✓ merr informacion nga librat e artit; ✓ përzgjedh mjetet e informacionit që do të përdorë.	
<b>Mjetet e punës:</b> fletore, stilolaps, libër arti.			
<b>Burimet:</b> Teksti - Art pamor 6		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> histori, TIK.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b> <i>Diskutim, marrëdhënia pyetje- përgjigje, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike analizë, vlerësim, interpretim</i>			

**Përshkrimi i situatës:**

*Vëzhgim.* Mësuesi/ja më parë ka porositur nxënësit që të kërkojnë në internet për adresat e Galerive që ndodhen në qytetin tuaj. Fton nxënësit të japin informacionin e mbledhur.

- Keni qenë në ndonjë galeri arti? Çfarë keni parë atje?

Mësuesi/ja saktëson se disa piktorë paraqesin veprat e tyre duke krijuar ekspozita personale, por edhe të përbashkëta me artistë të tjerë. Krijimet mund të jenë në pikturë, skulpturë, instalacion, video-

art, skulpturë, grafikë, fotografi etj. Në galeri gjejmë emra piktorësh të njohur dhe të rinj. Personi që merret me përzgjedhjen e punimeve dhe ekspozimin e tyre quhet *kurator*. Po kështu, në muze apo galeri arti ka disa njerëz të specializuar që iu shpjegojnë vizitorëve veprat e artit. Ata njihen me emrin *shpjegues*. Ndërsa, njerëzit që analizojnë veprat e artit dhe shpjegojnë elementet dhe parimet që ka përdorur artisti quhen *kritik arti*.

### Realizimi i kuptimit:

Mësuesi/ja fton nxënësit të shfletojnë librat e artit në mënyrë që të njihen më mirë me artistët dhe veprat e tyre. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit, për vizitën në galeri duhet të mbajnë shënime duke filluar nga emri i galerisë, emrin e piktorit, titullin e veprës, gjininë të cilën ka paraqitur, llojin (portret, pejzash, natyrë e qetë), teknikën (akuarel, vizatim, vaj, etj), elementet dhe parimet e artit që ka përdorur në vepër (vijat, ngjyrat, perspektivën, baraspeshën, dritëhijen, teksturën etj.) mesazhin që jep artisti nëpërmjet veprës dhe a ju pëlqen kjo vepër, ose jo dhe pse. Nxënësit mund të shtojnë vetë ndonjë të dhënë ose tipar për veprën. Ja, një model i formularit.

## Vizitë në galeri ose muze

Emri/mbiemri \_\_\_\_\_ data \_\_\_\_\_ kl. \_\_\_\_\_

Galeri, muze \_\_\_\_\_

Artisti \_\_\_\_\_

Titulli i veprës \_\_\_\_\_

Gjinia \_\_\_\_\_

Lloji \_\_\_\_\_

Teknika \_\_\_\_\_

Elementet dhe parimet \_\_\_\_\_

Mesazhin \_\_\_\_\_

A ju pëlqen vepra dhe pse \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre.

**Detyra:** Nxënësit përgatisin një formular për herën tjetër, sipas udhëzimeve të mësuesit/es.

<b>Planifikimi i orës mësimore – 5</b>			
<b>Tematika:</b> Historia, arti dhe shoqëria	<b>Lënda:</b> Art pamor 6	<b>Tema:</b> Në galerinë e artit.	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>		<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>● <b>Kompetenca qytetare</b> Nxënësi/ja përfshihet në mënyrë aktive dhe etike në jetën në komunitet.</li> <li>● <b>Kompetenca personale</b> Nxënësi/ja vlerëson artin shqiptar dhe mban qëndrim pozitiv ndaj vlerave kulturore kombëtare.</li> <li>● <b>Kompetenca digjitale</b> Nxënësi/ja mbledh dhe përpunon informacionin nëpërmjet teknologjisë.</li> </ul>		<b>Nxënësi/ja:</b> ✓ përmbledh me shënime informacionin; ✓ përcakton veprat që i pëlqejnë më shumë; ✓ përzgjedh informacionin për të krijuar një album.	
<b>Mjetet e punës:</b> fletore, stilolaps, aparat fotografik.			
<b>Burimet:</b> Teksti - Art pamor 6		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> histori, TIK.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b> <i>Diskutim, marrëdhënia pyetje- përgjigje, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike analizë, vlerësim, interpretim</i>			
<p><b>Përshkrimi i situatës:</b>                      Vëzhgim. Mësuesi/ja pyet nxënësit nëse i kanë gati formularët sipas udhëzimeve, jep porositë e rastit se si do të organizohen dhe çfarë hapash do të ndjekin për bajtjen në galeri. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit se në vizitën në muze ose në galeri nuk flasim me zë të lartë dhe nuk prekim asgjë me dorë. Nëse duam të fotografojmë duhet të marrim leje.</p> <p><b>Realizimi i kuptimit:</b>                      Mësuesi/ja shpjegon rregullat e sjelljes gjatë vizitës në muze.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mos pengoni vizitorët e tjerë.</li> <li>2. Mos u ndani nga grupi dhe mbani radhë.</li> <li>3. Mos shtyni të tjerët dhe mos bëni zhurmë.</li> <li>4. Mos prekni sendet e ekspozuara.</li> <li>5. Mos i kaloni duart përtej shiritave të verdhë, sepse aktivizohet sistemi i alarmit.</li> <li>6. Ngrini dorën, në rast se keni pyetje për mësuesen ose shoqëruesin e muzeut (shpjeguesin).</li> </ol> <p><b>Përforcimi i njohurive:</b>                      Analizë. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit:                      - Ngjitini fotot dhe të dhënat e mbledhura në një album të përbashkët. Mund të shtoni pranë tyre edhe arsyet pse ju kanë pëlqyer ose mbresat që iu lënë duke ju referuar edhe formularit që keni përgatitur.</p>			
<b>Vlerësimi:</b> Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre.			
<b>Detyra:</b> Nxënësit nxjerrin përshtypjet e vizitës.			

<b>Planifikimi i orës mësimore - 6</b>			
<b>Tematika:</b> Historia, arti dhe shoqëria	<b>Lënda:</b> Art pamor 6	<b>Tema:</b> Arti popullor	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>		<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>● <b>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit</b> Nxënësi mbledh informacionin, ndan idetë dhe bashkëpunon në grup.</li> <li>● <b>Kompetenca për jetën</b> Nxënësi është i aftë të dallojë vlerat e trashëgimisë kulturore në Shqipëri nëpërmjet përvetësimit të njohurive.</li> <li>● <b>Kompetenca digjitale</b> Nxënësi është i aftë të prezantojë krijimtarinë e tij nëpërmjet përdorimit të teknologjisë.</li> </ul>		<b>Nxënësi:</b> ✓ mbledh informacionin e duhur për artin popullor (veshjet dhe arkitekturën, objekte artizanati etj.); ✓ bashkëpunon në grup; ✓ prezanton informacionin e mbledhur duke vënë në dukje vlerat e trashëgimisë kulturore.	
<b>Mjetet e punës:</b> libër për kostumet popullore, artizanatin, arkitekturën shqiptare, fotografi të ndryshme lidhur me temën, karton, ngjitës, gërshërë, ngjyra etj.			
<b>Burimet:</b> Teksti – Art pamor 6		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> histori, TIK, gjeografi, trashëgimi kulturore.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b> <i>Diskutim, marrëdhënia pyetje- përgjigje, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim</i>			

**Përshkrimi i situatës:**

*Diskutim.* Mësuesi/ja ka porositur nxënësit më parë që të vizitojnë një dyqan me objekte të artizanatit, me stoli, veshje etj. Pyet nxënësit:

- Çfarë ju bëri përshtypje në këtë dyqan me artistike?

Për të ndihmuar nxënësit vendos një foto të një dyqani. Një orë më parë nxënësit duhet të kenë sjellin fotografi të ndryshme që kanë lidhje me trashëgiminë kulturore, artin popullor shqiptar, artizanatin etj., dhe kartonë të mëdhenj. Ndonjëri që ka mundësi, mund të sjellë edhe objekte artizanati ose elemente të veshjeve popullore.

- Çfarë artikujsh patë?




- Keni qenë ndonjëherë në Krujë?

- Çfarë ju ka bërë më shumë përshtypje në pazarin e Krujës afër kalasë? Po në qytete të tjera?

**Realizimi i kuptimit:**

*Stuhi mendimesh.* Shkruhet në tabelë “Arti popullor”. Mësuesi u drejton pyetje nxënësve rreth kostumeve popullore, objekteve të artizanatit etj., në formën e stuhisë së mendimeve. Mendimet e nxënësve shkruhen në tabelë (qeramika, tekstilet, punimi i metaleve, qëndisjet, stolitë) etj.



*Marrëdhënia pyetje-përgjigje.* Mësuesi/ja fton nxënësit të shohin foton. Pyet nxënësit:

- Si quhet kjo pikturë? Cili është autori i saj?

Piktura quhet “Shqipëria vallëzon” dhe është e piktorit A. Buza.

- Pse autori ka zgjedhur këtë titull?

*Ka paraqitur valltarë me veshje popullore nga krahina të Shqipërisë. Për shumë shekuj, veshjet tradicionale shqiptare paraqesin një pamje të qartë të krahinës, llojit të materialit, gjendjes familjare dhe qëndrimin, moshën dhe më shumë.*

*Veshjet janë bërë nga artizanët profesionalë me pambuk, lesh, mëndafsh. Janë dekoruar me ngjyra dhe simbole që qepura, temat, si: shqiponja, forma natyrale, të ndërthurura me fije ari dhe argjendi dhe perla të vogla lumi. Stilet dhe pamja e tyre ndër vite ka ndryshuar sipas materialeve të reja dhe nevojave të tregut, por veçoritë krahinore kanë mbetur.*

Mësuesi/ja paraqet foto të tjera për nxënësit.



Punime artizanale

Mësuesi/ja paraqet veshje dhe banesa nga krahina të ndryshme. Pyet nxënësit:

- Cilës krahinë i përkasin këto veshje, Shqipërisë së Veriut, së Mesme apo të Jugut?

Shqipëri e Mesme

Shqipëri e Veriut







Shqipëri e Jugut



Veshje me xhubletë, Veri



Mësuesi/ja shpjegon tradita shqiptare e kostumeve popullore është shumë e pasur dhe ka shumëllojshmëri të llojeve të këtyre kostumeve, si: Dibra, Gramshi, Librazhdi, Puka, Elbasani, Korça, Tepelena, Vlora, Gjirokastra, Dropulli etj. Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Si mendoni pse ndryshojnë kostumet nga njëri-tjetri si te burrat dhe te gratë? Po elemente të përbashkëta kanë këto kostume?

Mësuesi/ja shkruan në tabelë mendimet dhe komentet e nxënësve për të përbashkëtat dhe të veçantat.

- Cili nga këto kostume ju pëlqen? Pse?

Shumë stilistë frymëzohen nga veshjet tradicionale dhe krijojnë veshje modern duke përdorur një element ose motiv floreal etj. Po ashtu edhe banesat këto janë një pjesë e vogël e tyre sepse ka edhe në qytete të tjera të Shqipërisë banesa karakteristike. Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Ndryshojnë banesat nga njëra krahinë në tjetrën? Pse çfarë ndikon? (Relievi, kushtet atmosferike, gjendja ekonomike, statusi shoqëror etj.)

Mësuesi/ja jep elemente dalluese kryesore të veshjeve si te gratë dhe te burrat, karakteristika të veçanta të banesave etj, sipas krahinave.

*Krijimtari artistike.* Ndahen nxënësit në grupe. Çdo grupi i caktohet një temë lidhur me artin popullor shqiptar duke marrë parasysh preferencat dhe mendimet e nxënësve. P.sh.: grupi i veshjeve në Shqipërinë e Veriut, Mesme dhe të Jugut, grupi i arkitekturës përkatëse dhe grupi i objekteve të artizanatit shqiptar.

Duke u nisur nga tabloja me temë "Shqipëria vallëzon" mësuesi/ja udhëzon nxënësit për punën me grupe sipas specifikave. Grupi i veshjeve mund të stilojë veshje të kohës sonë duke huazuar një element të veshjeve popullore. Grupi i objekteve të artizanatit mund të modelojë me plastelinë disa prej tyre, dhe grupi i arkitekturës mund të vizatojë elemente të ndryshme dhe të veçanta nga ndërtesat karakteristike.

Nëse nxënësit kanë sjellë foto dhe pamje të ndryshme që ilustron artin popullor shqiptar atëherë mësuesi/ja udhëzon grupet që në kartonët e mëdhenj që kanë sjellë të vizatojnë hartën e Shqipërisë së bashku me konturet e krahinave kryesore të Shqipërisë së Veriut, Mesme dhe të Jugut. Çdo grup përmbledh dhe përzgjedh materialet që ka në dispozicion dhe fillon ngjitjen e tyre në vendet përkatëse të hartës. Një grup mund të ketë veshjet popullore të krahinave dhe i ngjit ato sipas vendeve në hartë, po kështu vepron grupi i arkitekturës dhe grupi i artizanatit etj.

Nxënësit bashkëpunojnë në grup dhe ndajnë përgjegjësitë në mënyrë që detyra të mbarojë në kohë. Sipas dëshirës njëri nga grupet mund të bëjë një album me informacionet e mbledhura ose të printuara.



Shtëpi korçare



Shtëpi beratase



Kulla e veriut



Shtëpi shkodrane



Shtëpi tiranase



Shtëpi gjirokastrite

**Përforcimi i njohurive:**

Secili grup paraqet hartën e tij dhe prezanton punën duke nxjerrë në pah karakteristikat e secilës krahinë dhe të evidentojë vlerat e artit popullor shqiptar, të kostumeve, arkitekturës dhe artizanatit.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre.

**Detyra:** Nxënësit për herën tjetër sjellin të detajuar me shkrim tipare më dalluese të veshjeve dhe arkitekturës shqiptare në qytetet kryesore.

<b>Planifikimi i orës mësimore - 7</b>			
<b>Tematika:</b> Historia, arti dhe shoqëria	<b>Lënda:</b> Art pamor 6	<b>Tema:</b> Vizitë në studion e artistit	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>		<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>· <b>Kompetenca e të menduarit</b></li> <li>- Nxënësi/ja zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese.</li> <li>· <b>Kompetenca personale</b></li> <li>- Nxënësi/ja zhvillon besimin në vetvete për talentet që ka.</li> <li>· <b>Kompetenca qytetare</b></li> <li>- Nxënësi/ja respekton dhe mban qëndrim pozitiv ndaj punës së të tjerëve.</li> </ul>		<b>Nxënësi/ja:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Njihet nga afër me veprimtarinë artistike dhe vendin ku krijohet;</li> <li>• Qartëson idetë e veta nëpërmjet bashkëbisedimit;</li> <li>• Vlerëson veprën krijuese të artistit.</li> </ul>	
<b>Mjetet e punës:</b> formular, stilolaps, aparat etj.			
<b>Burimet:</b> Teksti –Art pamor 6		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Histori, TIK, Aftësim teknologjik, Letërsi	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b> <i>Diskutim, marrëdhënia pyetje- përgjigje, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim</i>			

**Përshkrimi i situatës:**

*Marrëdhënia pyetje- përgjigje.* Mësuesi/ja pyet nxënësit:


- *Ka ndonjëri nga ju në familje ose të afërm ndonjë artist, piktor ose skulptor?*
- *Si e organizojnë ditën e tyre?*
- *Me çfarë teknikash punojnë?*

Mësuesi/ja pret përgjigjet e nxënësve dhe shpjegon se artistët kanë vendin e tyre të punë që quhet studio dhe, është vendi më i rëndësishëm për ta.

- *A do t’u pëlqente të vizitonit studion e një artisti?*
- *Si mendoni ju nga e kanë pikënisjen veprat e artit?*

Mësuesi/ja shpjegon se çdo projekt ose ide që lind në mendjen e një artisti fillon nga studio e tij. Aty është pikënisja.

- *A ju duket profesioni i artistit e thjeshtë apo i vështirë?*
- *Sa kohë mund të zgjasë krijimi i një veprë deri në fazën përfundimtare të saj?*  
(Krijimi i një veprë mund të zgjasë me ditë, muaj dhe vite.)





- Pse themi që ky profesion është i vështirë? (Sepse puna për të krijuar një vepër i merr artistit energjitë fizike, mendore dhe intuitive, si dhe shumë kohë.)

Mësuesi/ja u drejton pyetje të tilla me qëllim që t'i ndihmojë nxënësit për vizitën në studion e artistit.

- Artistit, për të krijuar një vepër, i duhet më parë të ideojë një bocet ku të hedhë idenë fillestare. Jo vetëm piktorët por edhe skulptorët kanë studio.

- Çfarë bën një artist përpara se të fillojë punën? Shikoni pamjet.

Mësuesi/ja dëgjon mendimet e nxënësve dhe shpjegon se artistët

më parë krijojnë një model me vizatim, ose me baltë përpara se të fillojnë punën. Po kështu, edhe piktorët.



Rafeloja në studion e tij



Vermer van Delft



Studioja e Pikasos

- Pse këta artistë kanë paraqitur studion e tyre që në para qindra vitesh?

Një studio për artistin është shtëpi e dytë, vendi ku ai kalon kohën më të madhe të ditës, madje harron edhe të largohet prej andej. Pra, është vendi më i dashur për ta.

### Realizimi i kuptimit:

Bisedë. Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Ju duket me interes vizita në një studio piktori? Çfarë mendoni të shikoni atje?

Nxënësit kanë mundësi të shohin nga afër punën e artistit, krijimtarinë e tij në vite, objektet e preferuara etj.

- Si ju duken studiot e paraqitura në libër? Edhe pse të rrëmujshme, kanë qenë djepi i lindjes së kryeveprave botërore.

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit për mënyrën se si do të plotësojnë formularin në mënyrë që kur të vijë në klasë ta kenë të thjeshtë të diskutojnë rreth vizitës.

### Përforcimi i njohurive:

Analizë, vlerësim. Nxënësit duke u bazuar te vizita që bënë në studion e artistit, nxjerrin përfundime për jetën dhe veprën e artistit dhe vlerësojnë rëndësinë e artit si një proces i vazhdueshëm krijimi. Nxënësit dhe do ta krahasojnë me përvojën e tyre, si edhe me njohuritë që kanë marrë në lëndën e *Artit pamor*.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre.

**Detyra:**

<b>Planifikimi i orës mësimore - 8</b>			
<b>Tematika:</b> Historia, arti dhe shoqëria	<b>Lënda:</b> Art pamor 6	<b>Tema:</b> Artet figurative në jetën e përditshme.	<b>Shkalla:</b> 3 <b>Klasa:</b> 6
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>		<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>· <b>Kompetenca e të menduarit</b></li> <li>- Nxënësi thellohet të kuptojë rolin e artit në jetën e përditshme.</li> <li>· <b>Kompetenca për jetën</b></li> <li>- Nxënësi krijon në përputhje me kërkesat e kohës.</li> <li>· <b>Kompetenca personale</b></li> <li>- Nxënësi përjeton nëpërmjet krijimit artistik vlerën e artit pamor.</li> </ul>		<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërgjegjësohet për rolin e artit figurativ në jetën e përditshme;</li> <li>• Ilustron, krijon, harton sipas dëshirës aty ku e ndjen veten më mirë;</li> <li>• Vlerëson kontributin që jep artistit në spektrin e madh të artit figurativ.</li> </ul>	
<b>Mjetet e punës:</b> nxënësi/ja zgjedh një krijim sipas preferencave të tij/saj.			
<b>Burimet:</b> Teksti – Art pamor 6		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Histori, TIK, Aftësim teknologjik, Letërsi	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b> <i>Diskutim, marrëdhënia pyetje- përgjigje, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim</i>			

**Përshkrimi i situatës:**

*Diskutim.* Mësuesi/ja paraqet një libër me ilustrime, një etiketë ushqimore, një veshje, një postier etj. (Sende që mund të jenë në klasë dhe kanë lidhje me temën).

Mësuesi paraprakisht shtron pyetjen:

- Si e kuptoni ju profesionin e një piktori (artisti)?
- Çfarë i bashkon të gjitha këto sende së bashku? (Artisti, piktori.)

Mësuesi/ja shpjegon se krijimtaria e një artisti nuk përmbledhet vetëm në konceptin e një kavaleti, telajoje dhe peneli.

**Realizimi i kuptimit:**

Mësuesi/ja shpjegon konceptet bazë të mësimit duke e ilustruar me shembuj.

**- Si lidhen artet figurative me artet e tjera?**

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Si do t'ju dukej një film pa figurë, një libër pa ilustrime, një patatinë pa etiketë, një teatër të zbrazët etj.?

Pra, ne kur kërkojmë diçka e zgjedhim nga ana e jashtme dhe nga etiketat. Në teatër, balet etj., është shumë i rëndësishëm dekori i skenografisë dhe kostumet që janë në përputhje me titullin, kohën dhe vendin ku zhvillohet ngjarja. Pra, artet figurative kanë lidhje të pandashme me disa fusha të jetës si dhe me teknologjinë kompjuterike.



Në kohët moderne, ku jetojmë ne sot dhe me përparimin e teknologjisë, fjala artist ka një kuptim shumë më të gjerë duke filluar që nga ilustrimet e librave për të gjitha moshat, në teatër, opera, balet, kinematografi, në dizajn (reklammat, posterat etj.), në modë (stilistët), dizajneri, arkitekti, fotografi etj. *Artet figurative kanë lidhje edhe me llojet e tjera të artit, nëpërmjet anës pamore.*

**- A mund të përmendni disa fusha ku zbatohen artet figurative?**

Mësuesi/ja shkruan në tabelë ndërkohë, që pyet nxënësit:

*- Pse artet figurative kanë lidhje me letërsinë, teatrin, operën, baletin, kinematografinë, dizajnin, modën, arkitektin, fotografimin etj?*

Përgjigjet e sakta të nxënësve i shkruan përbri fjalëve, si letërsi etj.

*- Dikur shumë nga këto krijime bëheshin nga dora e vetë artistit ndërsa, sot, kompjuteri ka hyrë kudo. Mësuesi bashkëbisedon më nxënësit duke nxjerrë në pah krijimtarinë artistike të fushave përkatëse. Pra, “syri i piktorit” është i nevojshëm në çdo fushë të jetës.*

*Krijimtari artistike.* Mësuesi/ja jep alternativat ku nxënësi zhvillon krijimtarinë e tij. Nxënësi mund të krijojë kopertinën e një libri që ka lexuar, mund të ilustronjë një tregim të shkurtër ose “fumetti” të krijuara vetë nga imagjinata, mund të krijojë një etiketë ushqimore, ose të stilojë një veshje, ose një objekt të përdorimit të përditshëm duke u frymëzuar edhe nga fotot e librit.

Nxënësit përzgjedhin teknikën dhe temën sipas dëshirës. Si fillim vizatojnë me laps dhe më pas përfundojnë ngjyrosjen. Nxënësit punojnë të pavarur.

**Përforcimi i njohurive:**

Krijimet e përfunduara nxënësit i vendosin në një vend të dukshëm dhe vëzhgojnë punët e njëri- tjetrit. Japin vlerësime dhe opinionet e tyre për realizimin sipas kërkesave të duhura. Në këtë mënyrë ata vlerësojnë rolin e artit figurative në jetën e përditshme dhe kuptojnë rëndësinë e tij në kohët moderne.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për konkretizimin e njohurive në krijimet e tyre.

**Detyra:** Nxënësit punojnë sipas rubrikës “ushtrohuni”.

## Udhëzime për vlerësimin

Në përputhje me parimet e qasjes së mësimin bazuar në kompetenca, vlerësohet si element i mësimdhënies, i cili përqendrohet në nivelin e arritjes së kompetencave. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësve në përmbushjen e kompetencave, u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien dhe të pajisin nxënësin me informacionin përkatës për progresin e tij. Sigurisht, është i domosdoshëm edhe vlerësimi i përmbajtjes lidhur me zotërimin e njohurive dhe shpalosjen e aftësive pamore nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e **tyre** (p.sh., vetëvlerësimi i punimeve të nxënësve të realizuara me teknika të larmishme artistike, portofol me punë artistike, prezantim me gojë, pjesëmarrja në një projekt kurrikular etj.).

Vlerësimi përshkon gjithë procesin mësimor dhe i shërben përmirësimit të këtij procesi. Në artin pamor, vlerësimi mbështetet në parimin e individualizimit, ku çdo nxënës zotëron dhe zhvillon prirje të veçanta, duke u shprehur në mënyrë individuale dhe në bashkëpunimin e realizimit të temave mësimore në grup. *Inkurajimi, imagjinata, shprehja origjinale dhe krijuese, interesimi, përjetimi artistik, interpretimi dhe prezantimi* i punëve artistike janë forma, të cilat ndihmojnë në vlerësimin e punës krijuese të nxënësve në arte.

Gjithashtu, pjesëmarrja individuale dhe në grup, në aktivitetet artistike të ndryshme që organizohen në klasë, shkollë dhe në komunitet, janë pjesë e procesit të vlerësimit. Vlerësimi mbështetet tërësisht në rezultatet e të nxënësve dhe objekt i vlerësimit janë krijimi i kompetencave të artit pamor të nxënësve, përmes krijimit, interpretimit dhe vlerësimit. Arritjet në lëndën e artit pamor janë më shumë individuale, prandaj duhet edhe të vlerësohen si të tilla. Kjo gjë bëhet në funksion të matjes së kompetencave artistike të caktuara, që arrin të zhvillojë nxënësi gjatë procesit mësimor, vetëm ose në grup, përmes veprimtarisë praktike, d.m.th., përmes *krijimit, vëzhgimit, dhe analizës së veprave të artit* etj. Nxënësit vlerësohen, ndërsa shfaqin arritjet nëpërmjet veprimtarive e produkteve të ndryshme.

Portofoli i nxënësit, është një tjetër mundësi vlerësimi, është një koleksion i punimeve përgjatë vitit shkollor në artin pamor. Ai mund të përmbajë krijime, organizime dhe projekte kurrikulare, në dobi të veprimtarive të ndryshme shkollore, produkte të veprimtarive kurrikulare etj.

Vlerësimi i nxënësve bëhet sipas kompetencave përkatëse që ata duhet të zhvillojnë.

## TEST PËRMBLEDHËS

Emri/Mbiemri \_\_\_\_\_

1. Cili është funksioni i vijës në artin pamor?

(1 pikë)

---

---

2. Shkruani disa lloje vijash dhe shpjegoni se çfarë shprehin.

(2 pikë)

1. \_\_\_\_\_ 2. \_\_\_\_\_ 3. \_\_\_\_\_ 4. \_\_\_\_\_

---

---

3. a. Çfarë shpreh shenja?

(2 pikë)

---

---

b. Emërtoni llojet e shenjave:

1. Shenja \_\_\_\_\_

2. Shenja \_\_\_\_\_

3. Shenja \_\_\_\_\_

4. Shenja \_\_\_\_\_

4. Cilat janë ngjyrat parësore? Pse quhen të tilla? Po vetitë?

(3 pikë)

---

---

---

5) a. Shkruani llojet e artit që zhvillohen në hapësirë.

(2 pikë)

---

---

b. Qarkoni përgjigjen e saktë. Artistët e paraqesin hapësirën:



1. nëpërmjet rregullave matematikore;
2. nëpërmjet rregullave të perspektivës.

**c. Shkruani gjinitë e artit që nuk e kanë përmasën e tretë.**

1. \_\_\_\_\_ 2. \_\_\_\_\_ 3. \_\_\_\_\_

**6. Qarkoni përgjigjen e saktë. Si quhet ndryshe sipërfaqja?**

**(1 pikë)**

- a. tekstil
- b. teksturë
- c. relief

**7. Si jepet vëllimi?**

**(1 pikë)**

\_\_\_\_\_

**8. Si është vëllimi në pikturë dhe në skulpturë?**

**(5 pikë)**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**9. Çfarë është harmonia?**

**(1 pikë)**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**10. a. Qarkoni përgjigjen e saktë. Baraspesha është:**

**(2 pikë)**

1. kombinimi i ngjyrave
2. kombinimi i elementeve për të krijuar ekuilibër

**b. Shkruani llojet e baraspeshës:**

1. \_\_\_\_\_ 2. \_\_\_\_\_

**11. Shkruani disa emra piktorësh që njihni:**

**(3 pikë)**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

<b>Pikët</b>	<b>0- 4</b>	<b>5- 9</b>	<b>10- 12</b>	<b>13- 15</b>	<b>16- 18</b>	<b>18- 20</b>	<b>21- 23</b>
<b>Nota</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>6</b>	<b>7</b>	<b>8</b>	<b>9</b>	<b>10</b>

